

Zoran Zaev
Në janar
përfundon
Marrëveshja
e Prespës

Fq.3



**PROVAT PËR
SKËNDERBEUN**

Vetëm 3 javë
kohë për operën
e parë shqiptare

Fq.4



Mirënjohje
ka vetëm
për tifozët
e Realit

Lopetegui

Fq.22



Koha

www.koha.mk

**E rrezikshme
është FIFA**

Fq.11

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3497 · e mërkurë, 31 tetor 2018

13°C | 20°C

15 DEN

FORUM

**Mos bëj
moralistin
mes
mexhlishesh!**



"Ata që merren me thashetheme, me e pa të drejtë" më thonë se shkrimet i kam paksa "me hatër e me temena" sidomos kur shkar-ravis për politikë... më thonë se shkrimet i bëj "toptan" me dy e më shumë standarde, njësoj si ajo puna e "burrave me barrë a pak shtatzënë dhe grave me pro-statë", ca të tjerë...

Fq.10

RAJON

**Parlamenti
grek refuzon
kërkesën për
1 minutë
heshtje**

Fq.14

GLOBI

**Myslimanët
më të
mirëpritur
në Evropën
Perëndimore**

Fq.15



KËRKOHET EDUKATA SEKSUALE EDHE NË SHKOLLA

MAQEDONIA KRYESON LISTAT PËR ABORTE



"Në Maqedoni, të rinjtë kanë nevojë për qasje më të mirë të shërbimeve shëndetësore seksuale, sepse janë në vendin e fundit të listës në Evropë për përdorimin mjeteve kontraceptive, por kryesojnë në listë për aborte dhe shtatzëni të tinxherëve. Pra, jemi lider në diçka që nuk është e mirë për shëndetin dhe mirëqenien e tonë", thonë nga HERA

Fq.6

Alimi nuk përmendet, gishti drejt Gurit

Shkup, 30 tetor - Korigjimi i procesverbaleve për zgjedhjet lokale në Çair në vitin 2013 nga funksionar të BDI-së është realizuar në marrëveshje me VMRO-DPMNE-në. Në rrëfimin e tij, Veton Kiki, dëshmitar i Prokurorisë Speciale Publike në rastin "Titanik 3", tha se Ismet Guri, gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore në Komisionin Zgjedhor Komunal (KZK), në Çair, i ka thënë se përmirësimi i procesverbaleve

duhet të bëhet për shkak se ashtu janë marrë vesh me VMRO-në. "Procesi zgjedhor gjatë ditës u zhvillua në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Me përmblylljen e vendotimeve, ne si Këshill zgjedhor filluam numërimin dhe mbledhjen e votave (materialeve). Diku para apo pas mesnate, nën shoqërimin e policisë i dërguam materialet në KZK-Çair. Me të hyrë në komunë, para zyrës...

Fq.5



EDITORIAL

NJË EUROPE
PA MERKELIN?

Janis EMMANOULIDIS

Prej 13 vitesh kancelarja Merkel përcakton politikën e BE, por jo pa kontestime. Politika e saj për refugjatët ishte pa konsensus. Politika e kursimeve e kritikuar. Në BE largimi i Merkelit shihet edhe si një shans i ri.

Vëzhguesit politikë në Bruksel nuk janë të habitur me dhënien e sinjalit të largimit të kancelares gjermane, Angela Merkel nga skena politike nga vetë kancelarja. Që në verë pas dështimit të samitit për refugjatët, portali politik informativ "Politico" bëri fjalë për largimin e saj. Aftësia e Merkelit për të arritur diçka në BE u trondit mjaft pas grindjeve të brendshme në koalicionin e saj qeverisës në Berlin. "Si Merkel po përçan BE" shkroi "Politico", një portal i elitës politike të Brukselit. Zgjedhjet e landeve Bavari dhe Hesen nuk ishin mbajtur ende, kur u shkrua ky artikull.

Por u kuptua qartë, se kursi i Merkelit në krizën e refugjatëve në vitin 2015 i dha hov populistëve në Europë. Ajo nuk e arriti dot solidaritetin e kërkuar në politikën e migrimit dhe as shpërndarjen e detyrueshme të refugjatëve. Megjithatë së fundmi Merkel u angazhua për mbylljen e kufijve të jashtëm dhe qendrat e azilit në Afrikën Veriore.

Në Poloni, Hungari dhe Itali nuk ka për të lëshuar ndokush një pikë loti, kur Merkel të dorëzojë edhe postin e kancelares. Shumë politikanë në vendet në krizë e shohin me sy shumë kritik politikën e ashpër të kursimeve që ndoqi Merkel gjatë krizës së euros në Greqi, Qipro, Portugali, Spanjë, Irlandë dhe tani Itali. "Një Europë pa Merkelin është natyrisht e mundur. Kur ke një lidhshmëri si Gjermania apo Merkel ka edhe vende që nuk janë shumë të kënaqur me politikën e saj. Prandaj, jo vetëm në Europën Lindore, por edhe atë Perëndimore gjen mjaftueshëm njerëz, që janë të kënaqur që kancelarja largohet", thotë Jannis Emmanouilidis, drejtues i Institutit "European Policy Centre" për Deutsche Wellen.

Ministri i Brendshëm i Italisë, Matteo Salvini në një intervistë për DW vlerësoi se Merkel e nuk e vlerësoi si duhet çështjen e refugjatëve. Pas zgjedhjeve në Hessen, Salvini shtoi edhe një deklaratë tjetër. Zgjedhjet janë "një goditje çekiçi" për kancelaren.

Megjithatë Gjermania vë vulën në Europë si vendi anëtar më i madh dhe më i fortë financiarisht. Kjo bën që diplomatët e BE të parashikojnë se negociatat për buxhetin e përbashkët në BE nuk do të shënojnë ndonjë progres para zgjedhjeve të europiane në Maj 2019. E paqartë mbetet, se si do të ndikojë vendimi i Merkelit për t'u larguar edhe në një çështje tjetër të personelit. Javën e ardhshme konservatori Manfred Weber i CSU-së donte të shpallte kandidaturën për postin e kreut të Komisionit Europian tek partitë popullore. Në këtë pikë fjala e Merkelit do të ishte vendimtare.

Më i prekur nga largimi i Merkelit duhet të ndjehet presidenti francez, Emmanuel Macron, sepse ai dëshironte me "miken e mirë Angela" të çonte përpara agjendën reformuese europiane. "Kjo do të thotë se sigurisht do të kemi një fazë pasigurie, nga perspektiva e Macronit kjo nuk është ajo që ai ka shpresuar", thotë eksperti Janis Emmanouilidis.

"Por nga ana tjetër që nga fillimi i koalicionit të madh kemi parë se si qeveria dhe kancelarja në tërësi nuk kanë reaguar shumë ndaj propozimeve të Macronit apo propozimeve të ardhura nga Parisi." Çështja është si do të zhvillohen gjërat pas largimit të Merkelit. Ekspertët shohin edhe një shans për Emmanuel Macron, pasi Merkel të largohet nga skena. Një spekulim që vazhdonte prej kohësh në Bruksel u hodh poshtë të hënën (29.10). Kancelarja gjermane bëri të qartë, se nuk synon të marrë poste në BE. Disa vëzhgues madje spekulonin se ajo mund të kalonte vitin e ardhshëm në Bruksel ose si presidente e Komisionit Europian, ose e Këshillit të BE, të dyja poste që duhet të gjejnë emra të rinj vitin e ardhshëm. (DW)

SI DO TË DUKET EUROPA PA MERKELIN?

"Humbja reale e fuqisë politike të Kancelares Merkel pas zgjedhjeve në shtetin Hesse dhe është një shenjë tjetër e ndryshimeve politike dhe gjeopolitike që janë duke përfshirë dhe do ta mbulojnë Europën dhe botën në vitet e ardhme. Brenda katër apo pesë viteve ne do të jemi në një riroorganizim krejtësisht ndryshe të botës dhe ai nuk do të jetë i favorshëm për ne shqiptarët sikur balansi i krijuar pas vitit 1989 e deri më 2016. Kemi edhe krejt pak çaste që kastat tona politike të ulen, të krijojnë plane konkrete dhe të pozicionohen në pika ku interesi shqiptar vihet si prioritet.

Nëse vazhdohet me byrtyet e politikave ditore dhe partiave dhe nuk nxirren kokat e shumë politikaneve nga rëra, atëherë dekadat e ardhme për shqiptarët do të jenë të zeza", ka shkruar një status në Facebook, veprimtari Uk Lushi.

MOS I VLERËSONI GABUESHËM NJERËZIT TANË!

"Vlerësimi i figurave politike tek ne mbi baza fetare, mbi baza të besimit në Zot dhe të ngjashme, sa për mua, është vlerësim amatoresk dhe tepër sipërfaqësor. Është vlerësim që sja vlenë. Nëse bash duhet të merren për bazë besimi në Zot apo përkatësia e dikujt fetare, atëherë le të shikohet në refleksionet dhe frymezimin e besimit në Zot të individit në punët që i bënë, në kryerjen e obligimeve që i ka ndaj qytetarëve.

Të shikohet a është bërë feja tek ai promotore dhe gjenerator për punë të bereqetshme. Të shikohet si e ka përkthyer fenë në gjuhën e së përditshmes dhe si e ka kuptuar esencën e saj. Përndryshe, besimi në Zot dhe feja mbeten ose çështje tejet personale e secilit njeri, ose mekanizëm perfekt për mashtrime e përfitime të ulëta.

Më thuani, sa ja vlenë barra qeranë nëse një politikan apo udhëheqës i ndonjë institucioni është besimtar apo i takon kësaj apo asaj feje, por është i korruptuar deri në fytyrë, që i shfrytëzon e i ndrydhe ndjenjat e njerëzve, që nuk shikon përtej hundës së tij, që interesin e tij e ka parësorë, që mashtron dhe përfiton nga votat tona, dhe, si do ta vlerësonit tjetrin, që ndoshta nuk është besimtar, që nuk takon fesë suaj, por e kryen punën me përgjegjësinë më të madhe?

Dhe anasjelltas.

Prandaj, mendoj unë, me gjithë rëndësinë e madhe që ka feja në edukimin dhe fisnikërimin e shpirtit të njeriut, nga andej, në bërjen e njeriut sa më i dobishëm për rrethin dhe shoqërinë, apo, me gjithë faktin se fjala e një lideri kur flet për fenë dhe gjëra të tjera sublime, është e madhe, me peshë dhe ka ndikim në shoqëri, pra, që duhet të kihet kujdes e të mos flitet paushall sa të ngacmohen keqazi ndjenjat e qytetarëve, bindshëm besoj, pra, se ajo që një lider politik e bënë të pranueshëm dhe të respektuar nga masat, nuk është përkatësia e tij fetare e deri dikund as ideologjike, por është pikërisht vizioni i tij për të ardhmen e vendit, është puna dhe përpjekja e tij për t'i sjellë të mira shoqërisë në të cilën jetojmë...!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, teologu Mustafa Bajrami.



MEDIACitate

NDOTJA
E AJRIT
SHKAKTON
VDEKJEN E
7 MILIONË
PERSONAVE
NË VIT

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) paralajmëroi se ndotja e ajrit çdo vit shkakton vdekjen e 7 milionë personave në botë, ndërsa 92 për qind i rreth 4 miliardë personave në rajonin Azi-Paqësor janë duke thithur ajër toksik.

Në raportin e ri të Programit të Mjedisit të OKB-së (UNEP), është bërë e ditur se me një paketë parandaluese e përbërë prej 25 pikë, në Azi me vitin 2030 do të mund të shpëtohet jeta e miliona njerëzve si dhe 1 miliard persona do të mund të thithin ajër të pastër.

"Rritja e standardeve të emetimit, intensifikimi i kontrolleve mbi automjetet, centralet e energjisë dhe industrisë me përmasa të vogla dhe të mëdha, zvogëlimi i djegies së mbeturinave të ngurta në zonat bujqësore dhe urbane, parandalimi i zjarreve të pyjeve, menaxhimi i duhur i plehrave të kafshëve, sigurimi i energjisë së pastër për amvisëritë dhe përmirësimi i transportit publik", janë masat që janë përmendur në raport.

Në raport theksohet se ndotja e ajrit çdo vit shkakton vdekjen e parakohshme të 7 milionë personave në botë prej të cilëve 4 milionë në Azi-Paqësor, ndërsa 92 për qind i rreth 4 miliardë personave në rajonin Azi-Paqësor janë duke thithur ajër toksik që mund të përbëjë rrezik serioz për shëndetin.

Drejtori Ekzekutiv i UNEP ka theksuar se "ajri i pastër që është nevojë më themelore" tashmë është shndërruar në luks në shumë vende të botës, vuri në dukje se ka shumë zgjidhje të testuara që mund të zbatohen.

Ndërkohë theksohet se zbatimi i kësaj pakete do të kushtojë 300-600 miliardë dollarë në vit.


(Anadolu Agency, 30 tetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË ISHIN "KËMISHAT E KUQE"?

Këmisha e kuqe ishte uniforma dhe shenja dalluese e luftëtarëve të Xhuzepë Garibaldit, heroit të bashkimit të Italisë, patriotit të madh italian. Historia e kësaj këmishë nis kur në krye të 500 italianëve, Garibaldi luftonte në mbrojtje të republikës së re uruguaiane

në Amerikën Latine, në 1843. Duke mos patur shumë fonde, Garibaldi shfrytëzoi një sasi cope të kuqe që e përdornin si veshje kasapët për të fshehur njollat e gjakut, dhe për të dalluar trupat e tij u kërkoi të vishnin këmishë me këtë pëlthurë.



ZAEVI BINDUR SE NUK DO KETË PENGESA NË NDRYSHIMIN E KUSHTETUTËS

NË JANAR PËRFUNDON MARRËVESHJA E PRESPËS

Zavi ka thënë se është në komunikim të rregullt me kryeministrin grek Cipras dhe se të dy nuk presin prolongim të procesit, për shkak se, siç thotë Zaevi, as ata, as ne, nuk kemi dobi nga kjo. "Sa më shpejtë përfundohen obligimet në parlament tek ne dhe tek ata aq më shpejtë lihet hapësirë për qytetarët që t'i shohin beneficimet nga Marrëveshja"



KËRKESAT PËR SHQIPTARËT, ZAEVI I CILËSON SI KUTIA E PANDORËS

I pyetur lidhur me atë nëse do të shqyrtohen propozimet e Lëvizjes BESA dhe të Aleancës për Shqiptarët. "Unë i kuptoj nevojat e njerëzve për të hapur debat, të japin propozime veçanërisht për kreativitetin e opozitës dhe ngjashëm, por në fund e di se askush nuk ka të drejtë të bëjë çfarëdo kushtëzimi të integritetit të Maqedonisë në NATO dhe BE. Me siguri nuk do të lejojmë hapjen e Kutisë së Pandorës. Këtë e dinë të gjithë, ndërsa është radha edhe unë ta konfirmoj. Parlamenti është ai që

vendos përfundimisht. Ne jemi vetëm propozues. Por, në kuadër të të gjitha këtyre gjërave unë gjithmonë qëndroj në dispozicion për të ndërnuar një shoqëri për të gjithë për të cilën angazhohemi të gjithë dhe jo të tentojmë në mënyrë tjetër kur sillen vendime të mëdha pas së cilave qëndrojmë të gjithë, të cilat janë përcaktimet tona programore, si parti politike të përfaqësuara në Parlament dhe përcaktime strategjike si shtet të rrezikohen në vetë procesin e vendimmarrjes", tha Zaev.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 30 tetor - Kryeministri Zoran Zaev pret që të respektohen të gjitha afatet për procesin për sjellje të amendamenteve kushtetuese, që janë obligim në pajtim me Marrëveshjen e Prespës.

"Afatet e rregullores janë qartë të përcaktuara. Nëse ne më 5 nëntor në seancë të Qeverisë i miratojmë draft-amendamentet dhe i dërgojmë deri tek Parlamenti, për 30 ditë duhet të caktohet seanca. Seanca do të caktohet në kuadër të 30 ditëve, në pajtim me Rregulloren, dhe do të hapet debati në Komisionin kushtetues dhe Komisionin juridiko-ligjdhënës. Gjithsesi se afatet kështu të konfirmuara janë qartë të precizuara në Rregullore dhe në kuadër të këtyre afateve zhvillohen të gjitha diskutimet, madje për këtë arsye edhe lejojmë që të projektojmë data për gjysmën e dytë të janarit", tha Zaev në pyetjen e gazetarëve pas fjalimit në simpoziumin e think tankëve nga Kina dhe vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Ai konsideron se dje kanë pasur takim cilësor pune me deputetët nga grupi i ri i deputetëve i VMRO-DPMNE-së dhe koalicioni, në të cilin kanë marrë sugjerime konkrete, që beson se do të futen në vetë tekstet. "Do t'i konsultojmë edhe një herë për atë që sugjerojnë, ta shohin të futur në tekst, se si ajo duket, dhe nëse e japin pëlqimin vazhdojmë me hapat e ardhshëm", tha Zaev.

Shtoi se për procesin me ndry-

shimet kushtetuese është konsultuar edhe pala greke.

"E dini se është konsultuar edhe pala greke. Ky nuk është obligim nga Marrëveshja, por në frymën e partneritetit dhe miqësisë është radha që të prezantojmë çka Parlamenti i Maqedonisë do të vendosë në periudhën që vjen, sepse është draft-fazë dhe gjatë debatit për vetë amendamentet kushtetuese mund të plotësohen me amendamente. Do të thotë, në debatin publik dhe në versionin përfundimtar të amendamenteve që do të vijin, Besoj se deri të premten do të mbërrijmë me të gjithë konsultimet e domo-

sdoshme", theksoi kryeministri Zaev, duke shtuar se është në komunikim të rregullt me kryeministrin grek Cipras dhe se të dy nuk presin prolongim të procesit, për shkak se, thotë Zaevi, as ata, as ne, nuk kemi dobi nga kjo. Sa më shpejtë përfundohen obligimet në parlament tek ne dhe tek ata aq më shpejtë lihet hapësirë për qytetarët që t'i shohin beneficimet nga Marrëveshja.

Ai deklaroi se nuk beson se do të ndodhë bllokimi nga ana e opozitës në procesin në Kuvend se thotë nuk ka nevojë për këtë. "Nuk ka nevojë për atë edhe pse ka spekulime të

caktuara për këtë punë. Unë personalisht nuk besoj se kjo do të ndodhë sepse nuk e shoh përshtatshmërinë e vetë bllokimit për shkak të afateve të rregullores qartë të precizuara që ekzistojnë në procedurë të tillë", tha Zaev.

Ai shprehu bindjen se në procesin e pajtimit do të bashkohen të gjithë deputetët e opozitës, se thotë se kjo është mirë për Maqedoninë. "Numri prej 80 deputetë nuk është i mjaftueshëm, jo se Zaev këtë e dëshiron. E dinë edhe ata se ky është moment historik për Maqedoninë. Duhet t'i sjellim bashkërisht vendimet dhe t'i përvijm krahët të pu-

nojmë në ekonomi, reformat për një jetë më të mirë të qytetarëve", tha Zaev. Duke komentuar deklaratën e djeshme të zëvendëskryeministrit Osmani se një pjesë e atyre të cilët kanë qenë të përfshirë në ngjarjet e 27 prillit mbase kanë qenë dëm kolateral dhe se nuk përjashtohet mundësia për ta të ketë amnisti, shefi i Qeverisë nënvizoi se angazhohet për proces të pajtimit. Për pyetjen për përfshirjen e Marrëveshjes së Ohrit në preambulën e Kushtetutës ai tha se kjo nuk është çështje e përcaktuar dhe se do të bisedohet ose është duke u biseduar në nivel nënkryetarësh.

"E dini se isha i përkushtuar në bisedimet me deputetët e grupit të ri të deputetëve të VMRO-DPMNE-së dhe partnerëve të koalicionit Për një Maqedoni më të mirë që të mund ta bëjmë procesin inkluziv të cilin e premtuan gjatë bisedimeve të cilat dolën si rezultat i qëllimit final - votimit për hapjen e nevojës për amendamente kushtetuese. Marrëveshja e Ohrit është pjesë përbërëse e Kushtetutës së RM-së. Ajo veç më është vendosur pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit. Dua të dërgoj mesazh se inkluzioni në proces është i rëndësishëm, por nuk guxojmë me ambiciet tona ta ndalojmë gjithë procesin dhe ta minimizojmë kohën e nevojshme për sjelljen e të gjitha hapave të nevojshme të cilat janë projektuar diku nga mesi apo nga gjysma e dytë e janarit. Do të bisedojmë për të gjitha detajet. Për mua është shumë e rëndësishme fillimisht ta plotësojmë marrëveshjen. Kjo është esenca e ndryshimeve kushtetuese, ndërsa në kuadër të kësaj esence tani e shoh se kemi një mënyrë mjaft të kujdesshme të propozimit të plotësimit të amendamenteve kushtetuese të cilat do ta garantojnë identitetin, nevojën e verifikimit apo ratifikimit të marrëveshjes nga pala greke, si edhe zbatimin e brendshëm që gjithçka është në frymën e marrëveshjes. Deputetët gjithsej 80 të cilët e dhanë votën e tyre që të hapen ndryshimet kushtetuese janë të rëndësishëm. Gjithsesi me ta do të bisedojmë edhe nëse kjo është e pranueshme për të gjithë do t'i vazhdojmë proceset duke përfshirë edhe për deklaratat e tilla të cilat i dëgjova prej mediave", tha Zaev.

MO NË PREAMBULË, SHEKERINSKA NUK PREFERON TË FLASË

Gjithçka që tani unë mund të them për atë se çfarë do të përmbajnë amendamentet do të ishte spekulim për shkak se ende jemi në procesin e përpunimit të amendamenteve kushtetuese. Për atë them se ka mendime të ndryshme, propozime të ndryshme, megjithatë nëse dalim menjëherë me propozim do të ishte shumë vështirë të sigurohen dy të tretat e shumicës pa konsultime paraprake dhe për atë arsye kryejmë konsultime më të gjera. Kjo është përgjigja e zëvendëskryeministres dhe ministres e Mbrojtjes Radmila Shekerinska në pyetjen e gazetarëve për deklaratën e zëvendëskryeministrit Bujar Osmani për futjen e Marrëveshjes së Ohrit në preambulën e Kushtetutës. "Amendamentet i punojmë jo vetëm me grupet parlamentare, por së bashku edhe me disa ekspertë, të cilët e njohin materialin e Kushtetutës. Gjithçka tjetër në ndërkohë do të jetë



vetëm spekulim. Kryeministri i zhvilloi këto bisedime me grupin parlamentar. Ne do të kemi debat brenda në Qeverinë e Maqedonisë, fokusi jonë për ndryshimet kushtetuese ka të bëjë me çështjet të cilat dalin nga Marrëveshja e Prespës.

Vazhdimisht zhvillohen debate, por gjithçka që do të them sot, do të ishte spekulim", tha ministrja Shekerinska, e cila dje mori pjesë në promovimin e 125 ushtarëve profesionistë të ARM-së në Shkup në kazermën "Ilinden". Ai përkujtoi se kryeministri Zoran Zaev së fundmi ka biseduar me grupin e ri parlamentar, siç potencion, për të gjetur gjuhë të përbashkët që do të mundësonte edhe në votimin e dytë dhe të tretë sigurimin e dy të tretave të shumicës. "Presim që deri në fund të javës debati në Qeveri të përfundojë dhe të dorëzohet në Kuvend propozimet për ndryshimet kushtetuese", tha zëvendëskryeministrja Shekerinska.

Ligji i shqipes, Prokuroria heton Ivanovin



Shkup, 30 shtator - Prokuroria e Përgjithshme Publike filloi me procedurën paraheti-

more lidhur me mos nënshkrimin e Ligjit të gjuhëve dhe Marrëveshjes së Prespës nga ana e presidentit të Maqedonisë, Gjorge Ivanov. Siç njoftoi Prokuroria e Përgjithshme Publike në Shkup, procedura parahetimore është ngritur duke proceduar sipas dy kallëzimeve anonime.

"Me këtë qëllim tashmë janë kërkuar të

dhëna dhe informacione nga Parlamenti i Maqedonisë dhe nga Kabineti i presidentit të Maqedonisë lidhur me atë se kur janë marrë vendimet në dhomën ligjvënësë, respektivisht për çfarë arsye nuk është nënshkruar marrëveshja nga ana e Presidentit", thonë në Prokurorinë Publike.

Konkretisht, bëhet fjalë për refuzimin e

Ivanovit për të dytën herë me radhë që ta nënshkruajë Ligjin e gjuhëve, të njohur ndryshe si Ligji i shqipes, edhe pse dy herë, në Parlament ishte konfirmuar vota "për" e shumicës për këtë Ligj. Gjithashtu, hetimet e Prokurorisë kundër Ivanovit kanë të bëjnë edhe me mos nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës. (Z.V)

Për këtë projekt të prezantuar që në muajin shkurt të këtij viti, si pjesë e Programit vjetor të Ministrisë së Kulturës, prej disa muajsh nuk po arrihet të nënshkruhen kontratat dhe të fillohet me provat

Koha Evis HALILI

Shkup, 30 tetor - "Skënderbeu", opera e parë shqiptare që do të realizohet nga Opera dhe Baleti i Maqedonisë, mund të nisë me provat javën e ardhshme (7 nëntor). Për këtë projekt të prezantuar që në muajin shkurt të këtij viti si pjesë e Programit vjetor të Ministrisë së Kulturës, prej disa muajsh nuk po arrihet që të nënshkruhen kontratat dhe të fillohet me provat.

Edhe pse është prezantuar si një prej ngjarjeve më të rëndësishme për kulturën shqiptare dhe të programit për shënimin e Vitit të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti, premiera e së cilës duhet të jetë më 28 nëntor - Që do të thotë se nëse provat nisin më datë 7 nëntor, brenda një afati rekord prej 21 ditëve do të duhet që të vihet në skenë kjo operë. Arsyet për të cilat u bllokuan procedurat nuk janë komentuar, si nga ish drejtori i OBM, Qazim Asotiq, ashtu edhe nga Ministria e Kul-

PROVAT PËR SKËNDERBEUN JAVËN E ARDHSHME

VETËM 3 JAVË KOHË PËR OPERËN E PARË SHQIPTARE



turës, për këtë projekt që realizohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës, por që nuk figuron si pjesë e Programit vjetor të Operës.

Fillimisht ideja për të realizuar këtë projekt nënkuptonte angazhimin e një numri të madh koristësh dhe artistësh të skenës, skenografisë grandioze dhe kostumeve të shtrenjta. Do të bazohet tek kryesisht tek poema e Naim Frashërit "Skënderbeu", por në ndërkohë si buxheti ashtu edhe të tërë elementët e tjerë kanë pësuar ndryshime, duke iu përshtatur rrethanave të krijuara.

Opera është kompozuar nga Fatos Lumani, libreti nga Arjan Krasniqi dhe është konceptuar mes të tjerash edhe si një kolazh nga vepra të shkruara për heroin kombëtar dhe me regji të Qëndrim Rijanit. Hollësitë për koston e këtij projekti, ansamblin e koristëve e këngëtarëve akoma nuk janë bërë publike. "Skënderbeu" i OBM është opera e parë me tematikë nga jeta e heroit kombëtar e kompozuar nga një kompozitor nga Maqedonia, por e dyta që realizohet nga një autor shqiptar. Deri tani njihen vepra e Preng Jakovës, i cili në vitin 1966

kompozoi operën "Skënderbeu", me libret të shkruar nga Lazar Siliqi dhe bazuar tek vepra e Marin Barletit. Ishte e njëjta pjesë që u shfaq gjashtë vjet më parë në Shkup në OBM me rastin e shënimit të 100 vjetorit të Pavarësisë. Për heroin kombëtar janë shkruar edhe dy opera të tjera të kompozuar në shekullin e XVIII-të, në Itali dhe Francë. E para është realizuar nga kompozitori Antonio Vivaldi dhe libretisti Antonia Salvi, ndërsa e dyta "Skënderbeg- Tragjeditë" nga Rebek dhe Frankër dhe libret të Mote.



Osmani në fluturimin e parë nga Athina për në Shkup

Athinë, 30 tetor - Zëvendëskryeministri i obliguar për çështje evropiane, Bujar Osmani, të enjten më 1 nëntor do të udhëtojë për në Athinë me rastin e vendosjes së serishme të linjës ajrore mes Shkupit dhe Athinës, njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina, e informuar nga burime nga Maqedonia dhe Greqia. Sipas informatave të njëjta, Osmani do të realizojë takim me ministrin alternativ të Punëve të Jashtme të Greqisë, Jorgos Katrugalos, pas çka, nga MPJ-ja greke, së bashku do të nisen deri te aeroporti athinas "Aleferios Venizelos", prej ku zëvendëskryeministri në Maqedoni do të kthehet me fluturimin e parë nga Athina për në Shkup, të vendosur pas pauzës prej mbi 10 viteve.

Fluturimi është në ora 18:40 sipas kohës lokale, ndërsa në Shkup mbërrin pas 1 orë e 15 minutave fluturim, respektivisht në ora 18:55 sipas kohës së Maqedonisë. Siç veçmë publikoi MIA muajin e kaluar, aviokompania greke "Aegean airlines", prej 1 nëntorit fillon me fluturime të rregullta, dy herë në javë nga Athina për në Shkup dhe anasjelltas. Ministri alternativ i Punëve të Jashtme të Greqisë, Jorgos Katrugalos, siç të shtunën publikoi MIA në intervistë për gazetën greke "Real njuz" e përmendi edhe fillimin e linjes ajrore për lidhje të drejtpërdrejtë të Athinës dhe Shkupit, si mundësi për thellimin e kontakteve mes dy popujve dhe rritjen e bashkëpunimit në disa sfera.

"Kjo është zhvillim pozitiv i ngjarjeve, që në mënyrë të konsiderueshme do të kontribuojë në rritjen e kontakteve mes dy popujve, por edhe promovimin e bashkëpunimit tonë në sferën e turizmit, tregtisë dhe biznesit. Është indikative sa u afuan popujt tanë gjatë viteve të kaluara, duke ndërtuar besim dhe mirëkuptim të ndërsjellë", tha Katrugalos në intervistë për gazetën greke.

Arnaudov dhe Vasilevski nuk tregojnë nëse do të votojnë për imunitetin e Gruevskit

Shkup, 30 tetor - Deputetët Luben Arnaudov dhe Sasho Vasilevski në dalje nga Gjykata Penale, në pushimin e gjykimin të djeshëm për ngjarjet e 27 prillit të vitit të kaluar në Parlamentin e Maqedonisë, në pyetjen e gazetarëve nëse do të votojnë për marrje të imunitetit parlamentar të Nikolla Gruevskit, thanë se nuk janë të njoftuar dhe nuk mund ta dinë se çfarë do të ndodh në Parlament. Arnaudov potencoi se edhe atij ia

kanë marrë mandatin, dhe askush nuk ka thënë asgjë, ndërsa kontestuese është edhe ajo që deputeti Pavle Bogoevski që e udhëheq Komisionin parlamentar për emërimet ku shqyrtohet marrja e imunitetit, është involvuar si dëshmitar në këtë proces gjyqësor.

"Duhet të shkojmë në Parlament dhe atje të tregojmë se çka ndodh. Me të vërtetë asgjë nuk di se çka ndodh. Edhe mua

ma morën mandatin dhe askush asgjë nuk më pyeti. Njeriu i cili e udhëheq seancën direkt është i involvuar në këtë proces dhe është kryetar i komisionit. Konsiderojmë se Pavle Bogoevski është prekur, sepse ishte dëshmitar në gjykim, ndërsa ka kryesuar me atë komision. Nuk ka logjikë... Ta dëshmojmë se nuk është ashtu ajo që duan të na e imponojnë, dhe për atë do të bisedojmë për punët tjera", potencon Arnaudov.



Shkup, 30 tetor - VMRO drejt përçarjes së madhe. Pas përjashtimit së fundmi të tetë deputetëve që votuan "për" hapjen e ndryshimit të Kushtetutës, tashmë grupi parlamentar i VMRO-së ka 39 deputetë nga 51 sa kishte më parë. Këtu hyjnë edhe tre deputetët e

AMENDAMENTET DO T'I VOTOJNË MBI 80 DEPUTETË

Dorëheqje të reja në VMRO, stabilizohet shumica

partive në koalicion me VMRO-në, si Amdi Bajram, Çedomir Sazdovski dhe Jusuf Hasan. Megjithatë, kjo nuk është e gjitha. Së fundmi, edhe deputetja Daniella Rangellova ka dhënë dorëheqje nga Forumi i Gruas i VMRO-së, njëjtë sikurse Lilja Zaturaska nga posti i sekretares në Forumin e Gruas.

Në postimin në saj në Facebook, Rangellova shkruan se dorëhiqet për shkak të mospajtimeve me politikën që i udhëheq

kryesia e VMRO-DPMNE. "Unë nuk mund të pranojë dhe të jem pjesë e kësaj udhëheqësie të VMRO-së, e cila partinë e çoi në izolim me politikën e bazuar në joshinjeritë dhe intriga që prodhuan ngatërresa brenda në parti. Patën sukses sipas parimit 'përçaj dhe sundo', në mënyrë plotësuese e ndanë popullin maqedonas dhe futën nivele të papranueshme të urrejtjes midis maqedonasve, por edhe midis anëtarëve të VMRO-së", shkruan Ran-

gellova. Sekretarja e përgjithshme i Forumit të Grave të VMRO-DPMNE-së, njëherësh deputetja Liljana Zaturaska, dje paradite shkroi se jep dorëheqjen e saj nga ky funksion me dëshirën për arritje më të mëdha me ekipin e ardhshëm i cili do ta drejtojë unionin.

"Si sekretare e përgjithshme e emëruar nga kryetarja Rangellova dëshiroj që të shpreh falënderim të madh për besimin që ajo më tha dhe kam dhënë maksimumin tim

që ta kryej funksionin në mënyrë më të denjë të mundshme. Jam në dispozicion të partisë sime duke i respektuar dhe duke i kryer vendimet dhe aktivitetet që do të më besohen në të ardhmen", shkruan Zaturaska në profilin e saj në Facebook. Në ndërkohë, pakënaqësitë dhe ndasitë e mëdha në VMRO kanë bërë të qartë se shumica tani më nuk e ka problem arrijen e 80 vota për ndryshimet kushtetuese. (Z.V)

DETAJE TË REJA PËR "TITANIK 3"



"Diku para apo pas mesnate, nën shoqërimin e policisë i dërguam materialet në KZK-Çair. Me të hyrë në komunë, para zyrës së KZK-Çair, kishte pritje të gjata. Nuk më kujtohet se kush ishte me mua. Ndërkohë, Ismet Guri dhe Qani Toçi si anëtarë të KZK-së, m'i kërkuan procesverbalet, gjegjësisht Guri më tha se të njëjtat duhet të përmirësohen për arsye të marrëveshjes që kanë me VMRO-DPMNE-në. Unë ashtu edhe veprovë. Më pas i dorëzova materiale dhe u largova", tha dëshmitari Kiki

ALIMI NUK PËRMENDET, GISHTI DREJT GURIT

Me të hyrë në komunë, para zyrës së KZK-Çair, kishte pritje të gjata. Nuk më kujtohet se kush ishte me mua. Ndërkohë, Ismet Guri dhe Qani Toçi si anëtarë të KZK-së, m'i kërkuan procesverbalet, gjegjësisht Guri më tha se të njëjtat duhet të përmirësohen për arsye të marrëveshjes që kanë me VMRO-DPMNE-në. Unë ashtu edhe veprovë. Më pas i dorëzova materialet dhe u largova", tha dëshmitari Kiki.

Pas deklaratës së dëshmitarit Veton Kiki, se i akuzuari Ismet Guri ia kishte përmendur marrëveshjen me VMRO-DPMNE-në, pati një shkëmbim fjalësh mes dëshmitarit dhe të akuzuarit, me çka prokurorja speciale Fatime Fetaj, kërkoi që gjykata ta ndalojë bisedën mes personave të theksuar. Përves prokurorëve dhe avokatëve, dëshmitarit Kiki pyetje direkte i parashtrori edhe i akuzuari Ismet Guri, gjegjësisht kërkoi të sqarojë se kujt ia kish të dorëzuar materialet dhe vulat.

"Personalisht ty dhe Qani Toçit ua kam dorëzuar vulat. Ndërsa, kush i ka vulosur procesverbalet, nuk e di", theksoi Kiki. Njëkohësisht, pyetje të drejtpërdrejta dëshmitarit Kiki i parashtrori edhe kryesuesja e Këshillit Penale, gjykatësja Olja Ristova, e cila shtroi çështjen e mos denoncimit të shkeljeve ligjore që janë bërë në Zgjedhjet Lokale të vitit 2013 në Çair, nga ana vetë dëshmitarit.

"Po, e saktë është se unë nuk i kam de-

noncuar këto parregullsi. Por, me vetë faktin se mua më tha se e gjithë kjo procedurë realizohet në marrëveshje me VMRO-në, për mua paraqiste një kërcënim indirekt. Atë kohë, VMRO ishte në pushtet. Ndërkohë unë isha i punësuar si nëpunës shtetëror. Kjo është shkak kryesor se pse nuk i kam paraqitur këto shkelje para organeve kompetente", potencoi Kiki.

Në mesin e dhjetëra dëshmitarëve për rastin "Titanik3", të martën foli edhe dëshmitari Muhamet Osmani, i cili në Zgjedhjet lokale të vitit 2013 në Çair, kishte qenë i deleguar si zëvendësanëtar i KZK-Çair. Për dallim nga dëshmitari Kiki, Osmani në deklaratën e tij nuk përmendi ndonjë çështje kyçe që lidhet me parregullsitë që i heton PSP-ja, por shtoi se prezencën e tij në KZK-Çair nuk ka qenë e vazhdueshme dhe se kohë pas kohë ka dalë për të bërë pushime të vogla. Ngjashëm si parafolësi i tij, edhe ky dëshmitar para Gjykatës Penale të Shkupit theksoi se ditën e zgjedhjeve, në mars të vitit 2013, nuk e kishin parë apo vërejtur prezencën e Ejup Alimit, i akuzuar për rastin "Titanik 3". Ndryshe, vazhdimi i procesit zgjedhor "Titanik 3", sipas të gjitha gjaseve, pritet të vazhdojë në muajin dhjetor, pasi PSP në publikimin e orarit të saj në ueb faqe nuk ka njoftuar se gjatë muajit nëntor është caktuar ndonjë seancë për këtë lëndë gjyqësore.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 30 tetor - Korrigjimi i procesverbaleve për zgjedhjet lokale në Çair në vitin 2013 nga funksionar të BDI-së është realizuar në marrëveshje me VMRO-DPMNE-në. Në rrëfimin e tij, Veton Kiki, dëshmitar i Prokurorisë Speciale Publike në rastin "Titanik 3", tha se Ismet Guri, gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore në Komisionin Zgjedhor Komunal (KZK), në Çair, i ka thënë se përmirësimi i procesverbaleve duhet të bëhet për shkak se ashtu janë marrë vesh me VMRO-në.

"Procesi zgjedhor gjatë ditës u zhvillua në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Me përmbylljen e vendotimeve, ne si Këshill zgjedhor filluam numërimin dhe mbledhjen e votave (materialeve). Diku para apo pas mesnate, nën shoqërimin e policisë i dërguam materialet në KZK-Çair.

Policia intervenoi me dy orë vonesë

Shkup, 30 tetor - Policia e shtetit intervenoi me saj kundër turmës së dhunshme në parlament më 27 prill 2017 e ka filluar dy orë me vonesë. Prezantimi i pamjeve nga kamerat e sigurisë në seancën e ditës së martë për rastin e "27 prillit", tregoi qartë se pjesëtarë të uniformuar të Ministrisë për Punë të Brendshme, në Sallën për konferenca futen rreth orës 20:50.

Publikimi i video materialit nga Prokuroria për krim të organizuar ka sqaruar veprimin e njëjësive speciale të policisë, me çka një pjesë e tyre ndalen në hyrjen e korridorit



që shpie drejtë Sallës për konferenca dhe pjesa tjetër nisat drejtë sallës së theksuar.

Pastrimi i terrenit dhe largimi i turmës së dhunshme është realizuar me ndihmën e gazit lotsjellës dhe shok bombave.

Ndryshe, prej kohës kur turma e dhunshme afrinë deri te Salla e konferencave e deri te intervenimi i policisë, qartë mund të shihet lëvizja e shefit të sigurimit të Trajko Veljanovskit, i akuzuari Goran Gjoshevskit, i cili vazhdimisht komunikoi me personat me maska dhe nuk e largon telefonin nga dora. (O.Xh)

KRONIKË

Arrestohet 47 vjeçari, maltretoi fëmijën

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme Tetovë - Stacioni policor në Gostivar, të hënë rreth ora 11 e 45 minuta, ka arrestuar 47 vjeçarin B.C. nga Gostivari, i dënuar me tre vite burg, për kryerje të veprës penale "moskujdesje dhe maltretim ndaj fëmijës së mitur" që sanksionohet sipas nenit 201 nga Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. Pas arrestimit dhe mbajtjes në Stacionin policor në Gostivar, të realizuar me urdhër të gjykatës, personi B.C. është dorëzuar në burgun e Tetovës për vuajtje të dënimit.

Burri keqtrajton gruan në Leshkë

53 vjeçarja banore e fshatit Leshkë, të hënë ka denoncuar dhunë familjare, të cilën rreth orës 14 e 30 minuta e ka kryer ndaj saj bashkëshorti i saj 50 vjeçar, i cili e ka fyer dhe e ka maltretuar psikikisht, bashkë me dy fëmijët e tyre minore dhe babain dhe nënën e tij. I denoncuar është privuar nga liria dhe mbajtur në Stacionin policor në Tetovë. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Ndalohe katër të rinj, kapen me marihuanë

Të hënë mbrëma rreth orës 21.00 në rrugën "Dimo Gavroski" në Tetovë, pjesëtarët e policisë kanë vërejtur katër persona, prej të cilëve njëri menjëherë ka ikur, ndërsa tre tjerët kanë qëndruar në vend. Gjatë kontrollit të kryer nga pjesëtarët e policisë, është vërtetuar se bëhet fjalë për persona të mitur të moshës nga 14 deri 17 vjet, ku në afërsi të tyre është gjetur marihuanë, të cilën në ndërmjet kohë e ka hedhur njëri prej tyre. Minorenët janë dërguar në Stacionin policor në Tetovë për zbardhjen e plotë të rastit.

Aksident afër kthesës së Kamjanit

Të hënë mbrëma rreth orës 18 e 45 minuta, në autostradën Gostivar-Tetovë, në afërsi të kyçes për në fshatin Kamjan, vetura e tipit "Pezho 406", me targa të Tetovës, e drejtuar nga 54 vjeçari F.Sh nga fshati Zhevrovjan, ka aksidentuar një qen endacakë, i cili në mënyrë të pakontrolluar ka lëvizur nëpër autostradë. Nuk ka persona të lënduar në veturë, ndërsa është konstatuar dëmi i dukshëm material. Gati se në të njëjtin vend, pak më vonë, vetura e tipit "Ford Mondeo" me targa të Tetovës, të cilën e ka drejtuar 34-vjeçari B.Q. nga fshati Xhepçisht, gjithashtu ka aksidentuar dhe ka mbytur në vend një qen tjetër. Edhe në këtë aksident nuk ka pasur persona të lënduar. (U.H)

“Në Maqedoni, të rinjtë kanë nevojë për qasje më të mirë të shërbimeve shëndetësore seksuale, sepse janë në vendin e fundit të listës në Evropë për përdorimin mjeteve kontraktive, por kryesojnë në listë për aborte dhe shtatzëni të tinxherëve. Pra, jemi lider në diçka që nuk është e mirë për shëndetin dhe mirëqenien e tonë”, thonë nga HERA

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 30 tetor - Edukimi seksual ka shumë kohë që flitet, megjithatë asnjëherë nuk është marrë një vendim në lidhje me futjen e saj në shkolla ose edhe informimin në përgjithësi. Në fakt, edukimi seksual nuk i referohet vetëm aktit, por një fushe më të gjerë termash si trupi i njeriut, gjinia, anatomia seksuale, shëndeti e orientimi seksual, riprodhimi, shtatzënia e shumë koncepte të tjera.

Të rinjtë në Maqedoni nuk kanë qasje të mjaftueshme në informacione në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të drejtave seksuale, ndërsa këtë e konfirmojnë për gazetën KOHA edhe organizata joqeveritare HERA, e cila kryesisht merret me shëndetësin seksual tek të rinjtë dhe nxënësit. “Në Maqedoni, të rinjtë kanë nevojë për qasje më të mirë të shërbimeve shëndetësore seksuale, sepse janë në vendin e fundit të listës në Evropë për përdorimin mjeteve kontraktive, por kryesojnë në listë për aborte dhe shtatzëni të tinxherëve. Pra, jemi lider në diçka që nuk është e mirë për shëndetin dhe mirëqenien e tonë”, thonë nga HERA.

Gjendja shëndetësore e të rinjve, thonë në këtë organizatë, është shqetësuese, ndërsa shqetësuese është edhe sjellja dhe dhuna që janë gjithnjë e më të përhapura. Huluntimet që organizata HERA i ka kryer në shkolla tregojnë se vetëm 13 për qind e

KËRKOHET EDUKATA SEKSUALE EDHE NË SHKOLLA

MAQEDONIA KRYESON LISTAT PËR ABORTE



Ndryshe nga Maqedonia, në Shqipëri, edukimi seksual në shkollat e mesme të Tiranës përveç informacionit teorik, këtë vit do të pasurohen edhe me elementë praktikë të përdorimit të metodave kontraktive. Ndërsa në Kosovë, ngjashëm sikurse tek ne, edukimi seksual mbetet ende tabu temë

nxënësve dinë se çfarë është prezervativi dhe 2 për qind e di se çfarë janë kontraktivët oralë.

Këtë vit ka pasur dy raste të regjistruara kur vajzat kanë pasur shtatzëni të padëshirueshme, ndërsa vetëm 1.6 për qind e të rinjve nën moshën 29 vjeç përdorin kontraktivë oralë dhe vetëm 12.8 për qind e çifteve përdorin kontraktiv modern. Mes të tjerash, nga HERA thonë se zbatojnë arsim joformal nëpërmjet kolegëve në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në qendrat tona arsimore. Në vitin 2017, 300 të rinj nga mbarë vendi kaluan disa trajnime lidhur me këtë temë, të cilat janë të rrenjosura thellë në jetën e përditshme dhe interesi për këto tema është në rritje.

“Këto parametra shqetësuese janë ndër arsyet se pse ne mendojmë se edukimi gjithëpërfshirës i seksualitetit duhet të

bëhet pjesë e sistemit arsimor për të rinjtë që të informohen brenda institucioneve arsimore ku ata kalojnë shumicën e kohës gjatë ditës”, thonë nga HERA.

Nga Ministria e Arsimit gjithashtu theksuan se janë në bisedime si me Ministrin e Shëndetësisë, por edhe institucione të tjera për të avancuar edukimin seksual në mënyrë që të parandalojnë sëmundjet e ndryshme transmetuese, shtazënitë e padëshirueshme dhe mbrojtjen sa më efikase të shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve, edhe pse, thonë në MASH, ka në programin mësimor lëndë ku janë të përfshira këto tema.

Rritje të vetëdijes për mbrojtje nga sëmundjet e transmetueshme seksuale dhe edukimin seksual kërkojnë edhe studentët e fakulteteve të mjekësisë. Studenti i mjekësisë, Bujar Islami, për KOHA thotë se organiza-

ta e ndryshme në bashkëpunim me udhëheqësinë e shkollave, pse jo dhe Ministria e Arsimit duhet të fillojnë fushatë dhe të angazhohen së bashku për rritjen e vetëdijes seksuale tek të rinjtë dhe ti edukojnë se si të mbrohen nga sëmundje të ndryshme dhe aborti.

Psikologët ndërkohë shprehin se kjo lëndë duhet të jetë pjesë e programit mësimor dhe ti kushtohet rëndësi, sepse gabimet më të mëdha bëhen nga mos informimi i mjaftueshëm dhe kurioziteti, ndërsa për këtë temë janë duke kryer analiza të cilat do të publikohen pas tre muajve.

Sipas Instituti për Shëndet Publik, në fund vitin e kaluar, numri total i pacientëve të prekur nga sëmundjet më të përhapura seksuale është me infeksionin chlamydia (137 persona), Hepati B dhe C (72-29) dhe më shqetësuese SIDA me 43 të prekur.

Ndryshe nga Maqedonia, në Shqipëri, edukimi seksual në shkollat e mesme të Tiranës përveç informacionit teorik, këtë vit do të pasurohen edhe me elementë praktikë të përdorimit të metodave kontraktive. Ndërsa në Kosovë, ngjashëm sikurse tek ne, edukimi seksual mbetet ende tabu temë.

Keqtrajtojnë 13-vjeçar, paraburgim për tre të rritur

Gostivar, 30 tetor - Gjykatës i procedurës paraprake nga Gjykata Themelore Gostivar tre personave të dyshuar për sulm gjinor ndaj një fëmije u caktoi masë paraburgimi prej 30 ditëve. Paraprakisht, me kërkesë të prokurorit publik, i cili vendosi procedurë, të treve fillimisht u caktoi paraburgim afatshkurtër prej 48 orëve. Në Prokurorinë Themelore Publike Gostivar është sjellë procedurë kundër tre personave për të cilët ekziston dyshim se disa herë kanë kryer vepër penale sulm gjinor mbi një fëmijë, i cili nuk ka mbushur 14 vjeç nga neni 188 paragrafi 1 në lidhje me nenin 45 nga Kodi Penal. Prokuroria në procedurë ka dyshime bazë se në kryerjen e kësaj veprë penale kanë marrë pjesë të dyshuarit, por edhe persona të tjerë për të cilët për momentin po ndërmerren aksione për gjetjen dhe identifikimin e tyre. Fëmija i moshës nga 13 vjeç disa herë është keqtrajtuar nga ana e personave të rritur. Prokurori publik kompetent dha urdhra dhe drejtime për konfirmim të mëtejshëm të lidhshmërisë së mëtejshme midis të dyshuarve të involvuar. Sipas informatave fillestare ekziston mundësi që në lëndë të përfshihen edhe persona të tjerë, njoftojnë nga Prokuroria Publike. Me urdhër të Prokurorisë fëmija është nën kujdesin e Qendrës për punë sociale. (U.H)

Hajnat vodhën 680 mijë denarë nga “Dërgesa e shpejtë”

Shkup, 30 tetor - Plaçkitësit kanë marrë 680.000 denarë nga hapësirat e firmës “Dërgesa e shpejtë” në lagjen Aerodrom. Sektori i Punëve të Brendshme Shkup, deri te Prokuroria Themelore Publike në Shkup, parashitroi padi penale kundër A.R (33) nga Shkupi për shkak ekzistimit të bazave për dyshim se ka kryer vepër penale “plaçkitje” dhe kundër L.A (18) nga Shkupi për shkak bazave për dyshim se ka kryer vepër penale “ndihmim”, ku kanë përfituar pronësi kundërligjshme prej rreth 680.000 denarë. Më 27 tetor, në bazë të urdhrit gjyqësor është bastisur shtëpia e të denoncuarit A.R në rrugën “Todor Çangov”, ku ka qenë edhe L.A. Gjatë kontrollit janë gjetur armë plastike dhe gjësende që lidhen me veprën penale. Të dy janë privuar nga liria, ndërsa është bërë edhe identifikimi i të denoncuarve nga ana e të dëmtuarës.

Edhe një vit vazhdon “situata e krizës” në kufirin jugor dhe verior

Shkup, 30 tetor - Qeveria propozon që deri më 30 qershor të vitit 2019 të vazhdojë situata e krizës në kufirin jugor dhe verior me qëllim për parandalimin dhe pengimin për hyrjen e emigrantëve transit në Republikën e Maqedonisë. Propozim vendi-

mi për ndryshimin e Vendimit për miratimin e vazhdimin të afatit për ekzistimin e krizës për shkak të rritjes së fluksit për hyrje dhe transit të emigrantëve në territorin e Republikës së Maqedonisë tanimë është dorëzuar në Kuvend, ku duhet të sh-

qyrtohet nga Komisioni amë dhe të votohet në seancë plenare Qëllimi për vazhdimin e këtij vendimi është për të siguruar vazhdimësi në kryerjen e aktiviteteve nga ana e Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe forcave të sigurisë të Ministrisë

për Punë të Brendshme, në funksion të sigurimit, mbrojtjes dhe ruajtjes të kufirit shtetëror. Situata e krizës për shkak të fluksit të emigrantëve në kufirin e Maqedonisë u shpall në vitin 2015, dhe prej atëherë ende vazhdon.

CAROVSKA PREMTON NDRYSHIME LIGJORE VITIN E ARDHSHËM

TË DEFINOHET FAMILJA ME NJË PRIND

Në nivel ndërkombëtar, shumica e madhe e familjeve me një prind janë nënë me një fëmijë/shumë fëmijë, në Evropë kjo përqindje është 80 për qind nëna me fëmijë, ndërsa në Maqedoni përqindja është akoma më e madhe. Shifra gri do të thotë se në Maqedoni ka rreth 20 mijë familje me një prind



blemit. Ajo tha se shifra gri do të thotë se në Maqedoni ka rreth 20 mijë familje me një prind. Në nivel ndërkombëtar shumica e madhe e familjeve me një prind janë nënë me një fëmijë/shumë fëmijë, në Evropë kjo përqindje është 80 për qind nëna me fëmijë, ndërsa në Maqedoni përqindja është akoma më e madhe. "Në Maqedoni, më shumë se 80 për qind e familjeve janë me një prind dhe fëmija kujdeset nga nëna", tha Paçkova. Mersiha Ismailoviq nga Legis, tha se në Ligjin për familjen nuk ekziston definicion i qartë i nocionit "familje", ndërsa kërkoi ndryshime urgjente të Ligjit. "Nevojitet ndryshim të Ligjit ku do të përfshihen fëmijët që vijnë nga familje me një prind, ndërsa Ligji për mbrojtje të fëmijëve në dispozitat e saj nuk përgjigjet për një familje me një prind, as nuk lidhet me të dhënat e caktuara të kësaj familje. Po ashtu, duhet të definohen nocionet se çdo të thotë një prind i vetëm", tha Ismailoviq.

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 30 tetor - Definimi i familjes me një prind pritet vitin e ardhshëm, Në vitin 2019 do të hapet Ligji për familje me qëllim që të intervenohet në të dhe të jepet përkufizim i qartë për atë që paraqet ky konstrukt familjar. Megjithatë, përkufizimi do të jetë pjesë e një procesi më të ndërlikuar i definimit të të gjitha llojeve të familjeve tjera, të cilat ekzistojnë në praktikë, ndërsa nuk njihen me vendime ligjore. Këtë dje e theksoi ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska, në tryezën e rrumbullakët "Të drejta të barabarta dhe mundësi për nënat beqare", në të cilën u

prezantua analiza e parë e punuar tek ne për gjendjen e familjeve me një prind të nënave kryefamiljare në Republikën e Maqedonisë.

Një nga rekomandimet në analizën është pikërisht definimi i terminit prind beqar dhe familje me një prind në norma përkatëse ligjore. Mosekzistimi i definimit përkatës për prind beqar dhe familje me një prind paraqet problem, por edhe pikë nismëtare për njohje të drejtë dhe trajtim juridik të këtyre familjeve në Maqedoni, theksohet në analizën e punuar nga shoqata "Një mundet". "Tek ne kur diskutohet për

familje, shumë vështirë hapet kjo çështje. Familja jonë nuk evoluon, nuk ka zhvillim në definimin e familjes në Maqedoni. Ky është një proces i ndërlikuar për të cilin duhet të ketë debat", tha Carovska. Gjatë definimit të familjes me një prind, thotë ministria, duhet të precizohet çka do të thotë saktë.

"Vallë nëse prindi tjetër ekziston, është i pranuar dhe paguan alimentacion bëhet fjalë për një familje me një prind, për shkak se këtu kemi mjete financiare, por edhe prani të prindit tjetër. Me të drejtën diskrete të sistemit të mbrojtjes sociale, duhet të vërte-

tohet nëse kjo prani është e vërtetë apo jo. Nëse prindi tjetër paguan vetëm mjete financiare dhe nuk është i pranishëm në rritjen e fëmijës, atëherë me siguri këtë do ta definojmë si familje me një prind, sepse kemi nevojë për shërbim si mbështetje për menaxhimin e kësaj familje", thotë ajo. Carovska shtoi se për shembull nëse nëna punon në furrë dhe shkon në punë në ira katër "nuk do të mbështetemi tek gjyshet nëse jemi shtet serioz".

Kryetarja e shoqatës "Një mundet", Doroti Paçkova theksoi se në analizë përpunohen aspekti juridik dhe kulturologjik i pro-

ndryshe, sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistika, në Maqedoni janë regjistruara 38.988 familje me një prind, nga të cilat 31.074 ose 79.7 për qind janë familje me nënë vetëm dhe 7.914 ose 20.3 për qind familje me baba të vetëm. Në territorin e Shkupit ka më shumë se 12 mijë familje me një prind, nga ato 9665 janë nëna të vetme dhe 2346 me baballarë të vetëm.

PUNËTORI PËR PLANIN VEPRUES TË SËMUNDJEVE JOINFEKTUESE

NJË NË TRE NXËNËS KA TEPRICË KILOGRAMËSH

Shkup, 30 tetor - Në Maqedoni, tre të katërtat e rasteve të vdekjes ndodhin falë sëmundjeve joinfektuese. Ushqimi i shëndetshëm nuk duhet të jetë përtej mundësive të njerëzve më të varfër. Një prej tre fëmijëve në shkollë kanë tepriçë kilogramësh apo mbipeshë. I domosdoshëm është aktiviteti fizik i pjesëmarrësve dhe promovimi i zbatimit të mënyrës së shëndetshme të ushqyerjes. Këtë të martën e theksuan pjesëmarrësit në punëtorinë dyditore multisektoriale për implementimin e Planit veprues të sëmundjeve joinfektuese në Republikën e Maqedonisë në organizim të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçev, në hapjen e punëtorisë tha se duhet të ndryshohet mënyra e jetesës, sepse, siç tha, gjithnjë e më shumë njerëzit konsumojnë ushqim me energji të larë, me koncentrim të larta të yndyrave të ngopura dhe trans, kripë dhe sheqer, ndërsa shumë pak pemë dhe perime dhe nuk janë aktiv fizikisht. Qeveria e Maqedonisë, theksoi ai, vazhdon me vëzhgimin e Nismës së OBSH-së për



ndjekjen e mbipeshës te fëmijë në vendin tonë përmes Programit kombëtar për shëndet publik.

Sipas tij, qëllimi është të iniciohet implementim multisektorial i Planit të veprimit për sëmundjeve joinfektuese, si dhe planifikimi i hollësishëm i veprimeve për periudhën e viteve 2019-2020. Shefi i Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë

në Maqedoni, Xihane Tavila tha se tre të katërtat e të gjitha sëmundjeve në Maqedoni janë falë sëmundjeve joinfektuese që është rritje e konsiderueshme. Drejtori i Zyrës së OBSH-së për sëmundje joinfektuese në Mosk, Zhao Breda tha se Maqedonia është në majën e grupit të vendeve në të cilat prevalenca e mbipeshës është mbi 30 për qind. (D.K)

Prodhimtaria industriale rritet për 4.5 për qind

Shkup, 30 tetor - Prodhimtaria industria në shtator është rritur për 4.5 për qind në krahasim me të njëjtin muaj vitin e kaluar, ndërsa rritje prej pesë për qind ka edhe për periudhën janar-shtator. Sipas të dhënave që sot i publikoi Enti Shtetëror për Statistikë, rritje është shënuar në sektorët Minierë dhe nxjerrje të gurëve për 4.7 për qind, Industri përpunuese për 3,6 për qind dhe në Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicionerë për 19.2 për qind. Rritja në sektorin Industri përpunuese është rezultat, para së gjithash, i prodhimit të rritur të prodhimeve ushqimore, pijeve, tekstilit, prodhimeve themelore farmaceutike, si dhe prodhimit të metalëve, makinave dhe veglave, automjeteve dhe mobiljeve. Sipas grupeve kryesore industriale, rritje është shënuar tek Energji për 15.5 për qind, Prodhime intermediare, përveç energjisë për 5.1 dhe Prodhime kapitale për 14.9 për qind. Rënie ka tek Prodhimet e qëndrueshme për konsum të gjerë dhe Prodhimet e paqëndrueshme për konsum të gjerë.

Shekerinska ka rikujtuar se buxheti i Maqedonisë këtë vit është rritur për 15 për qind, ndërsa paralajmëroi se e njëjta do të vazhdojë të rritet sipas dinamikës së përcaktuar për çdo vit

Shkup, 30 tetor - Bashkë me kolegët e tyre më të vjetër dhe me përvojë do të jeni shtyllë e shtetësisë dhe sovranitetit të atdheut tonë. Ju jeni ata që fjalët patriotizëm, guxim, sakrificë nuk do të jenë vetëm fjalë, por do të jenë mënyrë e jetesës. Pa ju dhe profesionalizmin tuaj nuk do të mund të flasim për pavarësi, mëvetësi, siguri, përparim ekonomik dhe prosperitet në Republikën e Maqedonisë. Kjo ka qenë porosia e zëvendëskryeminstres dhe ministres së Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në promovimin e 125 ushtarëve të rinj profesional në Armatën e Republikës së Maqedonisë në kazermën "Ilinden" në Shkup.

"Ky tren ku jemi të gjithë bashkë, është në vijë të shpejtë. Shkon përpara dhe nuk guxon të ndalet. Ju ftoj të gjithëve, ba-

PROMOVOHEN USHTARËT E RINJ NË KAZERMËN "ILINDEN" EDHE 125 USHTARË TË RINJ PROFESIONAL TË ARM-SË



shkë të jemi më të mirë, më efikas dhe më profesional", ka porositur Shekerinska, duke shtuar se kanë kaluar proces të vështirë të testit, ndërsa tani ka shtuar se "do t'u nevojitet energji e njëjtë dhe përkushtim që të dëshmojnë se sa mund t'i ofrojnë RM-së".

"E kemi mbajtur fjalën edhe në raport me prioritetet strategjike. Paralelisht me pranimin tuaj, në ARM kemi filluar edhe me bisedimet paraqasëse me

NATO-n që ky vend i ka pritur veç më 10 vite. Jam e bindur se bisedimet paraqasëse do të jenë të shpejta, efikase dhe cilësore. Do të jeni krenar që secili prej nesh me punën tuaj dhe profesionalizëm, do të mund të jep kontributin personal ndaj këtij procesi të integritetit që do të sjell erë të re për Maqedoninë si anëtare e 30-të e NATO-s", ka thënë mes tjerash në paraqitjen gjatë promovimit të ushtarëve të rinj profesional, ministria Shekerinska.

Ajo ka porositur se përgjegjësia para tyre është dhe do të jetë e madhe.

Shekerinska ka rikujtuar se buxheti i Maqedonisë këtë vit është rritur për 15 për qind, ndërsa paralajmëroi se e njëjta do të vazhdojë të rritet sipas dinamikës së përcaktuar për çdo vit.

"Nga ajo nuk ka zmbarsje. Të punësuarit këtë vit pas vitesh të gjata për herë të parë fituan rritje të rrogës për 10 për qind. Këtë vit për herë të parë arritëm të nënshkruajmë marrëveshje për furnizim të çizmeve, vazhdojmë me furnizimin e uniformave të reja", ka thënë ajo, duke shprehur bindjen se vitin e ardhshëm do të mund të jemi më ambicioz dhe të fokusohemi në procesin kryesor, e që ka të bëjë me modernizimin dhe pajisjen e cila do të sjell teknikë dhe teknologji të re dhe avancuese. Mes tjerash ka thënë se sillen ndryshime dhe zhvillim edhe në arsimin ushtarak.

Dyfish më shumë dënime për ndotësit

Shkup, 30 tetor - Intensifikojmë seriozisht aktivitetet e shërbimeve inspektuese dhe në shtator janë shqiptuar 132 dënime mandatore gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes së kapaciteteve që punojnë me licenca B dhe janë në kompetencë tonë, gjatë kontrollit të objekteve ndërtimore, si dhe të personave të cilët në mënyrë joadekuatë i kanë trajtuar mbeturinat. Aktivitetet intensive vazhduan edhe këtë muaj dhe deri më tani në tetor janë shqiptuar 220 vërejtje dhe 137 dënime mandatore. Këtë e theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov në seancën e sotme të njëzetë të Këshillit të Qytetit të Shkupit, në të cilën janë parashtruar pyetje të këshilltarëve. Një pjesë e pyetjeve kishin të bëjnë me ndotjen e ajrit ambiental dhe aktivitetet e inspektoratit të qytetit. "Në tetor në territorin e Qytetit të Shkupit është kryer kontrolli i përforcuar i kantierëve të ndërtimit në të gjitha komunat. Në këtë periudhë janë kryer kontrole në më shumë se 50 lokalitete ku kryhen aktivitete ndërtimore, me ç'rast kryerësve u thuhet të mos dilet nga kantieret në rrugë me kamionë me rrota të zhytura dhe të pambuluara. Në periudhën që pason do të vazhdojnë kontrollet e përforcuara dhe nëse konstatohet shkelje e ligjit, pasojnë dënime përkatëse për personat juridikë dhe fizikë", shtoi Shilegov.

Publicitet

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

KONKURS

Për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëndët profesionale - artistike në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI I ARTEVE

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Vizatim
 - Vizatim me pikturë

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore në lëndët profesionale-artistike docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore në lëndët profesionale-artistike, të parapara me nenin 167 të Ligjit për arsimin e lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Universiteti i Tetovës

Në bazë të nenit 2 pika 2 dhe pika 10, nenit 4, 46, 48 dhe 49 nga Ligji për përdorimin dhe asgjësimin e mjeteve në pronësi të shtetit dhe mjeteve në pronësi të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës" nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15) Komisioni për asgjësimin e mjeteve të tundshme dhe të patundshme në pronësi të IPSH Qendra Klinike Stomatologjike Universitare Shën Pantelejmon, e publikon këtë:

SHPALLJE Nr. 01/2018 për shitjen e mjeteve të tundshme

1. Lëndë për shitje përmes ankandit elektronik publik janë mjete të tundshme: karrige stomatologjike, aparate stomatologjike, instrumentet mbjellëse, instrumentarium i imët, karrige për zyrë, kompjuterë, monitorë, kasa fiskale, makina për larjen e robave etj.

Mjetet e tundshme të cilat janë lëndë për shitje mund të shikohen në hapësirat e bodrumeve të IPSH Qendra Klinike Stomatologjike Universitare Shën Pantelejmon, në rr. Nëna Terezë 17 Shkup çdo ditë pune nga ora 12.30 deri 14.30. Mjetet shiten nëpërmjet sistemit e parë-e shitur, ankesa shtesë nuk pranohen.

2. Çmimi fillestar për ankandin elektronik për mjetet e tundshme nga pika 1 është 2.300,00 denarë.

3. Ankandit publik për shitje të mjeteve të tundshme nga pika 1 do të mbahet më 15.11.2018 në orën 10:30.

4. Të drejtë në pjesëmarrje në ankandin elektronik kanë të gjithë personat fizik dhe juridik vendas dhe të huaj të cilët mund të fitojnë pronësi të mjeteve të tundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

5. Dokumentet e nevojshme për pjesëmarrje në ankandin elektronik
Pjesëmarrësit e ankandit publik janë të detyruar që në mënyrë elektronike të parashtrorin:
- fletëparaqitje për pjesëmarrje, dhe
- garancia bankare për seriozitet të ofertës në vlerë prej 2% nga shuma e përcaktuar e mjeteve të tundshme;

Kërkesa për ankandin elektronik parashtrorët në mënyrë elektronike në internet adresën:
e-aukcii.finance.gov.mk

Në bashkëngjitje me fletëparaqitjen, aplikantët gjithashtu duhet të parashtrorin edhe:

a) për personat juridik
- situatën aktuale nga regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht dokument adekuat i lëshuar nga organi kompetent nga vendi ku është regjistruar subjekti juridik;
Garancia e bankës për seriozitet të ofertës është 2% nga shuma e vlerësuar, deri në skadimin e afatit për paraqitje, parashtrorët në formë të shkruar (në origjinal) deri te Komisioni për kryerjen e veprimtarive për shitje të mjeteve të tundshme dhe patundshme me pronësi të JZU Qendra klinike stomatologjike Universitare Shën Pantelejmon, rr. Nëna Tereza 17, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë. Informacione në telefonin: personi kontaktues kryetari i Komisionit për asgjësimin e mjeteve të tundshme Gordana Maksimovska - 075 333 054 (çdo ditë pune prej orës 09.00 deri 14.00)

b) për persona fizik
- kopje nga letërnjoftimi ose pasaporta

6. Afati për paraqitje
Për paraqitje në ankandin elektronik, pjesëmarrësit janë të detyruar që në mënyrë elektronike të paraqiten deri më ditën e 12-të, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore dhe internet faqen.
Parashtruesve të cilët janë paraqitur në mënyrë të rregullt në sistemin e ankandit elektronik publik, në afat prej 3 ditësh pas skadimit të kohëzgjatjes së shpalljes, komisioni do t'ju dërgojë një emër përdoruesi dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin elektronik. (shpjegim: këtë e formon dhe e dërgon sistemi automatik)

7. Mënyra dhe procedura për zbatimin e ankandit publik
1. Për mbajtjen e ankandit publik, duhet së paku të ketë një pjesëmarrës.
2. Si ofruer më i favorshëm në ankandin elektronik, konsiderohet ai pjesëmarrësi i cili e ka ofruar çmimin e fundit, që përfaqëson çmimin më të lartë për shitjen e mjetit të tundshëm.
3. Ofruer më i volitshëm është i detyruar që në afat prej 15 ditë nga pranimi i njohimit me shkrim për zgjedhje, të paguan mjetet në pajtim me çmimin përfundimtar të arritur nga ankandit, në të kundërtën nuk do të merren masa për lidhjen e marrëveshjes, ndërsa garancia e bankës për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofruer në një afat prej 1 viti nuk do të mund të marr pjesë në çdo ankand të ardhshëm publik për lëndën e mjeteve të tundshme.
4. Bartësi i të drejtës për pronësi me çmimin më të volitshëm, do të lidh marrëveshje për blerje-shitje në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas kryerjes së pagesës për mjetet e tundshme.
5. Pjesëmarrësit në ankandin elektronik kanë të drejtë të kundërshtojnë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik. Komisioni vendos pas kundërshtimit me vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i kundërshtimit. Kundër vendimit të Komisionit mund të paraqitet ankesë deri tek komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurën administrative dhe procedurën e marrëdhënieve të punës në shkallë të dytë.

8. Internet faqja në të cilën do të mbahet ankandit publik
Ankandit publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim:
e-aukcii.finance.gov.mk

Komisioni për zbatimin e procedurave për shitje të mjeteve të tundshme

PAS SHUMË PREMTIMESH DHE ZHAGITJESH

NIS NDËRTIMI I URËS NË SHIPKOVICË

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 30 tetor - Më në fund ka filluar rregullimi i urës mbi fshatin Shipkovicë për në Brodec. Punët e para që janë duke u zhvilluar është hapja e një rruge alternative që të mos pengojë lëvizjen e lirë të banorëve të fshatrave Bozovë, Veshallë dhe Bordec për në Tetovë dhe anasjelltas, sepse kjo është rrugë e vetme. "Për momentin, është duke u bërë gërmimi dhe rregullimi i një rruge alternative që mos të ndërpritet lëvizja e qytetarëve në atë pjesë të Malësisë, ku po punohet në rregullimin dhe ndërtimin e urës në mes të fshatit Shipkovicë dhe Brodec që do të normalizojë në masë të madhe komunikacionin në drejtim të këtyre fshatrave pas vështirësive të mëdha që kanë hasur për shkak se pas çdo reshje të shiut është bllokuar gjithmonë rruga", tha Arsim Nuredini, shef i Sektorit për veprimtari komunale, mbrojtje të ambientit dhe natyrës.

Në një pjesë ku edhe kalon një përrua, reshjet sjellin me vete më shumë rërë dhe në këtë pjesë gjithmonë bllokohet dhe është e pakalueshme. E pikërisht kjo është rrugë e vetme që lidh fshatrat Brodec, Veshallë dhe Bozovë me Tetovë. Tashmë ka një vit që e njëjta është

"Me këtë rast, projekti është si vijon, ura me dimensione 8m gjatësi dhe 5m gjerësi dhe nga gjysëm metër trotuar në të dyja anët, projekt ky që sapo ka nisur dhe shpresojmë të përfundojmë në një afat sa më të shpejtë kohorë varësisht nga kushtet atmosferike, do të kushtojë gjithsej 100.000 mijë euro", tha Nuredini



asfaltuar, megjithatë sërish bllokohet sidomos në muajt e pranverës dhe vjeshtës. Nuredini më tej ka dhënë sqarime edhe për ndërtimin e urës të shumëpremtuar në këtë pjesë të Malësisë së Sharrit, ku gjithmonë rruga bllokohet gjatë reshjeve. "Me këtë rast, projekti është si vijon, ura me dimensione 8m gjatësi dhe 5m gjerësi dhe nga gjysëm metër trotuar në të dyja anët, projekt ky që sapo ka nisur dhe shpresojmë të përfundojmë në një afat sa më të shpejtë kohorë varësisht nga kushtet atmosferike, do të kushtojë gjithsej 100.000 mijë euro", tha Nuredini. Kohë më parë u paralajmërua ndërtimi i urës në këtë vend nga ana e Komunes së Tetovës dhe Byrosë

Rajonale për Zhvillim.

"U aprovuan mjetet financiare në vlerë prej 3.5 milionë denarë për ndërtimin e urës Shipkovicë-Brodec. Siç e keni të njohur të gjithë, ne e kemi ndërtuar atë rrugë, po ashtu kemi vazhduar edhe me projektimin e urës, sepse vlerësoj se ka nevojë për qytetarët e asaj pjese. Vlera e përgjithshme e projektit kapë vlerën 7.5 milionë denarë. Byroja për Zhvillim na përkraha me 3.5 milionë denarë, kurse katër milionët e mbetur tashmë vetëm janë të alokuar në buxhetin e Komunes së Tetovës", tha Arifi. Ndërkohë, nga dhe Byroja Rajonale për Zhvillim në atë kohë nënvizuan se me rëndësi është se kjo urë të financohet për arsye të ko-

munikimit të dy fshatrave. Ndonëse në përmasa më të vogla, megjithatë ky vend është potencial që të ndodhë edhe ndonjë tragjedi më e madhe, sepse vërshimet në atë zonë janë të mëdha dhe të paparashikueshme.

Blokimet nga prurjet e mëdha deri më tash nuk kanë shkaktuar dëme materiale apo pasoja në njerëz. Përndryshe, më 29 gusht të vitit 2016 u shkataruan disa shkëmbinj në këtë pjesë të rrugës, por edhe kjo rezultoi pa sukses sepse menjëherë më pas nga vërshimet, e njëjta rrugë u bllokua disa herë, kurse banorët vazhdojnë që të kërkojnë zgjidhje afatgjate për këtë problem të tyre.

Gostivar, inforqendër për persona me aftësi të kufizuara

Gostivar, 30 tetor - Shoqata për persona me nevoja të veçanta "Së bashku munde mi" nga Gostivari hapi zyrë në të cilën do t'u japë mbështetje, konsultime dhe këshilla personave me aftësi të kufizuara nga rajoni më i gjerë i Gostivarit. Zyra tani për tani do të funksionojë si qendër informative. "Zyra do të jetë në shërbim të qytetarëve të komunave Gostivar, Vrapçisht dhe Mavrovë-Rostushe dhe do të funksionojë si qendër informative për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara. Këtu është paraparë që të ndihmohet gjatë sigurimit të të drejtave dhe shërbimeve për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Në të ardhmen do të mbahen takime, konsultime për realizimin e projektit për mbrojtje nga diskriminimi si dhe për qëllime të tjera të cilat paraqiten si nevojë", tha Shpendi Salia, kryetar i Shoqatës. Në hapjen e infoqendrës morën pjesë përfaqësues nga komuna, Qendra për punë sociale, qytetarë dhe prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Selia e zyrës ndodhet në objektin e NP "Komunalec". Isak Lazami, drejtori i NP "Komunalec", në hapje theksoi se lëshimi i hapësirës për nevojat e shoqatës është mbështetje për nismat e tyre dhe se ndihmojnë pasi, siç tha, janë në dobi të personave me aftësi të kufizuara. Kryetari i shoqatës Salia paralajmëroi se projekti i radhës i cili është në plan është hapja e qendrës për fëmijët me paralizë cerebrale, për të cilën, siç përmendi, është nevojë mjaft e madhe për prindërit në Gostivar.

Vazhdon keqpërdorimi i praktikantëve

Shkup, 30 tetor - Të rinjtë janë një ndër kategoritë më të rrezikuara të drejtat e punës së të cilëve shkelen në praktikë. Ata kryesisht punojnë me kontratë me afat të caktuar, punojnë më gjatë se janë dakorduar dhe marrin pagë më të ulët se ajo e të punësuarve për periudhë të pacaktuar, thonë nga Seksioni i të rinjve pranë Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë, të cilat së bashku me Fondacionin "Friedrih Ebert" organizuan konferencë për të rinjtë. Të dhënat që u prezantuan në konferencë tregojnë se shkalla e të rinjve të papunë në moshën prej 15 deri 24 vjeç është 47.6 për qind, ndërsa gjysma e të rinjve apo 53 për qind kanë vendosur ose mendojnë të largohen nga vendi. Problem i madh për të rinjtë mbetet qasja e vendeve të punës ndërsa shqetësuese është se pjesa më e madhe e të rinjve punojnë në ekonominë joformale madje 48.1 për qind. Irena Ivanovska, kryetare e Seksionit të të rinjve pranë LSM, thotë se të rinjtë duhet të informohen për të drejtat e tyre nga marrëdhëniet e punës dhe përmes procesit inkluziv të krijohet nisma me të cilat do të përforcohet pozita e tyre në tregun e punës.

Aktivitetet kundër keq parkimit

Tetovë, 30 tetor - Në shumë vende të Tetovës vazhdon avazi i vjetër i parkimit të automjeteve jashtë zonës së caktuar për parkim. Pikërisht në këto zona, ingjencat i ka Policia e Tetovës, kurse komuna vetëm për ata që parkohen në zonë-parkim dhe nuk paguajnë. Në këtë drejtim, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së parkimit, para së gjithash në pjesën qendrore të qytetit të Tetovës, kanë filluar aktivitetet të përforcuara për zbulimin dhe sanksionimin ligjorë të atyre që parkohen gabimisht.

"Thëks i veçantë i këtyre aktiviteteve të cilat i realizojnë më shumë ekipe nga Stacioni për siguri në trafik dhe rrugë në Tetovë, i është dhënë të ashtuquajturës parkim paralel, e cila në masë të madhe pengon realizimin e parkimit zonal dhe lëvizjen e sigurt dhe normale të pjesëmarrësve tjerë në trafik. Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brend-

shme Tetovë, vetëm gjatë ditës së djeshme kanë zbuluar dhe sanksionuar 27 lloje të këtyre të kundërvajtjeve, duke përmendur se gjobat për këto lloje të kundërvajtjeve janë prej 45 deri 180 euro në kundërvlerë të denarit, varësisht nga vendi ku i kanë parkuar veturat e tyre", thotë zëdhënësi i SPB-së në Tetovë, Fatmir Rexhepi.

Sipas policisë, këto aktivitete me intensitet të njëjtë do të vazhdojnë edhe gjatë periudhës së ardhshme, ndërsa deri te vozitësit apelohet që t'u përmbahen rregullava, gjegjësisht të mos praktikojnë parkimin paralel, pa marrë parasysh sa kohë planifikojnë të ndalojnë, gjithashtu edhe gjatë periudhës kohore prej ora 10.00 deri ora 20.00 periudhë kjo që dukshëm rrit intensitetin e trafikut në rrugë, në të kundërtën do të ballafaqohen me sanksione të parapara me ligj. (U.H)

N'mot, nëntë fundjava të zgjatura

Shkup, 30 tetor - Gjatë vitit të ardhshëm do të kemi shtatë fundjava të zgjatura shkaku i festave publike, do me thënë 9 fundjava të zgjatura së bashku me festat fetare, të cilat i festojnë edhe besimtarët e krishterë. Vikendin tuaj të parë të zgjatur mund të ta planifikoni për "Krishtlindje", ku kemi fundjavë të zgjatur prej tre ditësh të bashkuara. Fundjava e dytë e zgjatur është për "Pashkët", në të cilën do të jenë katër ditë jo

pune. Kjo fundjavë e zgjatur është fundjava e fundit e muajit prill. E premtja do të jetë ditë jo pune vetëm për besimtarët ortodoksë, ndërsa dita e hënë për të gjithë qytetarët e Maqedonisë. Dita e iluministëve sllav Kirili dhe Metodi është 24 maji dhe festohet para fundjavës me çka fitohet vikendi i tretë i zgjatur.

"Ramazan Bajrami" festohet vitin e ardhshëm më 4 qershor të martën. Në vazhdim, fundjava

e pestë është festivali fetar "Ghosts", i cili vitin e ardhshëm, sipas kalendarit fetar, festohet më 14 qershor (e premte). Kjo ditë nuk punohet vetëm për besimtarët ortodoks që jetojnë në Maqedoni.

Festa shtetërore e Ilindenit, vitin e ardhshëm i bie ditën e premte, ose fundjava e gjashtë e zgjatur për vitin 2019. "Dita e Pavarësisë së Maqedonisë", 8 shtatori, vitin e ardhshëm i bie të

dielën, duke e pushimin të hënë (9 shtator), në fundjavën e shtatë të zgjatur të vitit. "Dita e kryengritjes revolucionare", festohet më 11 tetor dhe vitin e ardhshëm i bie ditën e premte, duke u dhënë qytetarëve fundjavën e tetë të zgjatur. Fundjava e nëntë e zgjatur është Dita e Klimentit të Ohrit. Kjo festë publike i bie më 8 dhjetor (e diel), dhe e njëjta zhvendoset dhe të hënë. (Q.A)

Mos bëj moralistin mes mexhlisesh!

Nga
Fadil LUSHI



"A ta që merren me thashetheme, me e pa të drejtë" më thonë se shkrimet i kam paksa "me hatër e me temena" sidomos kur shkarravis për politikë..., më thonë se shkrimet i bëj "toptan" me dy e më shumë standarde, njësoj si ajo puna e "burrave me barrë a pak shtatzënë dhe grave me prostatë", ca të tjerë hiç pa i lexuar, me plotë gojë ulërijnë kinse i kam njësoj si ato "kasollet prej kashte, prej qerpiçi e me dërrasa, të gjitha të mbuluara me cergën e merimangave", shkrime njësoj si ato "kameleonët a zvarranikët të vendeve të ngrohta, që ndërrojnë ngjyrën e lëkurës në përshtatje me ngjyrën e mjedisit ku ndodhen...", shkrime "që ngrenë tymnajë kot së koti", shkrime ku shkarkohet e shfryhet i gjithë mllef i akumuluar, imi dhe i të tjerëve që (nuk) mendojnë si unë, shkrime që "dezertojnë a shmangen nga Gjuha e Sotme Shqipe...", shkrime që bëhen me "sugjerime a me porosi", shkrime mu si ajo puna e lapidarit të ushtarit të panjohur shkronjat e të cilit tashmë kanë filluar të zbehën, shkrime njësoj si ajo poezia Anës lumenjve e shkruar nga Fan Noli: "Arratisur, syrgjynosur, /Rraskapitur dhe katosur, /Po vajtonj pa funt, pa shpresë, Anës detit i palarë, /Anës dritës i paparë, /Pranë sofrës i pangrënë, /Pranë dijes i panxënë, /Lakuriq dhe i dregosur, /Trup e shpirt i sakatosur...", "shkarravina" me shumë tarafe që nuk dallohen a nuk shquhen mirë, shkrime njësoj si "ato kockat që i hidhen zagarit për t'i lëpirë", shkrime njësoj si ato "hapësirat e shpellave nënujore, që nëse futesh në to, nuk del dot i gjallë...", shkrime njësoj si ajo puna e plakut me mjekrën e thinjur, i cili sabah e aksham heq trespiket..., shkrime njësoj si ajo puna e burokratit që shërbimet i bën me "dollarë e me euro...", njësoj si "puna e besimtarit të rremë, i cili dikur vidhte natën dhe mandej, para namazit të xhumasë, ia jepte fukarait zeqatën"...

Miqtë e mi të nderuar e të çmuar, në veçanti ata që kanë aftësi të lexojnë mes të rreshtash, më thonë se opinionet i qëndis duke iu referuar shprehjeve proverbiale, otomanizmave, dialekteve territoriale, barsoletave, ironisë therëse e të hidhur dhe, në fund, shkrime "açik" dhe pa dorëza. Disa të tjerë sikur pahiri harrojnë ta theksojnë formulën e shkurtër që lakon

normën juridike ku, pos të tjerash, thuhet se e drejta ime (për të shkruar) fillon aty ku mbaron e drejta jote e "paragjykimit". Unë do të vazhdoj t'i bëj shkrimet drejtpërdrejt dhe pa frikë. Një gjë di, të gjitha shkrimet e deritanishme i kam bërë me sebepe dhe jo me hatër me tarafe, jo me këshilla e kërkesa të fryra a të padrejta.

Çështje e vërteta, vështrimet me temena, gjithmonë ua kam dedikuar dëshmorëve të vatanit, foshnjave për gjiri, NËNËS shqiptare dhe të vërtetës! Shkrimin në vijim do t'ia kushtoj "haxhibabës" nga mëhalla jonë, i cili në fiqir është me "tamam", por ama sot e kësaj dite nuk "dëgjon mirë nga veshët".

Dikur moti, një "miku të tij" në nevojë, i kishte shkruar në ndihmë (morale dhe materiale). Pasi që kishte "realizuar nijetin", nevojtarit prej "axhamiu e sherrxhiu" i kishte dhënë uratën: "Të faleminderit që më ndihmove. Zoti të dhëntë xhehenemin!". Meqenëse "haxhibaba", është paksa "hafif" nga turqishtja e vjetër, e kishte pranuar uratën duke menduar se bëhet fjalë për "xhenetin"... dhe hiç fare nuk kishte "haber" se miku i tij që

më herët, prej inati e kishte vënë në nishan për ta qëlluar e gjymtuar shpirtërisht vetëm e vetëm pse shquhet për mirëbërësi dhe modesti. "Haxhibaba" ynë i dashur, shumë vonë e kuptoi se sipas etimologjisë a drejtshqiptimit të gjuhës osmane fjala "xhenet" nga fjala "xhehenem" dallon vetëm me një shkronjë.

Një ditë kur më takoi "haxhibaba" më tha: "Ore qerrata, në do bësh shkrimin e radhës, fillimisht duhet të heqësh dorë nga ajo doktrina filozofike që llafos dualizmin e papajtueshëmsi dhe nga modestia a thjeshtësia jote e tepruar..., pavarësisht se psikologët me shumë të drejtë thonë se modestia është virtut për aq kohë sa njeriu nuk e proklamoi si të tillë dhe, mos harro, ngandonjëherë thjeshtësia e tepruar lëre që kalon në banalitet, lëre që të detyron të heshtësh të vërtetën, lëre që të detyron të mbyllësh gojën, por edhe keqpërdoret, saqë edhe di të ta hajë kokën, të të bëjë budalla a të marrë dhe, në instancë të fundit, shpesh di edhe të të bëjë njeri pa sherr.

Modestia e tepruar dhe ajo përulja jo e merituar ndaj njerëzve të paragjykuar mund të të sjellë tela-

"...Modestia e tepruar dhe ajo përulja jo e merituar ndaj njerëzve të paragjykuar mund të të sjellë telashe, sidomos me njerëzit me të cilët nuk ke gjë të përbashkët as në moral, as në fiqir e as në trashëgimi. Andaj, është mirë të jesh modest, por ama gjithsesi me karar dhe pa zarrar"



she, sidomos me njerëzit me të cilët nuk ke gjë të përbashkët as në moral, as në fiqir e as në trashëgimi. Andaj, është mirë të jesh modest, por ama gjithsesi me karar dhe pa zarrar".

Edhe përtej gjykimeve të mësipërme, edhe përtej "sugjerimeve" të "haxhibabës", unë do të vazhdoj të shkruaj ashtu si më thotë mendja ime! Këtë "shkarravinë" do t'ia dedikoj pikërisht "haxhibabës", icili prej ditës që ka vendosur të mos gënjejë, ka rënë në hall të madh me disa "ryshfetçinj" dhe ca të tjerë politikëbërës axhami, të cilët për t'i treguar e për ta bindur "haxhiun" se kanë by**ën a prapanicën, hiç pa marre bëjnë moralistin dhe po***ën mes mexhlisesh të burrave, mes mexhlisesh të intelektualëve, mes kuvendesh të politikanëve..., mes mexhlisesh të matrapazëve të lëkurëve e të tjera kuvendesh a mexhlisesh të...

Ne që bëjmë shkrimin nuk do të kallëzojmë a të përmendim emrat e tyre, sepse po ta bëjmë këtë, atëherë pas tyre do të rreshtoheshin shumë të tjerë

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 30 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

maskarenj njësoj të tillë si ata..., toptan të nxirë në surrat! Të gjitha këto moralizime të mërztishme e të kota si dhe "po***ë-bërjet" mes mexhlisesh të diplomatëve të vendit dhe jabanxhinjsh, ma kujtojnë atë vakinë e 27 prillit të motit 2017, ku ca nacionalistë provincialistë dhe primitivë sikur deshën me forcë ta zaptojnë e ta shembin përtokë "binanë" e organit ligjvënës, sikur deshën të vrasin deputetët..., sikur deshën t'ia thyejnë qafën kryeparlamentarit dhe trupprojës së tij..., këta politikanë të dështuar dhe me kokën rrëmuje sikur ma kujtojnë meselenë e "... ledhit, i cili dikur ishte dukur papritmas në shtratin e një lumi, një lumë që ndante pronat e dy njerëzve(i pari, autokton, i dyti, ardhacak).

Ai që ishte rrënjës i atij vendi, vuri një hu prej ahu mbi ishullin ranor, duke e quajtur tokë të veten, edhe tjetri nguli hurin prej dël-linje për të zotëruar pronën..., dhe kështu plasi edhe pushka.

U bë batërdia me të vrarë e të plagosur.

Dy ditë më pas me rënien e shirave, lumi shtoi prurjet e ujit dhe ujdhesa u zhduk!

Pas shumë kohësh, kur "sulltani" u duk atypari, ardhacakut ia zgjati veshët duke i parashtruar pyetjen se "ç'hall ka dhe ç'kërkon...", kurse qiraxhiu paraqiti një varg kërkesash dhe dëshirash, duke thënë se "...e dua Krishtin, e dua paqen, e dua faljen, e dua amnistinë, e dua politikën turli tavë, i dua qoftet a topat e kandarit të NN-së, e dua drejtësinë e kapur nga politika, dua që organet gjyqësore të shndërron në një furrë ku të shkriheshin tersllëqet e mia..., e dua priftin që do të m'i falë gabimet a gjynahet në këmbim të një shisheje me raki rrushi e kumbullash, e dua sharrëxhiun e Esad Mekulit, e dua shqiptarin e mirë, por të vdekur, e dua shtetin dhe gjuhën time biblike, e dua Maqedoninë e Egjeut dhe atë të Pirinit, e dua Aleksandrin e Madh grumbull me fisin e tij!..."e të tjera kërkesa e dëshira "miletiantik".

"Sulltani" duhej të bënte shqyrr që ky ahmaku nuk kërkoi by***n e viçit!

Miku im i nderuar! Nëse kjo e vërtetë e mësipërme ka dy anë, atëherë unë do të "kërkoj katër kalemata e haxhibabës"!

Sa e rrezikshme është FIFA?

Nga
ALL TIME CONS

Me 211 federata anëtare dhe 3.5 miliardë tifozë në mbarë botën, përmatat e FIFA-s janë të pakrahasueshme. Dhe ky ndikim, dhe shuma të tilla të mëdha parash, e bëjnë shumë më të lehtë dominimin e lakmisë dhe të keqes. Në vitin 2014, në një artikull për "The New York Times", Dejvid Zirin ngriti një listë akuzash kundër FIFA-s, duke argumentuar se lakmia, korrupsioni, mos-reagimi dhe keqpërdorimi janë endemike për udhëheqjen e organizatës, përfshirë edhe presidentin e atëherëshëm Sep Blater.

Në fakt, akuzat për korrupsion nuk e dëmtuan trashëgiminë e Blater, i cili u zgjodh president i FIFA-s në vitin 1998, dhe u rizgjodh edhe 4 here të tjera. Për shembull, në majin e vitit 2006, gazetari investigativ britanik Endrju Xhenings, botoi librin e tij "Faul! Bota sekrete e FIFA-s", në të cilën ai ngriti akuzat për ryshfet dhe korrupsion, pas falimentimit të partneres së marketingut të FIFA-s, International Sports and Leisure (ISL) Sipas Xhenings, gjatë dy dekadave para rënies së ISL, kompania e marketingut do t'i paguante rregullisht ryshfete zyrtarëve të FIFA-s "në formë rrogash". Gjithsesi kur ajo falimentoi, disa zyrtarë u urdhëruan të ripaguhën me më shumë se 1 milionë paund për të mbuluar skandalin.

Më 29 nëntor 2010, shtrirja e korrupsionit u duk shumë më e thellë. Endrju Xhenings dhe programi investigativ i BBC-së, Panorama, pretenduan se anëtarët e mirënjohur të komitetit drejtues të FIFA-s Nikolas Leoz, Isa Hajatu dhe Rikardo Teikseira, kishin pranuar ryshfete të mëdha nga ISL mi-

dis viteve 1989-1999. Në fakt, ato ishin vetëm 3 prej 175 ryshfeteve të paguara nga kompania e marketingut, një shumë që arriti në 100 milionë dollarë. Sep Blater, tha se FIFA nuk i kishte hetuar akuzat, për shkak se ankesat nuk kishin ardhur përmes kanaleve zyrtare. Isa Hajatu, President i Konfederatës së Futbollit Afrikan, dhe presidenti i FIFA-s në detyrë pas dorëheqjes së Blater, ishte përfshirë në një skandal tjetër në vitin 2011.

Një informator i FIFA-s, e njoftoi gazetën britanike "Sunday Times", se Hajatu dhe anëtari tjetër i komitetit Zhak Anuma, u paguan 15 milionë dollarë për të votuar pro kandidaturës së Katarit për organizimin e Botërorit të vitit 2022. Xhenings, pretendoi gjithashtu manipulimin e votave dhe abuzime me detyrën nga FIFA, gjatë zgjedhjeve presidenciale të viteve 2002, 2007, 2011 dhe 2015, për të garantuar qëndrimin në detyrë të Blater. Ish-kryetari i Federatës Angleze të Futbollit, Lordi Dejvid Treisman, e ka përshkruar sjelljen e FIFA-s me atë të një "familjeje mafioze", duke vënë në dukje "traditën dhjetë-ravjeçare të ryshfeteve". Sep Blater dhe zyrtarë të tjerë të FIFA-s, i hodhën poshtë të gjitha pretendimet e Endrju Xhenings.

Më 25 maj 2011, FIFA njoftoi se kishte nisur hetimet për 4 zyrtarë - Muhamed Bin Hamam, Debi Minguell, Xhejzën Silvester dhe Xhek Uorner, në lidhje me akuzat për marrje ryshfeti nga një drejtues i FIFA-s, Çak Blejzër. Në vitin 2015, Uorner përjashtohet përherë nga organizimi i futbollit, pasi komiteti i etikës zbuloi se ai kishte "sjellje të ndryshme të pahijshme...që përfshinte ofrimin dhe marrjen e pagesave të fshehta dhe të paligj-



Që nga viti 1904, Federata Ndërkombëtare e Futbollit, FIFA ka organizuar dhe promovuar të gjitha turnetë e mëdha të futbollit, duke përfshirë Kupat e Botës. Është një organizatë jofitimprurëse, por që gjeneron të ardhura nga sponsorizimet. Në vitin 2017, të ardhurat e FIFA-s i tejkaluan 734 milionë dollarë. Por një rënie prej 189 milionë dollarësh, nuk duhet ta brengosë atë: kishte ende rezerva në para të thata, në mbi 930 milionë dollarë

shme". Edhe ata që informojnë për anëtarët e tjerë të FIFA-s, janë fajtorë për korrupsion. Në vitin 2013, Çak Blejzër - sekretari i përgjithshëm i federatës CONCACAF - pranoi marrjen e ryshfeteve gjatë Botërorëve të viteve 1998 dhe 2010, dhe ra dakord të shndërrohej në një informator të organizatës.

Nëse zyrtarët e FIFA-s janë kaq të pangopur sa të pranojnë ryshfete, kjo mund të mos duket si e keqja më e madhe. Megjithatë, korrupsioni mund të ketë efekte krejtësisht të dëmshme mbi botën. Për shembull, edhe para akuzave për korrupsion, Katarit u duk si një zgjedhje e çuditshme për të organizuar Kupën e Botës 2022. Tempera-

turat atje arrijnë rregullisht 49 Gradë Celsius, duke imponuar zhvillimin e turneut gjatë dimrit. Për më tepër, ndërtimi i stadiumeve të futbollit, është kryer duke shfrytëzuar nën kushte ç'njerëzore pune mijëra emigrantë. Vetëm në vitin 2013, autoritetet shëndetësore raportuan vdekjen e 520 emigrantëve në Katar, nga të cilët 385 në një mënyrë të pashpjegueshme. Katarit akuzohet edhe për korrupsionin e zyrtarëve të shumtë të FIFA, për fitimin e të drejtave të organizimit të botërorit.

Gjithashtu, edhe organizimi i Botërorit 2018 në Rusi dhe Olimpiadës në Soçi në vitin 2014, ishin zgjedhje të dyshimta. Soçi është një destinacion i mirënjohur turistik, me temperaturat më të larta në Rusi, me kritikën për korrupsionin, duke përmendur miliarda dollarë që u zhdukën në buxhetin e shtetit. Një nga kundërshtarët më të shquar ishte Boris Nemcov, një kritik i vjetër i Putinit, i cili ofroi prova për më shumë se 30 miliardë dollarë fonde të grabitura, duke i quajtur Lojërat Olimpikë Dimërore një "mashtim monstruoze". Një vit më vonë, ai u vra shumë pranë Kremllit.

Sikurse komentoi Frida Gitis e CNN-it, "ngjarjet sportive si Kupa e Botës në futboll dhe Olimpiadat, janë shndërruar trofe për tiranët. FIFA është një vend i përkryer për batakçinjte. Nuk është çudi se përse diktatorët duan të bëjnë biznes me të". Pavarësisht nga korrupsioni i shfrenuar në FIFA, gjatë 5 viteve të fundit agjencitë qeveritare nga shumë vende kanë tentuar t'i japin fund kësaj situatë. Në majin e vitit 2015, FBI-ja arrestoi 14 persona, duke përfshirë 9 zyrtarë të FIFA-s, me akuzat e mashtimit, shantazhit dhe pastrimit të parave. Dhe në shtatorin e vitit 2015, Prokuroria e Përgjithshme Zvicërisë nisi një procedim penal ndaj Sep Blaterit për "keqadministrim kriminal...dhe shpërdorim detyrë". Blater u largua nga detyra 3 muaj para mbarimit të mandatit, duke shënuar fundin e njëres prej periudhave më të turpshme të historisë së sportit.

Megjithatë, pavarësisht nga reputacioni i dëmtuar, FIFA kontrollon ende futbollin global, duke fituar 6 miliardë dollarë vetëm nga Kampionati Botëror i këtij viti. Me paratë vjen ndikimi, dhe me ndikimin vjen pushteti. Dhe kur kontrolloni një sport të dashur nga gjysma e popullsisë së botës, ndoshta korrupsioni është thjeshtë pjesë e lojës.



DIETA E TUMORIT TË GJIRIT, PARANDALOJENI ME KËTO USHQIME

Mjekët nuk rreshtin kurrë së përsërituri rëndësinë e një regjimi të duhur ushqimor, për parandalimin e tumoreve, përfshirë dhe atë të gjirit. Ky i fundit është edhe ndër më të përhapurit dhe shkaktohet nga një mutacion i ADN-së së qelizave, të cilat përfshijnë edhe ato ngjitur, duke u kthyer në kancerogjene. Por a e dini se janë pesë super ushqime, të cilat i ndihmojnë femrat të parandalojnë këto lloj formimesh?

BISHTAJAT: Disa studime kanë provuar se femrat që konsumojnë rregullisht fasule, thjerrëza dhe bishtaja të tjera, janë më pak të ekspozuara nga rreziku i kancerit të gjirit. Kjo pasi bishtajat janë një burim natyral antioksidantësh dhe substancash fitokimike, të cilat janë shumë të mira për parandalimin e kancerit. Ndër të tjera përmbajnë edhe shumë fibra dhe proteina vegjetale, kalcium, hekur dhe vitamina, të domosdoshme për shëndetin e trupit tonë.

SHEGA: Shega është një substancë e cila është në



gjendje që luftojë aromatazën, enzimë përgjegjëse për prodhimin e estrogenëve, të cilat janë edhe shkaktarët kryesorë për rritjen e tumoreve në gji. Kështu konsumi i rregullt i shegës, rezulton të jetë një 'armë' shumë e mirë për parandalimin e kancerit të gjirit.

PESHKU: Omega-3 është një acid yndyror i cili është në gjendje që të parandalojë for-

mimin e tumoreve. Peshku blu është shumë i pasur me to dhe konsumi i tij i rregullt parandalon kancerin e gjirit. Gjithashtu edhe gjithë ushqimet e tjera që përmbajnë omega-3 ju vijnë shumë në ndihmë.

BORONICAT: Në sajë të substancave fitokimike që përmbajnë, luajnë rol të rëndësishëm për të reduktuar rrezikun e kancerit të gjirit dhe për të nga-

dalësuar përhapjen e radikaleve të lira. Konsumi i tyre i rregullt, ka një mijë dobi.

KANELLA: Është një erëz shumë e mirë për të luftuar dhe parandaluar kancerin e gjirit. Mes gjithë erëzave, kanella është më e mira. Kjo pasi është në gjendje që të frenojë rritjen e tumorit. Kështu që përdoren si më shpesh në ëmbëlsira, në çaj apo në qumësht.



Njerëzit që qajnë shpesh kanë karakter të veçantë

Si shpërfaqet karakteri te njerëzit? Njerëzit në mënyra të ndryshme mbajnë ndjenjat, dhe gjithashtu i shprehin ato. Qarja përgjithësisht shoqërohet me një ndjenjë të thellë trishtimi dhe nuk duhet të jetë gjithmonë pikëllimi në fjalë. Sipas psikologëve, të qarët është i mirë dhe i shëndetshëm, dhe njerëzit që qajnë shumë janë të veçantë. Herën tjetër që jeni në buzë të lotëve, mban mend këto pak gjëra:

TË QARËT REDUKTON STRESIN.

Nëse jeni një person i cili lehtësisht lëshohet në emocione, atëherë do ta kenë më të lehtë për t'u marrë me situata të vështira jetësore. Pas "shlyerjes tuaj", ju do të ndiheni lehtësues dhe do të jeni në gjendje të shihni qartë situatën që ju bëri për të qarë.

TREGONI SE NUK KENI FRIKË NGA

NDJENJAT TUAJA. Të qarët është gjithashtu një shenjë se nuk keni frikë nga ajo që ndjeni. Qarja është një shenjë se ju pranoni ndjeshmërinë dhe lëndimin tuaj. Kjo është një shenjë se ju jeni një person i fortë që gjërat i quani emra të vërtetë.

TREGONI SE SA TRIM JENI. Njerëzit që tregojnë emocionet e tyre janë të guximshëm dhe autentikë. Është më e rëndësishme për ata që të jetojnë në të vërtetën e tyre sesa të shqetësohen për atë që të tjerët flasin. Përveç kësaj, ata e dinë se të tjerët gjithashtu do të tregojnë më lehtë ndjenjat e tyre të vërteta, madje edhe përmes lotëve, por nuk guxojnë, sepse duhet të mbajnë pamjen që kanë krijuar për veten.

TË QARËT NDIHMON NË VENDOSJEN E BALANCËS.

Kur ju pranoni ndjenjat tuaja dhe qarja është pjesë e procesit të pranimit, atëherë do të jetë çlirimi i ndjenjave.

Kafeja gjatë shtatzënisë rrit rrezikun e mbipeshës tek fëmijët

Cjatë shtatzënisë çdo grua është "viktimë" e dëshirave dhe e tekeve. Por që sot çdo grua shtatzënë duhet të heqë dorë nga kafeja gjatë kësaj periudhe. Konsumimi i saj rrit rrezikun e mbipeshës tek fëmija. Nga një studim që është kryer nga qendra kërkimore franceze në Suedi u gjet lidhja mes kafesë dhe mbipeshës tek foshnjat. Studiuesit analizuan të dhënat e rreth 51.000 grave dhe fëmijëve të tyre. Ato raportuan në lidhje me konsumin e kafesë në muajt e shtatzënisë.

Më pak se 50 miligramë në ditë u konsiderua si konsumim



i ulët, nga 50 deri në 199 miligramë u konsiderua mesatar, nga 200 deri 299 miligramë u

konsiderua e lartë, ndërsa më shumë se 300 miligramë kafe në ditë gjatë shtatzënisë konsi-

derohet shumë i lartë.

Por, a mund të rezistosh për nëntë muaj pa kafe? Në këtë rast, ekspertët rekomandojnë të konsumohet 200 miligramë në ditë dhe jo më shumë. Për më tepër, është mirë të dihet se studimet e mëparshme kanë treguar se gratë shtatzëna të cilat konsumojnë më shumë se 200 miligramë kafe në ditë kanë dy herë më shumë mundësi të kenë abort sesa ato që nuk konsumojnë kafe. Gjithashtu konsumimi i tepruar i kafesë shkakton efekte të ndryshme si nervozizëm, pagjumësi dhe dhimbje koke.

Ushqimet që ndihmojnë për një gjumë të rehatshëm

Gjumi është shumë i rëndësishëm për të rifituar energjitë dhe përballuar ditën. Por cilat ushqime na ndihmojnë për një gjumë të qetë?

- Qershia: Qershitë ose lëngu i qershive mund të ndihmojnë për një gjumë të rehatshëm, sipas një studimi nga Universiteti Shtetëror i Luizianës. Në eksperiment u përfshinë disa të rritur që kishin probleme me gjumin, të cilëve iu dha

250 gramë lëng qershie dy herë në ditë për dy javë. Ata filluan të flinin mesatarisht 84 minuta më gjatë sesa kur pinin qetësues ose lëngje të tjera frutash. Sekret i qëndron në tryptophanin e aminoacideve (përbërës që ndodhet tek shumica e proteinave), i cili gjendet në qershi dhe ndihmon në rregullimin e ritmit të gjumit.

- Peshqit, algat e detit dhe prodhimet e detit: Sipas një studi-

mi të Universitetit të Oksfordit, Peshqit, algat e detit dhe prodhimet e detit janë të pasura me omega-3, që përmirëson gjumin tek fëmijët dhe ul shqetësimet para gjumit.

- Arrat dhe bajamet: Frutat e thata janë ndër ushqimet që ju ndihmojnë të flini më mirë, sidomos arrat dhe bajamet. Sipas një studimi të Universitetit të Teksasit ata janë një burim i shkëlqyeshëm i melatoninës, një substancë që



përmirëson cilësinë e gjumit. Bajamet që përmbajnë nivele të larta të magnezit natyrisht lehtësojnë gjumin gjatë natës, sipas një studimi të botuar në Journal of

Orthomolecular Medicine. Përkundrazi, mungesa e magnezit mund të ndryshojë ritmin e gjumit dhe të shkaktojë shqetësime gjatë fjetjes.

PSE VETËVRIKEN NJERËZIT?

“Në shumicën dërrmuese të rasteve, njerëzit vrasin veten për shkak të njerëzve të tjerë”, shprehet Bering. “Problemet sociale - sidomos një shqetësim shumë i paqëndrueshëm mbi atë që mendojnë të tjerët ose që do të mendojnë për ne, nëse vetëm do të dinin atë që ne e perceptojmë të jetë një gjë e pakëndshme e vërtetë - ushqejnë një zjarr vdekjeprurës”.

Nga Michael SHERMER

Robin Uilliams (63), Kërt Ko-bein (27), Ernest Heminguej (61), Alan Turing (41), Virginia Ulf (59), Vincent Van Gogh (37-vjeç). Kur të keni përfunduar leximin e kësaj liste njerëzish të ndjeshëm, që humbën jetën si pasojë e vetëvrasjes, diku tjetër në botë një person tjetër do të ketë bërë të njëjtën gjë, rreth 1 person në çdo 40 sekonda (rreth 800.000 në vit), duke e bërë vetëvrasjen ndër shkaqet kryesore të vdekjeve në SHBA dhe jo vetëm.

Pse? Sipas psikologut të shquar Xhesi Bering i Universitetit të Otagos në Zelandën e Re, në librin e tij të spikatur “Pse vrasim veten”, “çështjet specifike që çojnë një person të caktuar të vrasë veten janë po aq të ndryshme, sa edhe ADN-ja e tyre - që përfshin zinxhir ngjarësh, që një ekspert e quan “marramendëse në shumëllojshmërinë e vet”. Lista e shkurtër e mësipërme, përfshin njerëz me një diversitet moshash, profesione, personalitetesh dhe gjinish. Depresioni zakonisht shfaqet në shumë raste të vetëvrasjes, megjithatë shumica e njerëzve që vuajnë nga depresioni nuk vrasin veten (vetëm rreth 5 për qind e tyre thotë Bering), dhe jo të gjitha viktimat e vetëvrasjeve janë në depresion.

“Rreth 43 për qind e ndryshueshmërisë në sjelljen vetëvrasëse në mesin e popullatës së përgjithshme, mund të shpjegohet përmes

gjenetikës”, raporton Bering, “ndërsa 57 për qind i atribuohet faktorëve mjedisorë”. Pasja e një predispozitë gjenetike për vetëvrasje, e kombinuar me një sekuençë të veçantë të sulmit ambjental ndaj dëshirës së dikujt për të jetuar, i çon disa njerëz të përipiqen të bëjnë të pamundurën që dhimbja të ndalojë. Në rastin e Bering, kjo ndodhi fillimisht si një adoleshent homoseksual i mbyllur në vetvete “në një qytet të vogël intolerant në perëndimin e mesëm”, dhe më pas me papunësinë në kulmin e karrierës së tij akademike (suksesi mund të çojë në standarde paarsyeshmërisht të larta mbi lumturinë, të shkatërruara më vonë nga peripeçitë e jetës). Megjithatë, homoseksualiteti më të shtypur dhe akademikët e papunë nuk duan të vrasin veten. “Në shumicën dërrmuese të rasteve, njerëzit vrasin veten për shkak të njerëzve të tjerë”, shprehet Bering. “Problemet sociale - sidomos një shqetësim shumë i paqëndrueshëm mbi atë që mendojnë të tjerët ose që do të mendojnë për ne, nëse vetëm do të dinin atë që ne e perceptojmë të jetë një gjë e pakëndshme e vërtetë - ushqejnë një zjarr vdekjeprurës”. Ashtu si shumica e sjellje-

ve njerëzore, vetëvrasja është një veprim shumëfunktional. Ekspozimi i variablove më të fuqishëm parashikues është i vështirë, veçanërisht për shkak se gjendje të tilla konjitive të brendshme, mund të mos jenë të arritshme edhe tek personi që i përjeton ato. Ne nuk mund të perceptojmë funksionimin neurokimik të trurit tonë, ndaj proceset e brendshme zakonisht i atribuohen burimeve të jashtme. Edhe ata që përjetojnë ide vetëvrasëse, mund të mos e kuptojnë pse-në, apo edhe se kur një ide mund të shndërrohet në një veprim konkret.


Ky vëzhgim është përforcuar nga Ralf Ljuis, psikiatër në Universitetin e Torontos, i cili punon me pacientët që vuajnë nga kanceri, dhe të tjerë që përballen me vdekjen. “Shumë njerëz që janë në depresion klinik, do të mendojnë se arsyeja se përse ata ndihen ashtu, është për shkak të një krize ekzistenciale rreth kuptimit të jetës, apo që i detyrohet një ngjarjeje relacionale që ka ndodhur” - thotë Ljuis. “Por ky është atribuimi subjektiv i njerëzve, kur në fakt ata mund të jenë në depresion për arsye që nuk i kuptojnë”. Për shembull, në prak-

tikën e tij klinike ai vëren: “Kam parë shumë raste kur këto kriza ekzistenciale, praktikisht janë zhdukur nën ndikimin e një antidepressanti”. Ky gabim atributiv, thotë Ljuis, është i zakonshëm: “Në një nivel themelor, ne të gjithë i interpretojmë gabim shkaqet e gjendjeve tona mendore, për shembull, duke bërë përgjegjës për nervozizmin tonë fjalët e thëna nga dikush, kur fakt është se kjo ka ndodhur për shkak se jemi të uritur, të lodhur”.

Gjatë konsultimeve me të mbijetuar të tentativave për vetëvrasje, Ljuis vëren: “Ata thonë ‘Nuk e di se si më erdhi. Nuk e di se çfarë isha duke menduar’”.

Kjo është arsyeja se përse parandalimi i vetëvrasjeve është kaq i rëndësishëm: pasi njerëzit mund të jenë shumë bindës në argumentimin se pse ata besojnë se jeta - jeta e tyre - nuk është e vlefshme për t'u jetuar. Dhe megjithatë gjendja duket radikalisht ndryshe disa muaj më vonë, ndonjëherë për shkak të një ilaçi antidepressiv, ndonjëherë për shkak të ndryshimit të rrethanave, ndonjëherë thjesht nga një ndryshim misterioz i mendjes”.

(bota.al)



Sa të pista janë paratë?

Paratë janë habitatet më mirë për mikrobet. Mbi tre në katër kartëmonedha e monedha janë të infektuara me mikrobe që mund të shkaktojnë meningjit, sepsis, sindromën e shokut toksik, abortit spontan dhe helmimit. Pikërisht këto të dhëna kanë ngritur alarmin dhe kanë bërë që ekspertët të hedhin idenë e pastrimit të parave. Madje ata thonë se lëvizja për të pasur një shoqëri pa para kesh do të ishte në më të mirën e shëndetit të njerëzve. Të dhënat e fundit vijnë pas një ekzaminimi që bëjnë ekspertët në Britaninë e Madhe të kartëmonedhave dhe monedhave që dominojnë tregun atje. Ata dalluan se 78 për qind e tyre ishin të veshura me një varietet prej 19 bakteresh të ndryshme. Dy prej tyre ishin supermikrobet rezistente ndaj antibiotikëve, të klasifikuara si të tilla nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Një tjetër gjendet në feçe, që do sugjeron se njerëzit nuk i lajnë duart pasi shkojnë në tualet. Ekspertët thonë se paratë që janë aktualisht në qarkullim janë një rrezik për shëndetin e popullatës. Profesi Paul Matewele, nga Universiteti Metropolitan i Londrës, duke folur për The Sun, tha se duhet marrë në konsideratë kalimi në një shoqëri pa para kesh, si një mënyrë për të ulur shpërndarjen e këtyre mikrobeve. “Nëse paguani me para për një sandwich, përpara se ta hani atë lani duart. Nëse nuk i lani duart pasi keni prekur paratë, po i kërkon vetë telashet”.

Shenjat që tregojnë se keni nevojë për më shumë kalcium

Kalciumi është një mineral esencial që është shumë i njohur për rolin e tij të rëndësishëm në shëndetin e kockave. Kur ju nuk merrni mjaftueshëm kalcium, mund të identifikoheni me anë të disa simptomave. Disa shenja se keni nevojë për më shumë kalcium, janë si vijon:

LËKURA E THATË. Hipokalcemia ose mungesa e kalciumit në trupin tuaj mund të jenë të dukshme në lëkurë. Kjo gjendje zakonisht e bën lëkurën tuaj të duket me luspa dhe e thatë. Gjithashtu është zbuluar se mungesa e kalciumit ka një lidhje të ngushtë me zhvillimin e problemeve të lëkurës si ekzema dhe psoriasis.



LODHJA. Si rregull, një papërshtatshmëri e kalciumit në trupin tuaj ndikon në shëndetin e përgjithshëm fizik. Pra, nëse

përjetoni lodhje ekstreme, le-targji, mungesë energjie ose një ndjenjë të vazhdueshme ngadalësimi, përipiquni të përqendrohni

në balancimin e dietës suaj ushqimore.

SËMURENI SHPESH. Kalciumi luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e një sistemi të shëndetshëm imunitar pasi ndihmon trupin tuaj të luftojë kundër viruseve dhe bakterëve. Një mangësi e kalciumit zvogëlon rezistencën e trupit tuaj kundër sulmeve patogjene dhe si rezultat, ju do të sëmurëni shpesh.

DHËMBËT E DOBËT. Për shkak të mungesës së këtij elementi jetik, dhëmbët mund të fillojnë të kthehen në të verdhë, prishen dhe lëndohen. Përveç kësaj, rreziku juaj për të vuajtur nga një sëmundje parodontale mund të rritet.

DHIMBJE TË MUSKUJVE.

Dhimbjet e muskujeve në kofshë e krahë që ndodhin më së shumti gjatë natës, mund të jenë një nga simptomat e hershme të një mungese kalciumi. Çdo person i rritur duhet të konsumojë rreth 1000 mg kalcium në ditë. Është e nevojshme të hani më shumë peshq të yndyrshëm (salmon, sardele, skumbri dhe ton), djathë, qumësht, soje, bajame dhe farat e susamit.

Për të ndihmuar trupin tuaj të përthithë më mirë kalcium, duhet gjithashtu të rrisni marrjen e vitaminës D. Kjo vitaminë gjendet tek e verdha e vezës, karkalecat, kërpudhat, drithërat, bullguri dhe lëngu i portokallit.

VRASJA E EKSTREMISTIT TË ARMATOSUR NË BULARAT

PARLAMENTI GREK REFUZON KËRKESËN PËR 1 MINUTË HESHTJE

“Greku i vrasë ishte pjesë e policisë sekrete të Autonomisë së Veriut të Epirit. Është mirë që policia e Shqipërisë t’i drejtohet me shkresë sigurimit të Greqisë për materialet që disponon. Greqia disponon kartën e policisë sekrete të Kostandin Kacifas që ishte pjesë policisë sekrete të Autonomisë”, thotë historian Arben Lalla



Në seancën e së martës të parlamentit grek përpara fillimit të diskutimit të saj deputetja Eleni Zaroulia mori fjalën dhe kërkoi që të mbahet nga Parlamenti një minutë heshtje në kujtim të Konstantin Katsifas.

“Para pyetjes së tanishme, për shkak se dje në Epirin e Veriut është vrasë nga regjimi shqiptar i cili persekuton grekët, sepse ai donte të shpaloste flamurin grek në ditën e përvjetorit të 28 tetorit, unë do të kërkoj për të mbajtur një minutë heshtje nga parlamenti në kujtim të 35-vjeçarit Konstantin Katsifos”, tha deputetja e Agimit të Artë.

Zëvendës kryetari i parlamentit duke cituar Rregulloren e parlamentit e refuzoi këtë kërkesë, njofton gazeta Shqip.

Në ndërkohë, është kundërshtuar kërkesa e familjarëve të ekstremistit të vrasë Kostandinos Kaçifas për një ekspertizë mjeko-ligjore të trupit të pajetë, pasi që paarditën e së martës në Bularat ka mbërritur policia gjyqësore. Ky vendim vjen pasi janë marrë në konsideratë rrethanat e ekzekutimit të Konstandinos Kaçifas, i cili në një video të publikuar dje u shfaq duke qëlluar në drejtim të policisë shqiptare.

Çështja është përgjegjësi e Prokurorisë së Krimeve të Rënda e cila dhe po heton çështjen.

Që prej të dielës trupi i pajetë i 35-vjeçarit

të ekzekutuar nga efektivët e RENE-s në Bularat, ndodhet ende në morgun e spitalit të Gjirokastrës.

Por, historiani Arben Lalla jep një tjetër version mbi 35-vjeçarit minoritar grek, që mbeti dje i vrasë në fshatin Bularat të Gjirokastrës.

Gjithçka pasi i riu qëllloi në ajër me armë dhe më tej gjatë ndjekjes nga policia qëllloi edhe ndaj uniformave blu, ku gjatë shkëmbimit të zjarrit mbeti i vdekur.

Sipas historianit, Konstandinos Kacifas ishte pjesë sekrete e Autonomisë së Veriut të Epirit.

Në postimin e Lallës thuhet: “Greku i vrasë ishte pjesë e policisë sekrete të Autonomisë së Veriut të Epirit. Është mirë që policia e Shqipërisë t’i drejtohet me shkresë sigurimit të Greqisë për materialet që disponon. Greqia disponon kartën e policisë sekrete të Kostandin Kacifas që ishte pjesë policisë sekrete të Autonomisë”.

Kacifas prej pak ditësh ishte kthyer në Gjirokastrë pasi jetonte në Athinë. Ai ishte i divorcuar dhe kishte një vajzë 13 vjeçe.

Në anën tjetër, ende është e vështirë për nënën e Kostandinos Kaçifas, 35-vjeçarit nga Bularati, i cili mbeti i vrasë dje në Bularat të Gjirokastrës pas shkëmbimit të zjarrit me Poli-

cinë, me tragjedinë që i ka ndodhur.

Ike në vitet më të bukura trimi im, shpirti im. Nuk do të të shoh më zemra ime. Akoma nuk e besoj. Nuk e duroj dot dhimbjen”, vajtonte ajo dje në një rën nga dhomat e shtëpisë, ku gjithë ditën pati dhjetëra ngushëllime.

“Familjarë, të afërm dhe banorë të fshatit janë mbledhur të gjithë që në orët e para të mëngjesit në shtëpinë e familjes Kaçifas, për t’iu gjendur pranë prindërve dhe motrave.

Këto të fundit jetojnë prej vitesh në Athinë, por kanë mbërritur gjatë natës për t’u qëndruar pranë prindërve dhe për t’i dhënë lamtumirën vëllait të tyre. Nëna dhe as motrat nuk pranuan të flisnin për mediat, duke iu kërkuar të qëndronin larg shtëpisë së tyre.

Një prej kusetëve të 35-vjeçarit të vrasë, ndërsa arsyetonte me gazetarët se përse nuk pranoheshin brenda ambienteve të shtëpisë, theksoi se “veprimi i Konstandinos ishte i pamenduar dhe kërkoi që ngjarja të mos politizohet. Mediat shqiptare e greke japin informacione të pavërteta. Djali bëri një budallallëk dhe një ngjarje e tillë nuk ka pse të politizohet. Po përpiqemi të qetësojmë ujërat si në Greqi dhe në Shqipëri. Ka të çmendur nga të dyja palët, kështu që mos t’u japim shkas ekstremistëve. Jemi fqinj dhe gjërat nuk duhet të keqinterpretohen”, u shpreh ai.



CIA për Serbinë: Korrupsion, heroína, shpëlarje parash

Në raportin e publikuar në sajtin e CIA-s për Serbinë pretendohet se Serbia proteston sepse SHBA dhe shtetet tjera demokratike e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në raport më tutje theksohet se disa mijëra të forcave të NATO-s gjenden në Kosovë dhe vazhdojnë ta mbajnë paqen në mes të shumicës shqiptare dhe pakicës serbe në Kosovë.

Gjithashtu pretendon se është shënuar sistemi joefikas i drejtësisë, niveli shumë i lartë i korrupsionit dhe plakja e popullsisë. Në këtë raport përmendet si një e dhënë e rëndësishme se Serbia është pika e ringarkimit të heroinës nga Azia Juglindore kah Evropa Perëndimore, si dhe që ekonominë e bazon në shpëlarje të parave.

Gjithashtu pretendohet se Serbia edhe më tutje ka kontest të pazgjidhur të kufijve me Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe me Kroacinë rreth kufirit në lumin Drina, gjegjësisht në Danub, por edhe disa çështje tjera të pazgjidhura bilaterale të cilat datojnë nga luftërat e viteve të 90 të cilat ajo i ka shkaktuar.

CIA gjithashtu ka publikuar në sajtin e vet se Serbia sipas shpenzimeve për armatim të ushtrisë së vet, gjendet në vendin e 85 prej 153 vendeve botërore të cilat gjenden në këtë listë dhe se për këtë është para Kroacisë e cila është e 91-ta, por prapa Malit të Zi e cila gjendet në vendin e 64.

GJERMANËT E ÇOJNË THAÇIN NË BELLORUSI, NJË KUNDËRSHTAR I KOSOVËS

Të mërkurën, presidenti Thaçi pritet të mbajë një fjalë rasti në një panel me Kryeministren e Serbisë, Ana Brnabić, me moderator ish-ambasadorin Ischinger, ndërkaq panelin do ta hapë Ministri i Punëve të Jashtme të Bjellorusisë, Vladimir Makei

Një nga ish-republikat sovjetike e cila ka kundërshtuar ashpër bombardimet ndaj Jugosllavisë dhe pavarësinë e Kosovës Bellorusia ka lejuar pjesëmarrjen e Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi të shkojë në Minsk për të marrë pjesë në takim dhe Grupit Kryesor të Konferencës së Sigurisë të Mynihut, një ngjarje e nivelit që mbledh protagonistë kryesorë rajonalë, krerë shtetesh dhe të organizatave ndërkombëtare, ministra, deputetë, drejtues të OJQ-ve dhe gazetarë, për të diskutuar për çështje

rajonale dhe globale të sigurisë.

Në fakt, Thaçi atje është ftuar nga diplomati gjerman që është shef i Konferencës së Sigurisë së Mynihut, Ëlfgang Ischinger.

Për udhëtimin e tij Thaçi ka njoftuar në Facebook.

“Rrugës për në Bjellorusi, për të marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë në Minsk. Në këtë ngjarje që mbledh protagonistë kryesorë rajonalë, krerë shtetesh dhe të organizatave ndërkombëtare, do të diskutojmë për çështje rajonale dhe globale të sigurisë. HTH” ka

shkruar ai.

Atje, përveç Thaçit do të jenë edhe zyrtarë tjerë shtetesh që nuk e kanë njohur Kosovën, përfshirë edhe shefen e qeverisë së Serbisë Ana Brnabić me të cilën Presidenti do të flasë në një panel.

“Të mërkurën, presidenti Thaçi pritet të mbajë një fjalë rasti në një panel me Kryeministren e Serbisë, Ana Brnabić, me moderator ish-ambasadorin Ischinger, ndërkaq panelin do ta hapë Ministri i Punëve të Jashtme të Bjellorusisë, Vladimir Makei” thuhet në njoftim.



Bellorusia ka mbajtur qëndrim të fortë kundër pavarësisë. Një ambasador i saj në Serbi kishte thënë se Minsk’u nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës.

Ndërsa, në shkurt të këtij viti, Presidenti i Bellorusë Olexander Lukashenko i i cili me dekada udhëheq më dorë të fortë me këtë shtet kishte zbutur qëndrimin duke thënë se gjithçka është vonë rreth Kosovës.

Ai kishte thënë se “ka qenë e nevojshme që të mos lejohet ndarja e Ballkanit dhe dhe ka qenë

e nevojshme që të mbrohet Jugosllavia” dhe se “është shumë të këndohen këgë”.

Procesi ka filluar një kohë të gjatë dhe ende është duke vazhduar. Mali i Zi ka shkuar, republikat tjera po ashtu. Kosova ka mbetur. Kjo është një vazhdimësi e shpërbërjes. Ne ekemi humbur ndikimin moti. Kjo s’është dashur të lejohet pra çështjet rreth pavarësisë. A mund ta influencojmë në këtë proces? Jo, nuk mundemi, ta themi këtë sinqerisht” ka thënë Lukashenko.

GJETJET E NJË STUDIMI

MYSLIMANËT MË TË MIRËPRITUR NË EVROPËN PERËNDIMORE

Në Evropën Perëndimore, për dallim, shumica e njerëzve nuk e ndjejnë se feja është një pjesë e madhe e identitetit të tyre kombëtar. Për shembull, në Francë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, shumica thonë se nuk është e rëndësishme të jesh i krishterë, për të qenë francez ose britanik i vërtetë



Perdja e Hekurt që dikur ndante Evropën mund të jetë zhdukur kohë më parë, por kontinenti sot shtë i ndarë nga dallimet e mëdha në qëndrimet e publikut ndaj fesë, pakicave dhe disa çështjeve sociale, si martesat e homoseksualeve apo aborti.

Krahasuar me evropianët perëndimorë, më pak banorë të Evropës Qendrore dhe Lindore do t'i mirëprisnin myslimanët ose hebrenjtë në familjet ose lagjet e tyre, thuhet në një studim të Qendres Amerikane të Kerkimeve Pew.

Studimi u bë në periudhën 2015-2017 me afro 56,000 të rritur në 34 shtete të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore.

Ndarja kontinentale në qëndrimet dhe vlera në disa raste është ekstreme.

Për shembull, në pothuajse çdo vend të Evropës Qendrore dhe Lin-

dore, më pak se gjysma e të rriturve të anketuar thonë se do të ishin të gatshëm të praninin myslimanë në familjet e tyre; në gati çdo vend të Evropës Perëndimore, më shumë se gjysma e të anketuarve thonë se do të praninin myslimanë në familjet e tyre.

Një ndarje e ngjashme shfaqet midis Evropës Qendrore / Lindore dhe Evropës Perëndimore në lidhje me pranimin e hebrenjve në familje.

Për ilustrim, në Holandë, 96% e të anketuarve kanë thënë se do të praninin myslimanë apo hebrenj në familjet e tyre, 95% në Norvegji, 92% në Danimarkë. Nga vendet e Evropës Qendrore / Lindore, në Armeni vetëm 7% janë shprehur pro pranimit të myslimanëve apo hebrenjve në familje, në Republikën Çeke 12%, në Bjellorusi 16%.

Evropianët perëndimorë po ashtu janë më të prirë se ata në Evropën Qendrore dhe Lindore që të pranojnë myslimanë në lagjet e tyre. Për shembull, me "po" janë përgjigjur 83% e finlandezëve, krahasuar me 55% të ukrainasve.

Studimi i Qendrës Pew po ashtu nxjerr në pah se për shumë njerëz që kanë jetuar në ish-bllokun lindor, të qenët i krishterë – katolik ose ortodoks – është një komponent i rëndësishëm i identitetit të tyre kombëtar.

Në Evropën Perëndimore, për dallim, shumica e njerëzve nuk e ndjejnë se feja është një pjesë e madhe e identitetit të tyre kombëtar. Për shembull, në Francë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, shumica thonë se nuk është e rëndësishme të jesh i krishterë, për të qenë francez ose britanik i vërtetë. Nga ven-

det e Evropës Qendrore / Lindore, në Armeni 82% e të anketuarve e shohin fenë si shumë të rëndësishme, në Gjeorgji 81%, në Serbi 78%.

Ndarja Lindje-Perëndim është po ashtu e dukshme në shovinizmin kulturor. Qendra Pew i ka pyetur qytetarët anembanë kontinentit nëse pajtohen me deklaratën: "Njerëzit tanë nuk janë të përsosur, por kultura jonë është superiore ndaj të tjerave".

Ndonëse ka përjashtime, evropianët e Evropës Qendrore dhe Lindore në përgjithësi janë më të prirë të thonë se kultura e tyre është superiore.

Tetë vendet ku ky qëndrim është më i përhapur janë të gjitha gjeografikisht në lindje: Greqia, Gjeorgjia, Armenia, Bullgaria, Rusia, Bosnja, Rumania dhe Serbia./REL



Sa fitojnë mjekët në Zvicër?

Të ardhurat e profesionistëve të pavarur mjekësorë janë studiuar edhe më herët. Megjithatë, studimet ishin të diskutueshme për shkak të dobësive metodologjike. Rritja e punës me orar të shkurtuar nuk ishte marrë parasysh. Në studimin e ri, të ardhurat tani janë standardizuar në pozita me orar të plotë

Të ardhurat e mjekëve të vetëpunësuar janë shumë më të larta se sa më parë. Këtë e ka treguar një studim i Zyrës Federale të Shëndetit Publik (BAG), i cili u publikua të hënën. Të ardhurat mesatare kapin shumën deri 257,000 franga.

Në varësi të sektorit shëndetësor, të ardhurat janë edhe më të larta. Për shembull, neurokirurgët kanë të ardhura mesatare prej 697,000 frangash dhe gastroenterologët me 627,000 franga. Mjekët e kujdesit primar kanë të ardhura mesatare prej 237,000 frangash. Specialistët e pavarur mjekësor fitojnë më së paku 183,000 franga në repartin e psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve dhe 195.000 franga në psikiatri dhe psikoterapi.

Studimi bazohet në të ardhurat që i nënshtrohen AHV-së për vitet 2009-2014.

Studimi gjithashtu tregon se profesionistët mjekësorë gra fitojnë sistematikisht më pak se burrat. Hendeku i të ardhurave është 29 për qind, shkruan BAG.

Të ardhurat e profesionistëve të pavarur mjekësorë janë studiuar edhe më herët. Megjithatë, studimet ishin të diskutueshme për shkak të dobësive metodologjike. Rritja e punës me orar të shkurtuar nuk ishte marrë parasysh. Në studimin e ri, të ardhurat tani janë standardizuar në pozita me orar të plotë.

Ky studim eliminon këto mangësi, shkruan BAG. Kjo tregon se të ardhurat e profesionistëve të vetëpunësuar të mjekësisë të standardizuara në pozicione të rregullta kohore janë rreth 30 për qind më të larta se shifrat e publikuara më parë. /Albinfo.ch

PRETENDENTËT KRYESORË PËR POSTIN E MERKELIT

Besnikë ose rebelë, kandidatët pasues të Angela Merkel në kupolën e partisë së saj (CDU), për të siguruar më pas një ndenjëse drejt Kancelarisë gjermane, nuk mungojnë aspak. T'i hedhim një vështrim pretendentëve kryesorë të deklaruar dhe të pritshëm.

ECILËSUAR

"MERKEL E SARRES"

E cilësuar "Merkel e Sarres" rajoni më i vogël i Gjermanisë, që është dhe origjina e saj Annegret Kramp-Karrenbauer, 56 vjeçe shfaqet si besnike e kancelares me të cilën ndan një linjë politike kryesisht centriste.

Katolike, ajo shfaq qëndrimet më tepër konservatore sesa Angela Merkel për çështjet sociale si aborti apo martesë për të gjithë. Ajo lëshoi gjithashtu kritika të matura në lidhje me politikën me dritë të hapura të kancelares ndaj qindra mijëra azilkërkuesisht në vitin 2015.



JENS SPAHN – REBELI

I moshës 38-vjeçare, Jens Spahn është pozicionuar si "anti-Merkel". Ai u zgjodh ministër i Shëndetësisë në pranverë për të kënaqur linjën e ashpër të CDU-së, ai nuk reshti së kritikuar vijën e kancelares që sipas tij, do ta kishte shndërruar CDU-në në "social-demokratë". Ai kërkon një ndryshim konservator, veçanërisht në çështjet e identitetit dhe emigracionit.

Ai nuk fsheh afërsinë e tij ideologjike dhe si brez me kancelarin e

ri austriak, Sebastian Kurz i cili qeveris me ekstremin e djathtë.

ARMIN LASCHET – KOMPROMISI

Ai mund të jetë kompromisi i duhur. Pasi drejtuesi i landit të Nordrhein-Westfalisë ka për të qenë një fitues, pasi ia doli mbanë të fitonte në vitin 2017 këtë rajon industrial dhe më të populluarin e Gjermanisë nga socialdemokratët.

Ai qeveris me Liberalët e FDP-së, aleat tradicional i CDU-së, që Merkel nuk ka marrëdhënie të mira. Udhëheqësi i kësaj partie,

Christian Lindner, madje u shpreh se Laschet "ka atë që duhet për t'u zgjedhur kancelar", një kompliment pas një karriere të gjatë të kufizuar në rolet e dyta.

FRIEDRICH MERZ – REVANSHISTI

Friedrich Merz, 62 vjeç, nuk ia fali kurrës kancelares pse e shkarkoi në vitin 2002 nga funksionet si kreu i deputetëve konservatorë në Bundestag.

Disa vite më vonë, i privuar nga të drejtat brenda partisë, ai lë politikën aktive për të punuar në sektorin privat si avokat, përpara se të bëhej kryetar i bordit mbikëqyrës të degës së madhe gjermane "Blackrock", menaxhere e aseteve.

Ai vazhdon gjithsesi të shfaqet rregullisht në debatet publike. Me pikëpamje ekonomike neo-liberale, ai ka kritikuar në mënyrë të përsëritur linjën "shumë të majtë" të mbajtur nga ana e kancelares Angela Merkel. /ATSH



REPUBLIKA E MAQEDONISË
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta
S h k u p

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 nga Ligji për punonjësit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), neni 22, neni 24, neni 25, neni 26 dhe neni 27 nga Ligji për marrëdhëniet e punës ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2105, 195/2015 dhe 27/2016) dhe Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 07/2018
për punësimin e punitorëve me kohë të caktuar për shkak të rritjes së përkohshme të ngarkesës së punës

Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për shkak të rritjes së përkohshme të ngarkesës së punës, publikon shpallje publike për angazhimin e 12 personave në kohë të caktuar, përdërisa zgjat nevojat e institucionit, më së largu 1 vit, në vendet e punës në vijim:

- Punonjës përgjegjës për punë financiare dhe materiale dhe logaritjen e pagës** në Departamentin për kontabilitet dhe pagesa - **1 realizues;**
 - Kualifikimet e duhura:** Arsimi: i lartë - shkenca Ekonomike, me përvojë pune me së paku 3 vjet;
 - Rroga neto fillestare:** 25.023,00 denarë;
- Kuzhinier** në Departamentin për hoteleri në Parlament, Qeveri, Klubin e organeve administrative, Vila në Shkup dhe objekte të rezidencave - **2 realizues;**
 - Kualifikimet e duhura:** Arsimi: i mesëm - turizëm dhe hoteleri, me përvojë pune me së paku 1 vit në hoteleri - gatim;
 - Rroga neto fillestare:** 14.972,00 denarë;
- Kamerier përgjegjës** në Departamentin e hotelerisë në Parlament, Qeveri, Klubin e organeve administrative, Vilat në Shkup dhe objekte të rezidencave - **2 realizues;**
 - Kualifikimet e duhura:** Arsimi: i mesëm, me përvojë pune së paku 1 vit në hoteleri;
 - Rroga neto fillestare:** 14.152,00 denarë
- Kamerier** në Departamentin e hotelerisë në Parlament, Qeveri, Klubin e organeve administrative, Vilat në Shkup dhe objekte të rezidencave - **3 realizues;**
 - Kualifikimet e duhura:** Arsimi: i mesëm, me ose pa përvojë pune;
 - Rroga neto fillestare:** 13.058,00 denarë;
- Punëtor për kryerjen e punëve ndihmëse** në Parlament, Qeveri, Klubin e organeve administrative, Vilat në Shkup dhe objekte të rezidencave - **1 realizues;**
 - Kualifikimet e duhura:** Arsimi: i mesëm, me ose pa përvojë pune;
 - Rroga neto fillestare:** 12.019,00 denarë;
- Shofer në dispozicion personal** në Departamentin për transport dhe mirëmbajtje të automjeteve motorike - **1 realizues;**
 - Kualifikimet e duhura:** Arsimi: i mesëm, përvojë pune me së paku 1 vit, të posedojë patentë shoferi për kategorinë B;
 - Rroga neto fillestare:** 19.046,00 denarë;

Kandidatët duhet të paraqesin edhe dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje e nënshkruar vet me dorë me mbishkrim të saktë me numër dhe emrin e vendit të punës për të cilën konkurrojnë, të theksuar me numër të telefonit dhe adresën e vendbanimit;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Vërtetim/Dëftesë për arsim adekuat të mbaruar;
- Dëshmi për përvojën e punës për vendin e punës;
Orari i punës përmban 40 orë në javë, ndërsa orari e përcakton punëdhënësi, i cili mund të organizohet në ndërrime, në përputhje me nevojat e procesit të punës.
Shpallja publike zgjat 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, llogaritur edhe ditën e publikimit.
Fletëparaqitjet të paraqiten tek Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, adresa Sheshi "Presveta Bogorodica" nr. 3, 1000 Shkup, përmes arkivit të Shërbimit ose përmes postës.
Fletëparaqitjet të cilat nuk do të paraqiten në afatin e paraparë dhe ato të cilat nuk do të përbajnë dokumentet e duhura, si dhe të cilat nuk do të paraqiten në mënyrën e theksuar më lartë, do të konsiderohen si jo kompleta, jo të rregulluara dhe të parashtruara me vonesë dhe nuk do të mbikëqyren.
Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet.
Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afatin e përcaktuar në pajtim me Ligjin për marrëdhënie të punës.
Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 244/2018

për punësimin e 2 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „IP Qendra Ndërkomunale e Punës Sociale Shkup“ për vendet e punës në vijim:

- SO3102G03005 Referent - Teknik administrativ III, Njësia për punë administrative dhe menaxhim me burime njerëzore, Shërbimi i punëve administrative dhe ndihmëse-teknike **2 realizues(ë)**

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, gjimnaz, ekonomi
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 12.629,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1, Shqiptar(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë. Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ. Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar. Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës. Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton

Shpallje

për punësim me kohë të caktuar deri me 31.12.2018

I. Për nevojat e themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor për Programin e Zbatimit dhe Zhvillimin e TI në Shërbimin Qendror -(1) një ekzekutues.

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas ECTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1-(Informatika, Teknika e Kompjuterit dhe Informatika ose Elektronika dhe Automatizimi);
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë.

II. Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Dëftesën/diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;
- Vërtetimin/dëshminë për përvojë punës;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje e programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje aktive të gjuhëve;
- Dëshminë se nuk është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetimin e shtetësisë.

III. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune-40 orë në javë, nga e hëna deri të premtën, ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

IV. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmi me të cilat vërtetohet plotësimi i kushteve të parapara.

V. Shpallja do të jetë e hapur 3 (tre) ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditor.

VI. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë- shërbimi qendror, rruga "Vasil Gjorgov" nr. 43, Shkup.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
Universiteti „Shën Kirili dhe Metodij“ - Shkup
Fakulteti për elektroteknikë dhe teknologji informatike



Në bazë të nenit 176 nga Ligji për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr 82/2018) dhe neni 51 nga Rregullorja për marrëdhënie të brendshme dhe punë në Fakultetin elektroteknik dhe teknologji informatike në përbërje të Universitetit "Shën Kiril dhe Metodij" në Shkup, dekani i Fakultetit elektroteknik dhe teknologji informatike, shpall

K O N K U R S
për tituj mësimor-shkencor

Shpallet konkurs për zgjedhjen e:

- Një mësimdhënës për të gjithë titujt mësimor-shkencor në lëndët nga sferat mësimore-shkencore **20207 - termocentralet dhe pikat e shpërndarjes,**
- Një mësimdhënës për të gjithë titujt mësimor shkencor në lëndët nga sferat mësimore-shkencore **21808 - inxhinieria e sistemit, automatikë dhe robotikë.**

Kushtet: kandidatët përveç kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parapara nga Ligji për arsim të lartë, duhet ti plotësojnë kushtet e veçanta dhe kushtet tjera në pajtim me aktet e përgjithshme të Universitetit "Shën Kiril dhe Metodij" në Shkup dhe Fakultetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të paraqesin: dokumente për arsim të mbaruar, biografi të shkurtër, Deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, formulari i plotësuar për raportin e përzgjedhjes së titujve mësimor-shkencor, listë e punimeve profesionale dhe shkencore, nga një kopje e punimeve, vërtetim për njohje të gjuhëve të huaja dhe certifikatë për shtetësi.

Orari i punës është në përputhje me orarin e orëve në semestër, rroga fillestare varet nga angazhimi mësimor në semestër. Mësuesi i përzgjedhur krijon një marrëdhënie pune për kohën për të cilën është përzgjedhur.

Fletëparaqitjet me dokumentet e kompletuara të paraqiten përmes arkivit të Fakultetit, ose përmes postës në adresën rr. Rugjer Boshkoviç 18, Shkup.

Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Nga FETI

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 nga Vendimi për kushtet dhe mënyra e dhënies me qira të pasurisë së patundshme në pronë të qytetit të Shkupit numër 07-7450/1 nga 30.10.2014 lajmëtarë Zyrar i Qytetit të Shkupit nr.12/14, Vendimi i këshillit Shkollor nr. 02-1268/2 nga 08.10.2018 dhe miratimi i fituar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit nr. 08-8712/2 nga 12.10.2018, SHMETQSH "Mihajlo Pupin" - Shkup publikon:

SHPALLJE

për dhënien e hapësirës shkollore me qira

I. Qiramarrësi: SHMETQSH "Mihajlo Pupin" - Shkup me seli në bul."Blagoja Stefkovski" pn - Shkup, tel.02 2529703.

II. Lënda për qira përbëhet nga:

1. Hapësira e oborrit me sipërfaqe prej 30m2 për vendosjen e objektit kohor për sandviçë

1.1. Çmimi fillestar për ankandin publik me hapësirën e theksuar është 308,00 denarë për 1m² pa TVSH të përfshirë.

2. Afati dhe kushtet që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit:

2.1. Shpallja zgjat 15 ditë nga dita e publikimit.

2.2. Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjithë personat juridik të interesuar të cilët deri te komisioni për ankandin publik do të paraqesin dokumentacionin në vijim:

- Fletëparaqitje që do të merr pjesë në ankandin publik
- Dokument për veprimtarinë e regjistruar, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Dokumentacioni të paraqitet në zarf të mbyllur me shenjë "mos e hap" dhe me shenjë "për shpalljen për dhënien me qira të hapësirës shkollore 2018" dhe të paraqiten përmes postës, posta e shpejtë në adresën bul. "Blagoja Stefkovski" pn - Shkup, ose në arkivin e shkollës, më së voni deri në orën 10.00 në ditën e fundit të shpalljes.
- Ofruesi i cili nuk do ta paraqet dokumentacionin e duhur nuk ka të drejtë në pjesëmarrje në ankandin publik.

3. Koha e fillimit të ankandit publik:

3.1. Ankandi publik do të fillojë më 14.11.2018, në orën 12.00 në hapësirat e shkollës.

4. Kohëzgjatja e ankandit:

4.1. Hapësira ipet me qira në periudhë deri më 01.09.2019.

Komisioni për dhënien me qira të hapësirës shkollore pranë SHMETQSH "Mihajlo Pupin" - Shkup

VAJZAT E FSHATIT PROMOVOJNË BUJQËSINË

12 vajza nga fshatra të ndryshme të Gjermanisë janë mbledhur për të bërë një set me foto që tregojnë jetën në fermat e vendit të tyre. Numri 12 është pikërisht sepse bëhet fjalë për një kalendar, kalendarin e Fermerëve të Rinj për vitin 2019, ku vajzat bëjnë poza të bazuara në superheronj si Superman, Thor dhe Ulverin. Qëllimi i këtij kalendari është për të tërhequr rreth 20.000 të rinjtë në fshatrat e Bavarisë, e për t'u treguar rëndësinë e bujqësisë.



ARKIVAT ONLINE, LEHTËSI PËR BLERJEN E DOKUMENTEVE NGA STUDIUESIT

Dokumentet arkivore tashmë mund të merren online, përmes aplikacionit novator të prezantuar sot nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, nën kujdesin e zëvendëskryeminstres Senida Mesi dhe në bashkëpunim me AKSHI.

Përmes këtij aplikacioni, studiuesit mund të porosisin nga çdo vend i botës, në çdo orë të ditës dokumentet që i duhen dhe pasi të kryejnë pagesën përkatëse do të mund t'i marrin brenda 1-5 ditë. Ky aplikacion e rendit arkivin shqiptar ndër më novatorët, tek module të ngjashme ka në vendet më të zhvilluara botërore, si Britania e Madhe, Franca, SHBA, por është vendi i parë Ballkanik, pas Turqisë, që ndjek praktikën më të mira ndërkombëtare.

Moduli "Arkivat online" u prezantua sot gjatë një aktiviteti të zhvilluar me studiues e studentë të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, ku përshëndetën zëvendëskryeminstria Senida Mesi, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Ardit Bido, dekan i



Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, prof. dr. Sabri Laçi dhe dhjetra profesorë të ftuar.

Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Ardit Bido prezantoi modul duke bërë edhe blerjen e parë online të kopjeve të dokumenteve.

"Ky është një prej kulmimeve të strategjisë së digjitalizimit që kemi dy vjet për të cilin po punojmë. Fakti që module të ngjashme kanë vetëm vendet më të zhvilluara botërore dhe asnjë nga vendet e rajonit na vendos në pararojë në Ballkan për të shërbyer sa më shpejtë dhe sa më mirë stu-

diuesit shqiptarë dhe të huaj, duke i dhënë hov zhvillimit të kërkimit shkencor në vend", tha Bido.

Zëvendëskryeminstria Senida Mesi theksoi se shërbimi më i shpejtë i çdo qytetari është një prioritet i qeverisë shqiptare.

"Ky aplikacion mundëson që në çdo kohë të mund ti shërbehen studiuesit, pavarësisht nëse zyrat shtetërore janë të hapura a të mbyllura", theksoi ajo.

"Ne garantojmë mbështetje të plotë për iniciativat e tilla novatore që në fakt vijjnë në përputhje edhe me prioritetet e qeverisë sh-

qiptare për digjitalizimin dhe inovacionin. Njëkohësisht, nxitim bashkëpunimin me politikëbërjen me qëllimin që t'ju përgjigjemi nevojave të tregut dhe të qytetarëve", u shpreh Mesi.

Gjithashtu Drejtoresha e Inovacionit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit Romina Kostani tha se kjo risi kaq e rëndësishme e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave duke sjellë blerjen e dokumenteve online është po aq e rëndësishme edhe për ne si pjesë e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. (ATSH)



Medalioni i panjohur në Gjermani, i porositur nga Ali Pasha

Një medalion i periudhës osmane ndodhet në shtëpinë e ankandit Kunker, Gjermani. Ai mendohet se është porositur në 1807 nga Ali Pasha Tepelena (1741-1822), sundimtari shqiptar Shqipërisë dhe Greqisë, i cili ishte i pavarur nga Porta e Lartë. Në kundërshtim me traditën islame, ajo tregon portretin e një gruaje me kostum oriental ose grek. Ajo quhet Mbretëresha [Vasiliki] Hanim. Hollësi të mëtejshme për këtë medalje jashtëzakonisht të rrallë janë të panjohura.

Imazhi perëndimor i medaljonit dëshmon ndikimin e marrëdhënive të ngushta diplomatike që kishte filluar Ali Pasha Tepelena me Fuqitë e Mëdha në rajon. Në fillim Franca 1798-1800 dhe pastaj Rusia 1800-1807 zotëronin Ishujt Jonianë, fqinjë të Pashallëkut të Janinës.

Ndërkohë që agjentë britanikë si William Martin Leake ishin të pranishëm në rajon. Në dhjetor 1806, Porta e Lartë i hapi luftë Rusisë dhe Ali Pashë Tepelena nxitoi të përfitonte duke arrestuar konsujt rusë në territoret e veta dhe me artilerinë, që kishte marrë nga francezët u përpoq të sulmonte ishullin e Shën Maurës, por rusët ngritën kundër tij feudalët çamë dhe armatolitet e Thesalisë. Ali Pasha u pajtua me feudalët çamë, kurse i biri i tij Myftari e mbyti në gjak kryengritjen e armatolite në Thesali.

Kur Fransua Pouqueville i emëruar konsull i përgjithshëm i Francës, mbritti në Janinë në 1806, i sollti Ali Pashë Tepelens dhe premtimin e Napolonit se do t'i jepte nën administrim ishullin e Korfuzit nëse do të angazhohej në luftë kundër rusëve.

Tashmë Ali Pasha Tepelena zotëronte gjithë bregdetin e Çamërisë dhe po shikonte që të merrte në zotërim dhe Korfuzin dhe Ishujt Jonianë. Paqja e Tilsitit në vitin 1807 midis Francës dhe Rusisë bëri të mundur largimin e rusëve nga ishujt jonianë, zotërimin e tyre sërish prej Francës dhe largimin e rrezikut rus për të minuar pushtetin e Ali Pashë Tepelens në Epir dhe More.



Kadare gati për të sjellë librin më të ri

Kanë mbetur edhe disa ditë deri në hapjen e Panairit të Librit në Tiranë, atje ku krahas shumë librave të njohur të Kadaresë tashmë vjen edhe libri i tij më i ri "Kur sunduesit grinden", shkruan KultPlus.

Shtëpia botuese "Onufri" sapo ka publikuar imazhin e shkrimtarit të njohur shqiptar Ismail Kadare, i cili po rishikon faqet e fundit të librit të tij më të ri, i cili do të promovohet në Panairin e Librit në Tiranë.


Deri më sot veprat e Kadaresë janë përkthyer në disa dhjetëra gjuhë të botës.

Panairi i 21 i Librit "Tirana 2018" fillon me 19 nëntor dhe zgjatë deri më 18 nëntor.

Henry Marsh rrëfen "brishtësinë" e trurit

Neokirurgu me famë botërore Henry Marsh ka promovuar librin e dytë të përkthyer në shqip me dëshmi nga sukseset dhe dështimet e tij si kirurg i trurit në vende të ndryshme të botës. Në ceremoninë e promovimit, ai thotë se nuk ka ndryshim mes neokirurgjisë në Londër dhe në Tiranë

Publikohet në shqip libri i neokirurgut të famshëm Henry Marsh. Përkthimi është bërë nga dy kolegët e tij shqiptarë, neokirurgu Mentor Petrela dhe mjeku Flor Dashi. Prej moshës 12 vjeçare, neurokirurgu Henry Marsh ka mbajtur ditë. Por gjatë 40 vjetëve të karrierës si mjek, të shkruarit ju kthye në terapi. Pas botimit të bestsellerit të New York Times, "Mos bëj dëm", Marsh vjen në shqip me rrëfimet "Jeta si kirurg i trurit" ku flet më shumë për gabimet e tij sesa për sukseset, flet për vdekjen, kjo për t'u dhënë një mësim edhe mjekëve



të rinj që të jenë të ndershëm me pacientin. "Një nga arsyt pse e shkruajta librin tim, edhe pse nuk e kuptoja gjatë procesit të shkruarit, ishte të edukoja publikun jomjekësor, se mjekët merren më tepër me pasigurtit ndërsa pacientët duan sigurinë. Por ne këtë nuk e realizojmë dot. Dhe në të njëjtën kohë doja të tregoja se mjekët janë njerëzore si gjithë të tjerët", shprehet Henry Marsh, neurokirurg. Kjo vepër është sjellë në shqip nga doktor Mentor Petrela dhe Flor Dashi, të cilët urojnë që përkthimi të jetë sa më afër vërtetësisë së shkrimit. Besimi se ja kanë dalë të realizojnë një përkthim të mirë është të bazuarit në fjalorin e

pasur të shkrimtarëve shqiptarë si Ismail Kadare dhe Martin Camaj.

"Ju si edhe unë jeni lexues, dhe kur lexojmë ëndërojmë, por të shkruash domethënë të mendosh më tepër seç duhet, ndërkohë përkthimi tani që e provuam, është një lloj frike se mos tradhton atë që thotë autori", tha Mentor Petrela, neurokirurg. "Prof. Petrela më kujtohet se më thoshte në librin e parë para se të nisim përkthimin, se unë gjej veten në 99% të rasteve në atë libër. Pra ky përgjithësim, jo të detajeve, por të mesazheve që ka mjeku me pacientët e bën që libri të përkthehet sa thjeshtaq edhe vështirë, me përgjegjësi", shton mjeku Flori Dashi.

“Ndeshja e nesërme është shumë e rëndësishme për ne. Siç e dini në tabelën e klasifikimit nuk jemi aty ku të gjithë kemi pritur, por shpresojmë që nëse arrijmë të radhisim disa ndeshje të mira do të arrijmë të dalim nga kjo krizë e rezultateve”, ka deklaruar mbrojtësi i FC Shkupit, Bllagoja Ljamçevski

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 30 tetor - Pas takimeve të zhvilluara gjatë vikendit në Ligën e Parë, në fundjavë në program do të kemi ndeshjet e javës së dymbëdhjetë. Skuadra e FC Shkupit pas disfatës të pësuar nga Pobeđa në xhiron e kaluar, të mërkurën në stadiumin e Çairit do të jetë nikoqire e Akademija Pandev, të cilët në 11 javët e para kanë arritur të marrin rezultate shumë të mira dhe këtë e dëshmon edhe pozita e tretë në tabelën e klasifikimit. Ekipi i Shkupit ndaj Akademija Pandevi do të mundohet që të gjej rrugën e fitoreve dhe kështu për tu larguar nga kriza e rezultateve që ka ka-

LIGA E PARË - JAVA E XII

SHKUPI NDAJ AKADEMIJA PANDEVIT KËRKON TË GJEJ RRUGËN E FITOREVE



pluar skuadrën. Mbrojtësi i majtë i skuadrës së FC Shkupit, Bllagoja Ljamçevski ka theksuar se ndaj Akademija Pandevit do të japim më të mirë për të marrë rezultat pozitiv dhe për të dalë nga kjo krizë. “Ndeshja e nesërme është shumë e rëndësishme për ne. Siç e dini në tabelën e klasifikimit nuk jemi aty ku të gjithë kemi pritur, por shpresojmë që nëse arrijmë të radhisim disa ndeshje të mira do të arrijmë të dalim nga kjo krizë e rezultateve. Me trajnerin e ri po punojmë mirë

dhe me shumë përkushtim dhe mendoj se do të vijmë punët në vend të vet dhe Shkupi do të jetë përsëri në pjesën e sipërme të tabelës”, ka deklaruar mbrojtësi i FC Shkupit, Bllagoja Ljamçevski. Për ndeshjen ndaj Akademija Pandev mungesë e vetme për skuadrën e Shkupit do të jetë Basilio Ndong, i cili vazhdon të jetë i lënduar. Nga ana tjetër, skuadra e Shkëndijës do të udhëtojë drejt Strumicës për të përballur me ekipin e Bellasicës. “Kuezinjtë”, në këtë përballje do

të futen me një synim të vetëm, për të marrë tre pikët e reja. “Jemi përgatiti maksimalisht për sfidën e radhës me skuadrën Bellasicës. Jemi të vetëdijshëm se në Strumicë na pret një ndeshje e vështirë, por besoj që neve jemi të gatshëm dhe të përgatitur për të dhënë më të mirën që nga ky takim të dalim me rezultat pozitiv. Kemi gjetur formën tonë që nga ndeshje në ndeshje shkon në ngritje e sipër, dhe besoj që këtë formë të manifestojmë edhe në

TAKIMET E JAVËS SË XII
SHKUPI - AKADEMIJA P
BELLASICA - SHKËNDIJA
RENOVA - SILEKSI
MAKEDONIJA GJ.P - VARDARI
RABOTNIČKI - POBEDA

takimin e ditës së mërkurës, për të treguar një tjetër paraqitje dinjitoze dhe që është me rëndësi në fund të dalim me tre pikë nga ky duel”, theksoi Visar Musliu. Nga ana tjetër, ekipi i Renovës pas barazimit xhiron e kaluar ndaj Vardarit në terren mysafirë, të mërkurën në Tetovës do të presin Sileksin e Kratovës. Xhepçishtasit që po kalojnë nëpër një super-formë, synojnë fitoren e radhës kundër veriorëve të cilët ndeshjen e fundit e mundën Rabotničkin. Renova kërkon fitoren e cila do i largonte nga zona e rrezikut. Në takimet tjera, skuadra e Rabotničkit do të pret Pobeden dhe Makedonija GJ.P do të luaj me liderin e tabelës, Vardarin. Të gjitha përballjet do të zhvillohen të mërkurën (sot) me fillim prej ora 13:30.

Stratev: Të formohet Ligë për të rinj deri në moshën 21 vjeçare

Shkup, 30 tetor - Qendra për studime të sportit “CIES”, ka analizuar skuadrat e 31 kampionateve kombëtare të cilat kanë prodhuar talentë të rinj për një afat një vjetor. Në hulumtimin e tyre këta kanë shfrytëzuar rregulloren e UEFA-së, në të cilën bëhet fjalë për futbollist të moshës prej 15 deri 21 vjeç, e që në tre sezonet e fundit kanë luajtur tek skuadra e tyre e tani luajnë në skuadër tjetër. Duke shikuar këto hulumtime të CIES-it, skuadrat e Maqedonisë janë të humbura në këto të dhëna për zhvillimin e talentëve të futbollit. Përgjegjësit e futbollit të rinjve në FFM, pajtohet me atë se talentët e rinj në Maqedoni, humben në moshën 18



vjeçare. “Gjithsesi se ky është problem i madh. Sipas meje ka dy mundësi se si futbollistët e rinj të mbahen në futboll. E para është ajo që të formohet një Ligë për të rinj deri në moshën 21 vjeçare. Ku këta futbollist do të

luanin. Mënyra e dytë është që klubet futbollistëve që përfundojnë stazhin e futbollistit të ri t’ju japin më shumë mundësi për të luajtur, futbollistëve, por për fat të keq kjo tek ne nuk është ashtu”, thotë Zoran Stratev, drej-

tor teknik i përfaqësuesve të shpresave të Maqedonisë. Në vend të parë të kësaj renditje të prodhimit të futbollistëve të rinj është Ajaks, i cili ka zhvilluar plotë 77 futbollist të rinj. Në raportin e CIES, shkruan se nga ish Jugosllavia zhvillim të madh të talentëve kanë Partizani i Beogradit dhe Dinamo e Zagrebit. Në Maqedoni funksionojnë me qindra klube të futbollit në të cilët stërviten me mijëra të rinj. Vetëm në komunën e Çair, me një sipërfaqe prej 3.52 kilometra katror funksionojnë 11 shkolla futbollit, ndërsa në Tetovë me rrethinë kemi 17 shkolla futbollit në të cilët stërviten futbollist të rinj gjurma e të cilëve humbet kur të mbushin 17 apo 18 vjet.



Referat pësojnë më së rëndi

Shkup, 30 tetor - Ofendimet dhe fyerjet e referave në ndeshje e ligës së parë janë sekrete publike. Mirëpo, sulmi referave në ligat e pionerëve ndodhë vetëm në Maqedoni. Kështu edhe ndodhi në ndeshjen mes Maqedonia Gjorçe Petrov dhe Renovës, me çka u sulmua gjyqtari kryesor i takimit Besar Abduli. Nga FFM, kanë njoftuar se i gjithë rasti është i denoncuar në MPB, ku për momentin janë duke u marrë masa për zbardhjen e rastit. Të dhënat nga terreni flasin se deri te ky incident ka ardhur pasi që një pjesë e prindërve që e kanë përcjellur ndeshjen, nuk kanë qenë të kënaqur me mënyrën se si ka referuar Abdylit, përfshi edhe sjelljen e tij. Njëkohësisht sulm ndaj referave është regjistruar edhe në Ligën e Tretë-Perëndim, gjegjësisht në ndeshjen mes Sateskës dhe Ohrid Lihnidos, referi ka qenë i sulmuar nga kryetari i Komunës së Volinoës, i cili i ka dëmtuar akuzat në fjalë. (F.N)

Kosova do të ndërtojë stadium të ri dhe modern

Zhuri do të bëhet me stadium të ri e modern që i plotëson nevojat e sportistëve zhurianë. Kështu u shpreh Ministri i Sportit, Kujtim Gashi, i cili mori pjesë në vënien e gurthemelit të stadiumit. Ky projekt kapital vjen në kuadër të plotësimin të infrastrukturës sportive fizike në të cilin Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të investojë 700 mijë euro, ndërkaq Komuna e Prizrenit do të ndajë 200 mijë sosh. Ministri Kujtim Gashi e ka



vlerësuar këtë projekt si të rëndësishë së veçantë për sportistët e

Zhurit me rrethinë. Ministri me këtë rast i uroi klubin dhe qyte-

tarët e Zhurit me rrethinë. “Ka qenë ëndërr për sportistët e futbollistët e talentuar për këtë stadium. Është projekt që financohet me një pjesë të madhe nga ministria dhe me një participim nga Komuna e Prizrenit”, ka thënë ministri. “Zhuri njihet edhe në të kaluarën që ka pasur një klub shumë të suksesshëm. Besoj që sot Zhurit dhe fshatrave përreth po ia krijojmë një mundësi të re”, ka thënë mes tjerash ministri.

GJASHTË FITORE RADHAZI, VENDI I DYTË DHE MBROJTJA MË E MIRË

Interi i Spallettit duket se ka mësuar nga tronditja e fillimit të sezonit, duke marrë edhe gjashtë fitore radhazi në kampionat. E gjitha kjo, pa harruar soliditetin e paprecedentë mbrojtës, duke pasur parasysh se Interi aktualisht ka pësuar vetëm 6 gola në 10 javë kampionat



Çdo gjë ndryshoi mbrëmjen e 18 shtatorit, kur fitorja ndaj Tottenham erdhi në minutën e 92. Dhe vetëm tri ditë pas disfatës turpëruese kundër Parmës, Vecino i dha fitoren Interit në ndeshjen e dytë të fazës në grupe të Ligës së Kampionëve. Që atëherë, Interi i Spallettit duket se ka mësuar nga tronditja e fillimit të sezonit, duke marrë edhe gjashtë fitore radhazi në kampionat. Këto triumfe kanë ardhur me pragmatizëm (ndaj Fiorentinës dhe SPAL), të tjerët "klinikisht" (ndaj Sampdorias dhe në derbin e Madoninës), ndërsa nuk kanë munguar edhe ato bindës në

planin e lojës, si kundër Cagliarit dhe sidomos mbrëmë, në "Olimpico", ndaj Lazios. Kundër bardhekaltërve, në fakt, ndoshta pamë Interin më të mirë të këtij sezoni: të aftë për të shkatërruar një konkurrent direkt për një vend në Ligën e Kampionëve, veçanërisht në pjesën e parë, kur Lazio e paven veten më në vështirësi se kurrë. Edhe një herë, "lokomotiva" që tërheq "vagonët" zikaltrë është kapiteni Mauro Icardi (realizoi dopietë). Sulmuesi argjentinas, më në fund është bërë i njohur edhe në nivelin europian. Spikati edhe Marcelo Brozovic, i cili, përveç go-

lit ndaj Lazios, tregoi se është një katalizator në "dhomën e kontrollit" të lojës zikaltrë. E gjitha kjo, pa harruar soliditetin e paprecedentë mbrojtës, duke pasur parasysh se Interi aktualisht ka pësuar vetëm 6 gola në 10 javë kampionat. Më pak se çdo ekip tjetër në Seria A, duke përfshirë edhe Juventusin. Kjo është arsyeja pse në këtë kampionat, Interi po e përvijon veten dukshëm si rivali i vetëm për titullin e Juventusit. Dhe jo vetëm për lidhjen me vendin e dytë aktualisht, që e bashkëndon me Napolin. Në javët e ardhshme, Interi duhet të njoftojë nën-

shkrimin me Giuseppe Marotta, drejtues i sprovuar në Seria A, që vjen nga Juventus pas shtatë titujsh kampioni radhazi. Një hap i mëtejshëm, që përpiket të kthejë zikaltrin në krye të futbollit italian, por pa nisur me proklamime të mëdha. Të qarta në këtë drejtim janë fjalët e kapitenit Mauro Icardi, menjëherë pas Lazio-Inter 0-3, të cilat e kanë shuar entuziasmin e të gjithë mjedisit zikaltrë: "Ne anti-Juve? Jo, kemi ende disa hapa për t'u rritur". Sidoqoftë, ky Inter, të paktën për momentin, me të vërtetë duket në rrugë të drejtë.



Dele Alli firmos kontratën e re, dyfishon shifrat

Dele Alli ka firmosur një kontratë të re gjashtë vjeçare me Tottenham-in. Marrëveshja e re mendohet të jetë në shifrën e 90.000 paund në javë dhe skadon në vitin 2024. 22 vjeçari, pjesë e kombëtares angleze i është shtuar listës së gjatë që e shohin të ardhmen në këtë ekip si Harry Kane, Davinson Sanchez dhe Kieran Trippier. Alli është rikthyer pas dëmtimit të tij teksa kanë fituar 1-0 ndaj Manchester City-t këtë të hënë. Përfaqen zyrtare të ekipit, Dele Alli ka thënë: "Jam nderuar që kam firmosur një kontratë të re deri në 2024. Do doja të bëja një falënderim të madh për presidentin, menaxherin, shokët e mi të ekipit dhe tifozët. Mezi pres të shoh çdo më rezervojë e ardhmja. Nuk mund ta shihja askund tjetër vetëm time teksa rritesha si lojtar".



Vettel: Ky mbetet sezoni më i vështirë i karrierës

Për Sebastian Vettel, viti 2018 mbetet "sezoni më i vështirë në karrierë". Në një intervistë për "Autosport", piloti gjerman i Ferrarit analizon aventurën e tij të këtij viti, pak ditë pasi humbi shansin të duelojë për titullin kampion. "Nuk ka asnjë dyshim për mua, ky mbetet një nga sezonet më të vështira. Ishte një vit ndryshe nga të tjerët. Botërori për mua është i mbyllur, por jemi ende në garë për titullin e konstruktorëve dhe mund t'i bëjmë një dhuratë Ferrarit", tha Vettel. "Mund t'ia dalim mbanë, pasi kemi një makinë të shpejtë, më të shpejtë se Mercedes dhe mund t'i fitojmë dy garat e mbetura. Për mua ky mbetet një sezon delikat dhe i vështirë, ndërsa për Ferrarin një vit më i mirë se ai i kaluarit", tha Vettel. Piloti gjerman shprehet se gara e Singaporit i vuri vulën titullit kampion, garë ku kuptoi se nuk kishte më asnjë shans për të mundur Hamilton. Një deklaratë disi e çuditshme, pasi piloti harron garat e Monzës apo Gjermanisë, ku humbi pikë të rëndësishme për fajin e tij. "Nga Singapori deri në Amerikë nuk mbajtëm dot ritmin e Mercedes për disa gara. Ndodhën edhe disa gjëra të tjera që në penalizuan, përfshi edhe gabimet e mia dhe kjo situatë nuk na ndihmoi. Por të gjitha këto bëjnë pjesë në punën tonë", u shpreh Sebastian Vettel.

Rossi: Nuk mendoj për vendin e dytë, po punojmë për 2019-ën

Valentino Rossi ka mbetur i pakënaqur nga gara e zhvilluar në pistën australiane e Phillip Island, ku ai synonte podiumin, por në fund u detyrua të kënaqet me vendin e gjashtë. Për pasojë, piloti italian i Yamaha ka humbur edhe më shumë terren karshi patriotit të tij Andrea Dovizioso me Ducatin në sfidën për vendin e dytë në Moto GP. "Ishte një fundjavë e vështirë dhe gjatë gjithë garës vuajta me gomën e pasme. Nuk e prisja këtë gjë, pasi kjo situatë më penalizoi", tha Rossi. Një ankesë disi e çuditshme, pasi shoku i tij i skuadrës Maverick Vinales fitoi në këtë garë, duke bërë një para-

qitje më të mirë me motorin tjetër Yamaha. "Diferenca me Maverick? Të dy punuam njësoj me gomat gjatë fundjavës. Ai arrin t'i japë menjëherë shpejtësi motorit, ndërsa unë humbas pak kohë. Duhet kuptuar përse, për ta përmirësuar këtë ngërc në garat e radhës", u shpreh më tej Valentino Rossi, i treti në renditjen e Moto GP. Pavarësisht kësaj, italiani i Yamaha shprehet se tashmë për të ka nisur puna për 2019-ën, për të kuptuar sektorët ku ai dhe inxhinierët duhet të punojnë. "Natyrisht që të renditem i dyti është më mirë se sa i treti, por tashmë kjo nuk përbën ndonjë diferencë të madhe.



E rëndësishme është që të provojmë gjëra të reja dhe që na shërbejnë për të ardhmen. Dhe, mbi të gjitha, shpresojmë që ato të funksionojnë si duhet për të mirën e Yamaha", tha Rossi.



Novak Djokovic e nisi vitin 2018 në vendin e 22-të, por tashmë ai ka një "2" më pak në renditje dhe synon që këtë vit ta mbyllë në vendin e parë. Tenisti serb do të debutojë sot në turneun e

Djokovic: Jam në formë të shkëlqyer e dija që do të rikthesha kampion

fundit Masters të këtij sezoni, atë të Parisit, me shpresën që javën e ardhshme të jetë në majën e klasifikimit. "Fakti që Nadal nuk luajti në turnetë aziatikë më dha mundësinë që të afrohem me të në renditje dhe të synoj vendin e parë. Madje kam mundësinë që ta mbyll këtë vit në krye, çka do të ishte diçka fantastike", tha Djokovic. Më tej, tenisti serb shtoi: "Jam në formën optimale, kam

qenë pushim javët e fundit dhe kam arritur të rikuperoj nga problemet e vogla fizike apo lodhja. Të jem si singertë, në turnetë e fundit kam zhvilluar ndeshje shumë të mira, çka konfirmon se jam më në formë se kurrë më parë. Nuk dua të jem arrogant, por kam besuar se një ditë do të rikthesha fitues dhe ia dola mbanë. M'u desh pak kohë, por arrita të triumfoj sërish", u shpreh Djokovic.

KRISTOFOR KOLOMBI ZBULOI TRINIDAD & TOBAGO, DORTMUNDI JADON SANCHO!

Në Gjermani trumpetohet si çmenduri nga Dortmund në moment krize. Por, në ato anë, kur flitet për talente, kanë më shumë se dy sy. Dhe pasi viti i shkuar ishte mes të rinjve dhe ndonjë grumbullimi në ekip të parë, ky sezon po tregon se ato 10 mln eurot ishin thjesht "qindarka" për dikë si Jadon



Në udhëtimin e tij tretë rreth botës, eksploruesi Cristofor Colombi do të zbulonte dy ishuj, të cilat më pas do t'i quante Trinidad & Tobago... Deti i Karaibeve, natyra ekzotike dhe sidomos mrekullia e natyrës. Por, fatkeqësisht... varfëri totale. Jo më kot, shumë familje, duke hipur në anije të mëdha, janë arratisur drejt një horizonti shpresdhënës, me optimizëm dhe për një jetë shumë më të mirë. Spanjë, Portugali, Francë e deri në Angli. Aty ku në Londër, shumë vite më parë, një familje do të zbarkonte për të gjetur strehim në periferi. Të jetosh në Angli është e pamundur të mos luash futboll. Sidomos, nëse ky sport është tuneli drejt daljes nga varfëria dhe fitimi i bukës së gojës. "I vogël qëndroja vetëm rrugëve: doja të bëhesha dikushi dhe të nxirrja familjen time nga ato shtëpi popullore që shteti na kishte dhënë...". Histori të

dëgjua shumë herë, por fatkeqësisht të vërteta. Uria, dëshira për t'ia dalë, që e bëjnë shpesh diferencën në futboll dhe Jadon Sancho po e provon mbi lëkurë duke dhënë një tjetër shembull për t'u frymëzuar. Nëpër rrugë, ashtu si shumë fëmijë të tjera, Jadon argëtohet. Ndërkohë, scout të klubeve të ndryshme provojnë që të zbulojnë sa më shumë talente... Në ato anë kalojnë pjesëtarë të klubit Watford dhe menjëherë i thonë: "Eja në Akademinë tonë!". Por, Manchester City është më i pushetshëm dhe futet në mes, duke e bërë të sajën të voglin Jadon. Është

vetëm 14 vjeç, por çfarë potenciali. Në Angli nis të dallohet, ndërsa vitina më e rëndësishme është European U-17, kur me gola, asiste dhe driblime të çmendura bën që publiku të dashurohet: ato të mosshës së tij mbeten të mahnitur dhe kurrë nuk e ndalojnë. Pesë gola në gjashtë ndeshje, duke fituar çmimin si Lojtari Më i Mirë i Turneut. Çmim që më parë kanë fituar lojtarë si Kroos, Rooney, Gotze, Fabregas e kështu me radhë. Një "kartvizitë" e rëndësishme, pra. Te City ndoshta akoma nuk e kanë vlerësuar aq sa duhet. Borussia Dortmund e ka ndjekur dhe e ka kuptuar se ky është një bast për t'u fituar... "Sa doni për Jadon?", i drejtohet Cityt. "Me dhjetë milionë euro jemi të kënaqur", përgjigja. Ndërrohen fakset, shtrëngohen duart dhe për shifrën e mësipërme, një 17 vjeçar pjesë e Akademisë së "Citizens" vishet verdhezi. Në

Gjermani trumpetohet si çmenduri nga Dortmund në moment krize. Por, në ato anë, kur flitet për talente, kanë më shumë se dy sy. Dhe pasi viti i shkuar ishte mes të rinjve dhe ndonjë grumbullimi në ekip të parë, ky sezon po tregon se ato 10 mln eurot ishin thjesht "qindarka" për dikë si Jadon. Pesë gola në Bundesliga dhe Champions, me 7 asiste. Jo vetëm, por edhe debutim me Anglinë. Fundjavën e shkuar, mrekulloi sërish Signal Iduna Park, duke shënuar 3 gola në 70 minuta. Por, i pari u anulua, edhe pse kishte shënuar me thembër. Zëvendësohet ai, Hertha Berlin bazon Dortmund. Por, nuk ka rëndësi kjo, por fakti që në Dortmund ka lindur një yll. Jadon "the rocket" Sancho. Historia e emigrimit, shpresës dhe besimit. Sepse, zbulimin këtë herë nuk e bëri Cristofor Colombi, por Dortmundi, me gjithë respektin.



Plagët e Kievit nuk janë shëruar, Karius barrë edhe te Beshiktashi

U transferua në Turqi nga Liverpooli në radhët e Beshiktashit në formë huazimi për të shëruar "plagët" e finales së Championsit kundër Realit të Madridit (gaboi rëndë të paktën në dy raste), por Loris Karius duket se është bërë barrë edhe për klubin turk. Në bazë të marrëveshjes, duhet të qëndrojë në Stamboll për dy vite, por kanë mjaftuar tre muajt e parë që portieri gjerman t'i bindë përfundimisht drejtuesit e klubit turk se nuk e ka marrë veten nga gafat e Championsit. Në fillim një dalje e gabuar në kampionat, më pas një gol absurd i pësuar nga Malmoe në Europa League... Karius nuk është shëruar nga "goditja" e Kievit. Beshiktashi jo vetëm që nuk ka ndërmend ta blejë kartonin e tij, por konsideron të tepërt edhe pagën e lartë të portierit. Liverpooli gjithashtu nuk dëshiron t'i shtojë një barrë trajnerit Klopp, ndaj mund të mbajë që qëndrim të prerë: "e morët, tani mbajeni për dy sezone". Por edhe për çështjet më të vështira ka gjithmonë një zgjidhje. Beshiktashi mund t'i bëjë një tjetër propozim Liverpoolit: të marrë në formë huazimi Origin, një sulmues i dalë jashtë planeve të Jurgen Klopp, dhe të kthejë në "Anfield" portierin Karius. Për trajnerin gjerman të "The Reds" është e njëjta gjë, Karius apo Origin, është një barrë për t'u vuajtur, pse jo për t'u hequr qafe ndoshta përfundimisht.

Publicitet

Në bazë të nenit 20, 21 dhe 22 nga Rregullorja për licencat të zbatimit të veprimtarive energjetike (Gazeta zyrtare e RM nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16) Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime AGRO GAMA DOO import-eksport DOO Vasilevë, e publikon këtë

NJOFTIM

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime AGRO GAMA DOO import-eksport DOO Vasilevë, në ditën 15.10.2018 parashtroi Kërkesë për ndërrimin e Licencës për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritura, për shkak të rritjes së fuqisë të instaluar, deri te komisioni Rregullator për energjetikë dhe shërbimet e ujit të R. Maqedonisë të regjistruar me numër UP1 nr. 12-145/18.

Emri i Kërkesës:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime AGRO GAMA DOO import-eksport DOO Vasilevë, me seli në rr. Vëndbanim pa sistem rrugor PN (zona industriale) Vasilevë.

Lloji i veprimtarisë energjetike:

Prodhimi i energjisë elektrike

Zona ku do të realizohet veprimtaria:

Prodhimi i energjisë elektrike do të bëhet nga centrali fotovoltaik i kulmit të depos - frigorifer të PK 1318, KK Vasilevë, Komuna Vasilevë, Republika e Maqedonisë.

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për realizimin e veprimtarisë:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime AGRO GAMA DOO import-eksport DOO Vasilevë do të prodhon energji elektrike nga centrali fotovoltaik në kullm, me lokacion në PK 1318, KK Vasilevë, Komuna Vasilevë, e cila e posedon Kërkesën e licencës. Prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet sistemit inverter do t'i dorëzohet sistemit shpërndarës. Fuqia e instaluar në pjesën e re të centralit fotovoltaik 90,72 kW. Centrali FV ekzistues për të cilën Kërkesi veç se ka fituar Licencë për kryerjen e veprimtarisë energjetike është me fuqi prej 24,00 kW.

Kohëzgjatja e licencës:

Kërkesi kërkon qe licenca të gjatë 35 vjet.

Afati për parashtrimin e ideve, mendimeve dhe sugjerimeve me Kërkesën për dhënie e licencës:

Personat fizik dhe juridik të interesuar mundin me shkrim të parashtrorin deri te komisioni Rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit të RM mendimet dhe sugjerimet në lidhje me Kërkesën në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të Njoftimit për Kërkesë në shtypin ditor.

Adresa e komisionit Rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit të RM

bul. Makedonija pn pallati Lazar Pop Trajkov kati i 6-të.

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime AGRO GAMA DOO import-eksport DOO Vasilevë

THIRRJE PUBLIKE

PËR PËRZGJEDHJEN E PERSONIT JURIDIK I CILI KRYEN VEPRIMTARI APO POSEDON LEJE PËR GRUMBULLIMIN DHE/APO TRANSPORTIN, PËRPUNIMIN, RICIKLIMIN DHE ASGJËSIMIN E MBETURINAVE

Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë, në bazë të nenit 42 paragrafi 3 i Ligjit për përdorim dhe disponim me sendeve në pronësi shtetërore dhe me sende në pronësi të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 106/15, 153/15, 190/16 dhe 21/18) dhe Vendimit për dhënie e pëlqimit për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së personit juridik i cili kryen veprimtari apo posedon leje për grumbullimin dhe/apo transportin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave Nr. 44-7789/1 të datës 04.09.2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 21/2018), shpall thirrje publike për përzgjedhjen e personave juridik të cilët kryejnë veprimtari apo posedojnë leje për grumbullimin dhe/apo transportin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave, për sende të tundshme të cilat për shkak të gremisjes, papërdorshmërisë apo vjetërsisë teknologjike nuk përdoren nga ana e Komisionit të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë.

Thirrja publike është e pandashme.

Personi juridik i përzgjedhur në thirrjen publike ka obligim t'i marrë sendet e tundshme subjekt të thirrjes publike dhe të njëjtat t'i shtëtojë dhe transportojë si mbeturina në mënyrë të duhur, në përputhje me Ligjin për përdorim dhe disponim me sendeve në pronësi shtetërore dhe me sende në pronësi të komunës, Ligjin për menaxhim me mbeturinat dhe Ligjin për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike dhe mbeturina elektrike dhe elektronike.

Sendet e luajtshme gjenden në vendet në vijim:

1. Rr. Maqedonia nr. 25. Pallati Lazar Pop Trajkov, kati 4 dhe
2. Blvd. Shën Klimenti i Ohrit nr. 54, Shkup

Instruksonet të thirrjes publike për përzgjedhjen e personit juridik do të jenë detajisht të publikuara ne ueb faqen e Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë – www.sec.gov.mk ose mund të merren drejtpërsëdrejti në arkivin e Komisionit i letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë.

Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2

Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.

Tel. 071/372-215 & 078/243-583

LOPETEGUI FALËNDERON KLUBIN, MIRËNJOHJE KA VETËM PËR TIFOZËT E REALIT

“Pas vendimit të Bordit të Drejtorëve të Real Madridit, dua të falënderoj klubin për mundësinë që më kanë dhënë. Faleminderit lojtarëve për përpjekjet e tyre dhe punën, respekt për secilin dhe çdonjërin nga punonjësit e klubit, për trajtimin e tyre të mirë gjatë kësaj kohe. Dhe, natyrisht, mirënjohja ime shkon për tifozët, për mbështetjen e tyre”, tha Lopetegui



Julen Lopetegui ka falënderuar tifozët e Real Madridit, pas shkarkimit të tij si trajner, të hënën. 52-vjeçari u shkarkua zyrtarisht, pas humbjes shokuese në “El Clasico” (5-1) ndaj Barcelonës, të dielën, ndonëse kishte raportime se vendimi ishte marrë që pas humbjes 2-1 ndaj Levantes, fundjavën e kaluar. Real Madridi lëshoi një deklaratë, në të cilën konfirmoi largimin e Lopeteguit, ku thuhej se “ekziston një shpërpjesëtim i madh mes cilësisë së skuadrës, që ka tetë futbollistë të nominuar për “Topin e Artë” dhe rezultateve të arritura deri tani, këtë sezon”. Megjithatë Lo-

petegui refuzoi të rikthehej në mjediset e klubit madrilen për lamtumirën, i falënderoi të gjithë ata, me të cilët kishte punuar. “Pas vendimit të Bordit të Drejtorëve të Real Madridit, dua të falënderoj klubin për mundësinë që më kanë dhënë. Faleminderit lojtarëve për përpjekjet e tyre dhe punën, respekt për secilin dhe çdonjërin nga punonjësit e klubit, për trajtimin e tyre të mirë gjatë kësaj kohe. Dhe, natyrisht, mirënjohja ime shkon për tifozët, për mbështetjen e tyre. U dërgoj atyre urimet e mia më të mira për pjesën tjetër të sezonit”, tha Lopetegui në një deklaratë të shkurtër, të dhënë tek EFE.

Santi Solari do të shërbejë si trajner i përkohshëm i ekipit të parë, ndërsa një pasues afatgjatë i Lopetegui po kërkohet nga “LosBlancos”. Ardhja e Santiago Solari në krye të stolit të Real Madrid nuk e ka qetësuar situatën në kampin e “LosBlancos”, të cilët mesa duket vijojnë kërkimet për një trajner që do t’u rikthejë në lavdinë e dikurshme. Madrilenët duan Mauricio Pochettino deri në fund të nëntorit, ku ky i fundit vetëm një ditë më parë, pranoi se ka nisur sezonin më të keq të karrierës së tij në Tottenham. Siç shkruan “The Sun”, përfaqësues nga “Santiago Bernabeu” janë takuar me njerëz të afërt

me 46-vjeçarin javën e kaluar në Londër dhe i kanë dorëzuar raporte premtuese kryetarit Florentino Perez. Antonio Conte ishte një nga emrat më të përfolur për të marrë drejtimin e Real Madrid pas një serie rezultatesh negative me Lopetegui në krye, por lojtarët nuk ishin dakord me stilin dhe mënyrën e tij e të të punuarit. Një ndër arsye kryesore përse kampionët e Champions League nuk zgjodhën italinin është edhe Eden Hazard. Ky i fundit është objektiv i madh i Real Madrid dhe emërimi i Contes do të kishte ndikuar që të rinovonte kontratën me Chelsea.



Icardi: Inter në rrugën e duhur, por nuk jemi anti-Juve

Mauro Icardi ka konfirmuar momentin e mirë që po kalon me dopietën ndaj Lazios, por ka siguruar se Inter nuk është anti-Juventus. Sulmuesi ka shënuar gjashtë gola në katër ndeshjet e fundit të Serie A, por mbi të gjitha me vetëm shtatë goditje drejt portës, duke vërtetuar edhe njëherë se sa vrasës është brenda zonës. “Jam duke kaluar një formë të mirë, bashkë me Inter. Po luajmë mirë, përveç ndeshjes me Barçan, por duam të luajmë akoma më mirë,” shprehet sulmuesi për Sky Sport pas fitores 3-0. “Ne nuk jemi anti-Juventus, pasi jemi disa hapa mbrapa asaj që kanë arritur ata në vitet e fundit, por jemi të lumtur me lojën tonë. Jemi në rrugën e duhur. “Ekipi po përmirësohet, po punojmë për t’u përmirësuar dhe të luajmë topin, diçka që e bëmë shumë mirë sot. Është e rëndësishme edhe të mos pësonim gol, pasi e dimë se kemi mundësinë të shënojmë”, ka theksuar Icardi.

Cancelo: Ronaldo i lindur për të fituar

Joao Cancelo lavdëroi bashkëlojtarin e tij me Juventusin dhe Portugalinë, Cristiano Ronaldo, duke e quajtur atë “fitues të lindur”, sepse iu jep ekipeve ku luan një atmosferë të veçantë. Duke u bashkuar me Juventusin këtë sezon, pas një huazimi tek Interi, 24-vjeçari është bërë një element i padiskutueshëm në të djathtë të bardhezinjve. Megjithatë, Cancelo ka më shumë fjalë për bashkatdhetarin e tij. “Unë jam duke folur për një lojtar, që ka bërë dallimin kudo që ka shkuar, sepse Ronaldo është ndryshe nga të gjithë të tjerët”, tha ai për “Sky Sport Italia”. – Kur arriti te Juventus, nuk ngriti vetëm nivelin e skuadrës, por edhe nivelin individual të shokëve të tij. Juventus ka qenë gjithmonë një klub i madh, por tani me Cristianon jemi transformuar, synojmë Ligën e Kampionëve. Cristiano ka lindur për të fituar dhe ndihmuar



shokët e tij të fitojnë”. Në lidhje me “Topin e Artë”, Cancelo nuk beson se ka ndonjë diskutim, pavarësisht nga pretendimet e Lionel Messit, Luka Modric dhe Antoine Griezmann. “Çdo ditë stërvitem me Cristiano Ronaldon dhe deri tani ai ka fituar pesë trofe të tillë”, shtoi portugezi. Nëse Cristiano nuk e fiton këtë vit, është e pabesueshme. Ai është më i miri i të gjithëve dhe sezonin e kaluar ishte më vendimtar sesa çdo lojtar tjetër. Cristiano fitoi Ligën e Kampionëve si protagonist absolut, duke shënuar 15 gola. Pa Cristiano Ronaldon, Real Madridi humb 5-1. Ky është ndryshimi”.

Emery hidhet në veprim, synon t’i marrë mesfushorin Mourinhos

Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, është i interesuar të transferojë Juan Mata verën e ardhshme, pasi kontrata e spanjollit i afrohet përfundimit në “Old Trafford”. Këtë e bën të ditur “DailyStar”. Spanjollit ka më pak se një vit të mbetur në marrëveshjen e tij të tanishme me Manchester United dhe ka luajtur pak nën drejtimin e Jose Mourinhos, këtë sezon. Mata luajti te Valencia për tri vite nën urdhrat e trajnerit Emery, ndërkohë që të dy mund të ribashkohen në fillim të edicionit 2019-2020. Mesfushori i Spanjës, 30 vjeç, ishte ylli i krahut të Valencias, i drejtuar nga trajneri aktual i Arsenalit, Unai Emery (2008-2011). Deri më tani, mesfushori nuk ka pranuar të zgjasë qëndrimin e tij në “Old Trafford” përtej këtij sezoni, pavarësisht nga përpjekjet e klubit për ta bindur atë të nënshkruajë një kontratë të re. Mata mund të

provojë një ribashkim me trajnerin e tij të vjetër. Emery mbetet një admirues i madh i “playmaker”-it të Manchester United,

i cili u largua nga Valencia për te Chelsea për shumën e 37.1 milionë paundëve, shtatë vite më parë.



DASHI 21. mars - 20. prill
Mund të merrni disa bonuse dhe avantazhe të papritura, të cilat gjithsesi do ju lejojnë që të përmirësoni rezultatet në punë. Ky është momenti më i mirë për të mbajtur impulsivitetin nën kontroll në sferën e dashurisë.

DEMI 21. prill - 21. maj
Duhet të ndiqni më shumë këshillat e vlefshme të bashkëpunëtorëve dhe të afërmeve tuaj, pasi së fundmi keni qenë shumë kokëfortë në marrjen e vendimeve në vendin e punës. Kjo e martë është ideale për të reflektuar. Takimet e mbrëmjes janë mjaft të favorshme.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Në dashuri mos u tregoni shumë të paduarur, pasi ankthi i së kaluarës mund të bëjë që të nxirrni konkluzione të nxituara në raport me partnerin/en tuaj. Në vendin e punës parashikohen mundësi shumë të mira për të çuar përpara propozime të reja.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Nëse gjatë javëve të fundit e keni ndjerë veten të lënë pas dore në dashuri, ky është momenti ideal për të marrë vëmendjen që keni pritur. Parashikohet të jetë një e martë shumë intriguese dhe e pasur me të reja të rëndësishme lidhur me një histori në të cilën jeni përfshirë prej pak kohësh.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Më në fund do mund të korni frytet e punës tuaj dhe kjo gjë do ju lejojë që të arrini një pozicion të ri të rëndësishëm. Sa i takon dashurisë, duhet të jeni gati që të përballeni me ndonjë të papritur të vogël.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Nëse keni probleme në vendin e punës, duhet të flisni hapur dhe të zhdokni çdo dyshim. Këshillohet që të jeni më luftarak, sidomos nëse bëhet fjalë për të mbrojtur nismat tuaja. Takimet janë mjaft të favorizuara.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Është një ditë e cila do ju gjejë shumë të djegur dhe për këtë arsye duhet të shmangni përfshirjen në debate që nuk ju përkasin. Ka disa tensione të cilat duhen sheshuar me patjetër, pasi në të kundërt gjithë ankthin do e shfryni në familje dhe dashuri.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Të gjitha shqetësimet tuaja, e kanë origjinën në vendin e punës dhe kërkojnë më shumë përgjegjësi prej jush. Megjithatë kjo e martë këshillon që të mos lini pas dore dashurinë dhe ndjenjat, pasi parashikohen zhvillime të papritura.


SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Fati do të jetë në anën tuaj dhe për këtë arsye do të arrihi të zgjidhni çdo të papritur në vendin tuaj të punës. Megjithatë duhet të jeni më të qetë dhe të reflektoni më shumë në familje ose në dashuri, pasi ka disa çështje të pazgjidhura, të cilat duhen trajtuar me kujdesin maksimal.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Mos merrni përsipër shumë përgjegjësi, pasi për shkak të stresit të akumuluar gjatë ditëve të fundit, do të ndiheni shumë të lodhur, shkruan noa.al. Në dashuri, parashikohen mundësi të mira për të zyrtarizuar një raport.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Parashikohet një ditë e cila do ju gjejë të rrethuar nga njerëz pozitiv dhe të besueshëm, me të cilët duhet të nisni bashkëpunime të reja. Tashmë duhet të jeni tejet të sigurtë në zhvillimin e angazhimeve tuaja.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Këshillohet që të shmangni investimet shumë të mëdha, pasi në këtë moment duhet të jeni më të vendosur në riorganizimin e plotë të disa aktiviteteve tuaja që presin të mbyllën. Mbrëmja do të jetë shumë romantike.

Mensur Mamuti	ERDHA PAPRITMAS RAPISTI AMERIKAN NË FOTO (EMRI I VERITETË)	B	RAPISTI AMERIKAN NË FOTO	HIT I RAPISTIT NË FOTO	LUMË NË TAILANDË
VRAP I KALIT NË HAPË TË SHPEJTË					
SHTET NË SHBA					
QYTET NË INDI (NË UTAR PRADESH)					
ENERGJIA	ISMAIL ARSLLANI ERBIUMI				PËREMËR VETOR
AKTORI KROAT, BASHIQ					
PARTI POLITIKE ANGLEZE					
VOLTI AMNISTI	SHAJAK I HOLLË, I RRAHUR				
F					BANORE E ARMENISË
REJA					ERSTEDI (OERSTED) HIDROGJENI DHOMA FILM I POL VERHOVENIT SHITËS IKONASH
VALDETE ANTONI KËNGË E SINAN VLLASALIJUT		BRITMË GËZIMI, BROHORITJE SHTET NË GADI-SHULLIN PIRENEJ			
B				ZAKON, LIGJ TË HOLLA	
PJESË E LIGJIT			SPANJA	KRATER NË MARS QË E KËMBISHITIN TË PRERË	
PËRSËRITJA E ZHURIMAVE NJERA PAS TJETRËS PËREMËR DËFTOR					ORGANIZATA NDERKOMBETARE PJATA, SAHANI
K			THIRRJA E ARKIMEDIT PARAFJALË GJERMANE		
PJESA E SIPËRME E KRAHUT				PJESËTAR I NJË VENDI, BANUES KALIUMI	
KOHA					VËLLAI I MADH (KRAHIN)



ZGJIDHJET: B, REVAN, OHAJO, BANSI, E, IA, RELJA, TRAST, V, ABA, FALJE, NUSJA, VA, BROHORI, BIJA IME, DOK, NEN, E, PABO, KADENCA, ON, KËTO, EUREKA, LLËRA, BANOR, FANKI, APË.

Shumë i lehtë Sudokun mesatar

				5		9	7	8			8			4	9			
						8		1	4		1	9			4	2		
						6		2			7		9			1		
	7	4		1							7	6			3		9	4
6				5		2								1		2		
						8		7	3					4				
	3			4							2		8				6	
8	4			9							8	7				1	5	
2	1	9		3								6			5	7		

Shumë i lehtë: 462153978, 357298614, 198746523, 574319286, 683572149, 921684735, 735461892, 846927351, 219835467. Mesatar: 638214975, 519687423, 274953816, 761538294, 943162587, 852749631, 425871369, 387496152, 196325748.



FËMIJA I EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË GREQI KRIJON ROBOTIN E RRALLË NË BOTË



Dhimitër Haxhi, një adoleshent 15 vjeç, fëmijë emigrantësh shqiptarë në Greqi, ka krijuar një robot nga një printer tredimensional dhe ka fituar një çmim nga Ambasada Amerikane në Greqi. Djalë në Greqi mban emrin Dimitris Hatzis dhe studion në Kavalla, ku dhe jeton me prindërit. "Urime Dimitris Hatzis, këtij 15 vjeçari që studion në Kavallë për krijimin

e një roboti humanoid nga një printer 3D! Me këtë krijim Dimitris i përket tani një grupi të vogël që ekzistojnë në botë. Krijimi i tij është pjesë e projektit "In-Moov", një platformë burimi e hapur që është përqendruar rreth përmasave të robotit humanoid nga një printer 3D. Hatzis mundi të rikonstrukttojë robotin pas një pune të përditshme njëvjeçare

dhe tani i përket 1 ndër 6 njerëzve në botë që kanë mundur të përfundojnë këtë mision.

Pesë të tjerët janë përfshirë dhe disenjatorin origjinal të robotit, francezi Gael Langevin, 2 rusë, një italian dhe një gjerman. Hatzis është më i riu në grup, dhe më i ri në moshë", shkruan ambasada amerikane në Athinë.



Ishte i fiksuar pas djemve, babai shet për 5 mijë euro vajzën e sapolindur

Ka persona që janë të fiksuar pas gjinisë së fëmijës, ku djemtë janë më të "preferuarit". Por një rast në Kinë ka kaluar çdo parashikim. Burri dëshironte të kishte djalë, dhe me ardhjen në jetë të vajzës e shiti atë për 5 mijë euro. 42-vjeçarja Li tha se do shkonte të shtëpinë e të birit për t'i dhënë ndihmë rreth kujdesjes për të porsalindurën, njësoj siç kishte bërë me mbesën e parë.

Por, i biri nuk e mirëpriti dhe nuk pranoi që ta fuste brenda. "Unë e pashë mbesën time vetëm për pak çaste kur erdhi në jetë. Më pas nuk e pashë më dhe biri im nuk më lejonte të hyja në shtëpi", tha ajo për policinë. Në fillim të tetorit, Li shkoi të takonte nusen kur i biri nuk ishte në shtëpi dhe zbuloi se foshnja ishte zhdukur.

Fëmija është gjetur dhe aktualisht është nën kujdesin e nënës dhe gjyeshes së saj. Blerësit dhe babai i foshnjës janë arrestuar nga policia lokale.

Shpërblime për ata që nuk përdorin veturën!

Në qytetin italian të Bolonjës, njerëzit shpërblehen për çiklizëm, ecje dhe përdorimin e transportit publik. "Bella Mossa" është ideja e projektuesit urbanistik Marco Amadori. Skema kundër ndotjes ka për qëllim të zvogëlojë udhëtimet me makina dhe të nxisë udhëtimin "e gjelbër" me shpërblime si birra, akullore ose bileta kinema për pjesëmarrësit që për pjesëmarrësit që plotësojnë shëtitjet dhe udhëtimet eko-miqësore.

Banorët e Bolonjës mund të shkarkojnë një aplikacion që përdor ndjekjen e GPS për të regjistruar udhëtimet e tyre. Çdo shëtitje ose udhëtim me biçikletë ose autobus fiton pikë, të cilat mund të ndërtohen dhe të shkëmbehen

për mallra dhe shërbime në bizneset lokale që kanë nënshkruar skemën. "Sistemi i grumbullimit të pikave nuk bazohet në distancën që ju udhëtoni, por në një udhëtim të vetëm, sepse është e rëndësishme që edhe për udhëtime të shkurtra prej 1 kilometra ta bëni atë në mënyrë të qëndrueshme", tha Marco Amadori për BBC.

"Bella Mossa" ka fituar popullaritetin dhe nuk është folur për zgjatjen e periudhës operative katër mujore të iniciativës. Aplikacioni lejon që çdo ditë të regjistrohen maksimumi katër udhëtime, për të inkurajuar njerëzit që të përdorin skemën me kalimin e kohës dhe për të ndihmuar që udhëtimi në qytet të jetë më i qëndrueshëm.



335 - Perandori i Konstantinopojës, Konstantini i Madh sjell ligje kundër hebrejve.

1096 - Sulltani Kilidj Arslan i Nikesë mund ushtarët e Kryqëzatës së Parë.

1512 - Martin Luther regjistrohet në fakultetin teologjik të Universitetit të Uitenbergut.

1553 - Ndizen vëllime të Talmudit.
1555 - Parlamenti anglez refuzon të njeh Filipin e Spanjës si mbret.

1727 - Rusia dhe Kina merren vesh për korrigjimin e kufijve.

1878 - Kancelari i Republikës gjermane delegon fundin e "Socializmit".

1914 - Përfundon beteja e Varshavës me disfatën e gjermanëve.

1921 - Hapet Teatri Tuschinski në Amsterdam.

1954 - Trupat indoneziane zbarkojnë në Guine të Re.

1971 - Pablo Neruda fiton Çmimin Nobel për Letërsi.



PARTNERË NË TË NJËJTIN PROFESION?! JETË MONOTONE

Partnerët që kanë të njëjtin profesion kanë një bashkëjetesë monotone. Në këtë përfundim arrin një studim i publikuar në "The Telegraph". Studiuesit, pasi hulumtuan 291 çifte, ku partnerët ishin në të njëjtin profesion dhe 350 çifte, me partnerë që kishin profesione kryekëput ndryshe nga njëri-tjetri, thanë se është më e vështirë të jetosh në një shtëpi me "kolegun" se sa me dikë që as ia ka haberin punës që ti bën. Në rast se bashkëshortët kanë të njëjtën fushë studimi por edhe punojnë në të njëjtin drejtim, atëherë u mbetet më pak kohë për jetën private - orët e punës zgjasin më shumë dhe ekuilibri marrëdhënie-karrierë, nuk gjendet lehtësisht. Pra, hallet e zyrës, kalojnë në shtëpi më shpesh dhe bëhen çështje dite edhe në tryezën e ngrënies. Megjithatë, studiuesit psikologë, theksojnë se kjo temë nuk mund të ndahet me thikë, edhe pse të dhënat të çojnë në këtë përfundim.

TIFOZËT

Mësuesja: Beni, çfarë kafshe është zebra?

Beni: Një gomar që ka veshur bluzën e Juventusit!



Jetojmë në një kohë, ku e keqja shkon gjithmonë drejt të drejtit!
(Robert Ndrenika)



KALENDARI HISTORIK 31 TETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS